



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor**

**“Menaxhimi i Turizmit Rural”**

**i**

**Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Bujqësor i Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Klodiana Gorica
2. Prof. Asoc. Dr. Ermelinda Kordha

Korrik/2019

## PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

### Përshkrim përmbledhës

Programi Bachelor në Manaxhimi i Turizmit Rural (MTR) ofrohet për studentët nga Departamenti i Zhvillimit të Turizmit Rural, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Universiteti Bujqësor i Tiranës.

Ky program është lancuar në tregun e arsimit të lartë shqiptar për herë të parë në vitin akademik 2011-2012. Programi është hapur me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr 272, datë 10.06.2011 dhe që prej asaj kohe ka funksionuar në mënyrë të pandërprerë duke diplomuar pesë breza studentësh.

Programi i studimit Bachelor në “Manaxhimi i Turizmit Rural” plotëson më së miri kriteret sa i takon rëndësisë së programit për nevojat e ekonomisë, organizimit dhe administrimit të tij nga një staf i kualifikuar, nga kompetencat që ai përcjell, si dhe sa i takon mësimdhënies, mësimnxënies, si dhe plotësimit të burimeve të nevojshme për realizimin me cilësi të programit të studimit

Hapja e këtij programi është bazuar në dokumentacionin e mëposhtem:

- Propozimit të Dekanatit të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit e datës 13.01.2011 me Nr. Protokoll 13 (Aneks 3 Hapja e Programit të MTR Fq 3).
- Në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës së Shqipërisë, Nr. 272 të datës 10/06/2011 (Aneks 3 Hapja Programit të MTR Fq. 1, Datë 10/06/2011), bazuar në nenin 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 26 dhe 42 të ligjit 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, referuar vendimit nr. 5 të datës 17.01.2011 të Rektoratit të UBT (me nr. Protokoll 155/1 i datës 18.01.2011) (Aneks 3 Hapja e Programit të MTR Fq 2)

Unikaliteti dhe rëndësia e këtij programi përmbledhen në pikat e mëposhtme:

- Rëndësia e këtij programi është veçanërisht **kombëtare** sepse në kushtet kur Shqipëria po kërkon të zhvillojë dhe mirëorganizojë territorin dhe agroturizmin, studentët e këtij programi jo vetëm që priten të jenë një burim i rëndësishëm ekspertësh/specialistësh, por do të plotësojnë qartë nevojat që kanë tregu shqiptar kundrejt rritjes së këtij trendi.
- Rëndësia e këtij programi është gjithashtu **ndërkombëtare**, sepse përputhet qartë edhe me politikat e komunitetit europian për zhvillimin e komuniteteve dhe zonave rurale si dhe me perceptimin e ri europian të një destinacioni turistik.
- Qasja e këtij programi **mirëekuilibron kërkesën me ofertën** që paraqet tregu shqiptar, për shkak të tendencës në rritje të agroturizmit dhe turizmit rural, rrjedhimisht rritjes së numrit të bizneseve të tilla, pra rritjes së kërkesës i përafrohet me një rritje të ofertës.
- Programi “Manaxhim i Turizmit Rural” është një program unik në llojin e tij në Shqipëri jo vetëm sepse përmbush dhe plotëson qartë nevojat e biznesit/tregut shqiptar për këtë produkt (studentët e diplomuar), por edhe për shkak se **një program i tillë nuk ofrohet nga IAL të tjera**. Në përgjithësi programet e ofruara nga IAL e tjera publike dhe/ose private, ofrojnë programe në manaxhim të përgjithshëm të turizmit.
- Përmes lancimit të këtij programi dhe tashmë testimit të tij në treg, ky program **rrugëton dhe mbështet mundësinë e profilizimeve dhe aftësive të tjera me të specializuara** që mund të ofrohen në të ardhmen nga ky departament, duke përbërë një mënyrë rritjeje të qëndrueshme dhe të kujdesshme të kësaj njësie të UBT.




### Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Procesi i vlerësimit të jashtëm paraqitet si një proces që ka ndjekur hapat rigoroze të cilat janë në zbatim të ligjit për arsimin e lartë dhe gjithë bazës ligjore për veprimin e Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Procedura përfshiu fillimisht trainimin e ekspertëve pjesë e GVJ me standartet e cilësisë dhe kriteret, si edhe me përdorimin e sistemit elektronik në pjesën e panelit të ekspertit. Shpjegimi i tyre pati rëndësi për cilësinë e mëtejshme të punës së GVJ. Instalimi i komunikimit të mirë në grupin e punës midis ekspertëve dhe menaxherit teknik nga ASCAL ishte një hallkë e rëndësishme për ecurinë e procesit. Pas njohjes dhe shfrytëzimit të dokumentacionit të dorëzuar nga institucioni për diplomën përkatëse, u ndërtua një axhendë për vizitën në institucion dhe hapi i radhës natyrshëm ishte realizimi i saj. Axhenda u zbatua me rigorozitet, duke ndikuar pozitivisht në mbledhjen dhe grumbullimin e informacioneve të mëtejshme të cilat do të ndikonin në një vlerësim bazuar mbi informacion sa më të detajuar. Pas vizitës në terren u realizua raporti përfundimtar nga ekspertët e jashtëm dhe ky u dorëzua për rishikim nga ASCAL dhe për njohjen me të të GVB. Menaxhere teknike e ndjekjes së këtij programi është Specialistja e ASCAL, Znj Suela Kromidha.

Më datë 02.07.2019 nëpërmjet sistemit AMS por edhe me shkresë zyrtare, është dërguar në Institucion Draft RVJ. Me shkresë Nr 204 prot, datë 09.07.2019 “Përcjellje e komenteve të Draft Raportit të Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit Bachelor në “Menaxhimi i Turizmit Rural”, vjen nga UBT përgjigja për Draft RVJ. Kjo përgjigje vjen dhe më datë 10.07.2019, nëpërmjet sistemit AMS. UBT nuk ka asnjë koment për këtë Draft Raport. Për sa më sipër, Draft RVJ merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm dhe firmoset nga Ekspertët e vlerësimit.




**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor**

**“Menaxhimi i Turizmit Rural”**

**I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR**

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.</p>	<p>Ideimi, kompozimi dhe ekzistenca e këtij programi studimi është konsideruar, ofruar në treg dhe mbështetur në vijim në të gjithë procesin e zhvillimit të tij si një produkt cilësor, koherent dhe vecanërisht mbështetës për politikat dhe interesat kombëtare.</p> <p>Kjo rezulton dhe mbështetet në argumentimin më poshtë se jo vetëm mbështetet dhe përputhet me misionin dhe objektivat makroekonomike të arsimit të lartë dhe zhvillimit kombëtar, por e përcjell këtë filozofi më së miri në të gjitha dokumentat strategjike të UBT e deri tek njësia bazë mbështetëse dhe ofruese e këtij programi (departamenti) si më poshte:</p> <p>a. Ky program është hartuar në përputhje me misionin e arsimit të lartë, por edhe me politikën udhëheqëse të institucionit, të reflektuar në statusin e UBT, të miratuar në vitin 2017. Në këtë dokument strategjik (<i>Aneks 7 Statuti UBT_Miratuar_2017, Datë 28.03.2017, Neni 2 pika 3</i>) citohet se: synimi kryesor i UBT, Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit dhe i Programit të Studimit të MTR që bën pjesë në këto struktura, është të ofrojnë arsimim të lartë, zhvillim të dijeve dhe shkencës, inovacionit dhe të profesioneve të ligjshme. Po kështu në këtë dokument strategjik citohet se: “<i>UBT ka për mision edukimin profesional dhe kërkimin shkencor në fushat: prodhim bimor, prodhim shtazor; hortikulturë; mbrojtje bimësh; akuakulturë dhe peshkimi; agromjedis &amp; mbrojtjen e tij; ekonomi agrare; politikat bujqësore; zhvillimi i interguar rural; menaxhimi i ndërmarrjeve; marketing; financë &amp; kontabiliteti; agroturizëm, bioteknologji dhe ushqim; industrinë e pijeve; mbarështimin e pyjeve; industrinë drurit; mjekësinë veterinarë &amp; shëndetin publik etj.</i>” (<i>Aneks 7 Statuti UBT_Miratuar_2017, Datë 28.03.2017, Neni 2</i>)</p> <p>b. Nga ana tjetër, e gjithë veprimtaria mësimore, kërkimore dhe shkencore e cila qartë reflektohet në dokumenta strategjike, zhvillohet në përputhje me nevojat e zhvillimit të vendit, duke “<i>synuar t’u paraprijë dhe t’u japë përgjigjet sfidave të zhvillimit dhe të integritetit të vendit në strukturat evropiane, shfrytëzimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, rritjes së prodhimit vendas dhe njëkohësisht zgjerimit të llojshmërisë dhe të vëllimit së eksporteve të produkteve bujqësore dhe blegtorale, rritjes së konkurrencës, etj.</i>”, (<i>Aneks 7 Statuti UBT_Miratuar_2017, Datë 28.03.2017, Neni 59, pika 4</i>).</p> <p>c. Një reflektim dhe qasje e tillë, pro mbështetjes dhe ruajtjes së vlerave kombëtare është e reflektuar edhe në mendësinë e përditshme dhe mënyren</p>	



<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>e të operuarit të të gjithë departamentit që e ofron këtë program studimi. Kjo përcillet përmes opinioneve, analizave dhe raporteve vjetore të departamentit, në qartësinë e orientimeve strategjike për të ardhmen që kanë dhe shprehin jo vetëm stafi por edhe studentët e këtij programi.</p> <p>Megjithëse është program relativisht i ri, ky program krijon, nxit dhe mbështet një kulturë akademike të besueshme, që sigurohet përmes një bashkëpunimi dhe partneriteti të reflektuar si brenda departamentit, midis studenteve apo me biznesin, ku vlerësohen larmia, krijimtaria dhe risia, ku ushqehen dhe përhapen idetë dhe ku shpërblehen rezultatet. Ky reflektim vjen jo vetem nga konsultimi me dokumentat strategjike të institucionit por edhe departamentit, por deri tek brendësia e programit e reflektuar në module të caktuara që orientojnë qartë edukimin e përgjithshëm të studentëve me përgjegjësi mendimi dhe veprimi.</p> <p>Sikurse është shpjeguar edhe më lart, në pikat a dhe b, mbështja dhe përputhja e këtij programi me misionin e institucionit është e reflektuar jo vetëm në dokumentat strategjike të tij por edhe në mendësinë e përditshme dhe mënyrën e të operuarit të të gjithë departamentit që e ofron këtë program studimi.</p> <p>Objektivi i hapjes së këtij programi është të përgatisë specialistë të aftë të fushës së Ekonomisë dhe Agrobiznesit, të profilit të Menaxhimit të Turizmit Rural. Kjo është e mundur përmes kurrikulës së studimeve, e cila ofron për studentët njohje të thellë të teorisë ekonomike dhe të menaxhimit, teorisë dhe praktikës turistike, njohje dhe përdorim shumë të mirë të metodave sasiore të studimit, si dhe një formim të thellë profesional.</p> <p>Gjithashtu, objektivat e trajtuara me kujdes dhe në përputhje të plotë në dokumentat përkatës (<i>Aneks 8 Plani Strategjik UBT_Miraturar, Qershor 2016, Paragrafi Fundit, Fq 5 dhe i Parë Fq 6; dhe, (Aneks 7 Statuti UBT_Miraturar_2017, datë 28.03.2017, Neni 2 Pika 1 dhe Neni 59, Pika 1), orientojnë formimin e studentëve duke përfshirë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale dhe analitike që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij. Synojnë pajisjen me njohuritë bazë mbi shkencat bujqësore, sipas profilit përkatës (Aneks 9 Rregullorja-e-Studimeve_UBT_Final 2017, miraturar më datë 28.03.2017, Neni 19, Gërma c).</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga UBT, vizitat në institucion, reflektohet qartë një përputhje e të gjithë filozofisë së këtij programi për t'u zhvilluar jo vetëm në përputhje të plotë me objektivat dhe misionin e institucionit (UBT), por:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• për të përcjellë vecanërisht mbështetjen ndaj objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm kombëtar (sepse mbështet programet e qeverisë dhe niveleve të tjera qëndrore me një program të tillë që vjen në kohën e duhur kur zhvillimi rural dhe turizmi përbëjnë prioritetet kryesore të ekonomisë shqiptare);</li> <li>• por zhvillimin rural dhe mbështjen e komuniteteve lokale e bën si përmes nxitjes së bizneseve të reja apo start up ekzistuese në treg në nivele lokale në këtë fushë me dije, aftësi dhe profesioniste, ashtu edhe përmes nxitjes së studentëve drejt hapjes dhe krijimit të tyre të start up dhe bizneseve që orientohen drejt turizmit rural. Në këtë mënyrë ky program nxit zhvillimin</li> </ul>



	e biznesit, dhe përfron studentët e këtij programi jo vetem drejt vetëpunësimit (duke rritur në këtë mënyre aftësitë sipërmarrëse shqiptare), por duke i shërbyer në fund te fundit zgjerimit të këtij sektori, dhe direkt zhvillimit ekonomisë kombëtare: sepse synon rritjen e punësimit dhe rolin që ky sektor ka në GDP kombëtare.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

**Standardi I.2**

**Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	<p>UBT ka hartuar dhe miratuar një plan strategjik për zhvillimin e Institucionit për periudhën 2016-2025 (<i>Aneksi 8: Plani Strategjik i UBT 2016-2025: Misioni dhe vizioni i UBT-së, faqe 5, paragrafi 1</i>), ku UBT synon të jetë qendra më e madhe dhe ekselente e edukimit në të tre ciklet e studimit, kërkimit shkencor dhe transferimit të njohurive.</p> <p>Edhe programi i studimit Bachelor në “Menaxhimi i Turizmit Rural” është hartuar duke patur parasysh këtë vision strategjik, përgatitjen e menaxherëve për ndërmarrjet e bizneseve të turizmit dhe përgjithësisht atij rural, duke konsideruar sfidat e mëdha të dijës dhe të mjedisit gjithmonë e më konkurrues, duke konsideruar studentët, punëdhënësit si dhe shoqërinë në tërësi.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	<p>Në planin strategjik për zhvillimin e UBT-së vendosen disa prioritete midis të cilave janë studentët, kërkimi dhe mësimdhënia. Plani strategjik përbën një plan konkret për të ndërtuar realitetin e UBT dhe përbën një pikë të fortë orientuese për të ardhmen. Kështu, në Planin Strategjik, në Statutin dhe Rregulloren e studimeve universitare të UBT si dhe në rregulloren e FEA, janë përcaktuar qartë të gjitha drejtimit prioritar akademike e si i tillë është dhe programi “Menaxhimi i Turizmit Rural”, i cili në këtë frymë ndër të tjera synon MTR synon të sigurojë nivel njohurish në shkencat ekonomike për menaxhimin e bizneseve të turizmit dhe përgjithësisht atij rural që të jenë të krahasueshme me diplomat që lëshojnë strukturat analoge universitare jashtë vendit (<i>Aneks 10 Rregullore e Programit Studimit MTR, miratuar më datë 27.09.2017, Neni 1</i>).</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– (<i>Aneks 7 Statuti UBT_Miratuar_2017, Datë 28.03.2017, Neni 2</i>),</li> <li>– (<i>Aneks 8 Plani Strategjik UBT_Miratuar, Qershor 2016</i>) dhe</li> <li>– (<i>Aneks 12 Rregullore e FEA2017, miratuar më datë 29.09.2017, Neni 6, Pika 1, Neni 16, Neni 19, Pika 4 dhe Nenet 20 dhe 21</i>).</li> </ul>
	<p>MTR ofrohet si program studimi për nivelin e parë të studimeve universitare. Në përfundim të nivelit të parë që zgjat tre vjet, jepet diploma Bachelor (<i>Aneks 10 Rregullore e Programit Studimit MTR, miratuar më datë 27.09.2017, Neni 1, Germa c.</i>).</p> <p>Studimet ne DMTR synojnë arsimimin profesional dhe kualifikimin shkencor të studentëve në fushën e menaxhimit të turizmit rural. Studimet në këtë</p>



<p><b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p>	<p>program synojnë të sigurojnë njohuritë themelore në këtë fushë nëpërmjet integritit të mësimit me kërkimin.</p> <p>Programi i studimit të MTR, është hartuar në përputhje me statutin, strategjinë dhe planin e zhvillimit të UBT_s, në mbështetje të rregullores së FEA_s, të rregullores së brendshme të DMTR_s dhe rregullores së programit të studimit të MTR_s. (Aneks 16 Mendimi i Dekanit të FEA_s)</p> <p>Ai është hartuar në përputhje me drejtimet prioritare akademike të UBT_s (</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- (Aneks 7 Statuti UBT_Miraturar_2017, Datë 28.03.2017, Neni 2),</li> <li>- (Aneks 8 Plani Strategjik UBT_Miraturar, Qershor 2016) dhe</li> <li>- (Aneks 12 Rregullore e FEA2017, miraturar më datë 29.09.2017, Neni 6, Pika 1, Neni 16, Neni 19, Pika 4 dhe Nenet 20 dhe 21).</li> </ul> <p>Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit të MTR ofrohet në përputhje me fushat e drejtimet akademike të përmendura në paragrafët e mësipërm, dhe përcaktuara nga institucioni (UBT) dhe fakulteti përkatës (FEA), bazuar në Statutin e UBT, Planin Strategjik të UBT.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- (Aneks 12 Rregullore e FEA2017, miraturar më datë 29.09.2017, (në mënyrë të veçantë Neni 20 dhe 21);</li> <li>- (Aneks 11 Rregullore e Brendshme e DMTR, miraturar më datë 27.09.2017 (neni 1 dhe Neni 9) si dhe</li> <li>- (Aneks 10 Rregullore Programit të Studimeve të MTR (Neni 1).</li> </ul>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;">✓</p>

<p><b>Standardi I.3</b>  <b>Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Programi i studimit të Menaxhimit të Turizmit Rural (MTR) përbën një program të mirëorganizuar dhe studiuar paraprakisht jo vetëm përmbushjen e detyrimit që kanë IAL ndaj zhvillimit të qëndrueshëm kombëtar (ekonomik, social dhe mjedisor), por për t'a sjellë sa më pranë nevojave të tregut për të mbështetur bizneset shqiptare me produkte cilësore (studentë të diplomuar), me aftësi dhe dije të plota dhe përshtashme për këtë treg. Rregullore e Programit të Studimit MTR_s, miraturar më datë 27.09.2017, neni 9), përcakton se ky program studimi ka qartësuar objektivat të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p> <p>Objektivi i hapjes së këtij programi është të përgatisë specialistë të aftë të fushës së Ekonomisë dhe Agrobiznesit, të profilit të Menaxhimit të Turizmit Rural. Përgatitja e specialistëve të Menaxhimit të Turizmit Rural është konsideruar në tërësinë e tij si një instrument i zhvillimit ekonomik territorial dhe social i zonave rurale. Për më tej, ky program synon arsimimin profesional dhe kualifikimin shkencor të studentëve në fushën e menaxhimit të bizneseve të turizmit rural, të politikave të turizmit të qëndrueshëm, atij rural dhe të agroturizmit. DMTR synon të sigurojë nivelin e duhur të njohurive në shkencat ekonomike për menaxhimin e bizneseve të turizmit rural, për politikat agrare dhe të formave alternative të turizmit, marketingun dhe menaxhimin e agroturizmit që</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



	<p>të jenë të krahasueshme me diplomat që lëshojnë strukturat analoge universitare jashtë vendit (<i>Aneks 10 Rregullore e Programit të Studimit MTR, miratuar më datë 27.09.2017, Neni 1</i>).</p> <p>Edhe në nivelet e moduleve përkatëse, si pjesë e këtij programi studimi përcjellin të njëjtën filozofi të mbështetjes së aftësive dhe kompetencave me atë që përcakton edhe rregullorja e këtij programi. Kështu, çdo program moduli, pjesë e kurrikulës së programit të studimeve të MTR përcakton objektivat e formimit, të cilat janë në përputhje me objektin e modulit dhe programin e studimit të MTR (për hollësi shih rubrikën "Përmbledhje dhe Rezultatet e të Nxënës", (<i>Aneks 15 Syllabuset e Programeve të MTR</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Një ndër qëllimet kryesore të këtij programi të specifikuar jo vetëm në dokumentat strategjike, por edhe të reflektuara në kurrikula apo shprehura nga stafi, është mbështetja që ky program synon t'i japë tregut shqiptar, biznesit vendas dhe nevojave të tij për dije, aftësi dhe mirëmanaxhim, vecanërisht zhvillimit të biznesit të vogël dhe mesëm rural, duke e bërë në këtë mënyrë mjaft të përafër me zhvillimin e përgjithshëm kombëtar dhe me politikën nxitëse dhe mbështetëse që nivelet publike qendrore kanë për zonat rurale.</p> <p>Në Rregulloren e Studimeve të UBT_s, përcaktohet se programet e studimit të ciklit të parë "Bachelor" ofrohen në përputhje me misionin dhe vizionin e UBT_s, si dhe Fakulteteve dhe Departamenteve brenda tij, dhe në përputhje me strategjinë për zhvillim të UBT-së. Ato janë hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nuk bien ndesh me interesat dhe programet e tjera të ofruara nga Institucione të tjera të Arsimit të lartë (<i>Aneks 9 Rregullorja-e-Studimeve UBT_Final 2017, miratuar më datë 28.03.2017, Neni 19, Germa a dhe b</i>).</p> <p>Sipas rregullores së DMTR_s, departamenti mund të sugjerojë hapjen e fushave të reja të studimit në përshatje me nevojat e shoqërisë, kushtet ekzistuese dhe perspektivat e zhvillimit të vendit, bazuar në ligjin Nr. 80/2015 datë 22.7.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe akte të tjera nënligjore (<i>Aneks 11 Rregullore e Brendshme e DMTR, miratuar më datë 27.09.2017, Neni 1 pika 2</i>).</p> <p>Ngjarje të rëndësishme që lidhen me përafrimin e tregut dhe nevojave të biznesit që ky program mbulon lidhen edhe me:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Nga ana tjetër, një studim i realizuar nga Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA), me synim gjurmimin e ecurisë së studentëve të UBT në tregun e punës, ka evidentuar opinionet e tyre lidhur me tre komponentë: a) profilin e studentit, b) vlefshmërinë e diplomës së UBT për tregun e punës, dhe c) punësimin e tyre. QKA realizon dhe aktivitete trajnimesh në lidhje me zhvillimin e karrierës si dhe në bashkëpunim me departamentin bën gjurmimin e studentëve, plotësimin të marrëveshjeve për realizimin e praktikave dhe punësimit me biznese të ndryshme, bashkëpunimit me institucione, etj. (<i>Aneks 14 Raport Performanca QKA 2018, Tabela 1, Fq 5-7</i>). Në mbledhjen e DMTR_s, të datës 04.04.2018, një nga pikat e diskutuara ishte edhe gjurmimi i studentëve të Programit të Studimit të MTR. Në këtë mbledhje u konkludua që nga 2018 e në vazhdim gjurmimi i studentëve do të bëhet në mënyrë periodike dhe të rregullt çdo vit:       <ul style="list-style-type: none"> <li>– (<i>Aneks 22 Miratim Rregullore MTR &amp; DMTR dhe Gjurmim Studentëve MTR</i>);</li> <li>– (<i>Aneks 13/2 Gjurmimi Studenteve Ilustrim MTR</i>).</li> </ul> </li> </ol>



Bazuar në raportin e QKA për vitin 2018, rezulton që në periudhën Qershor-Korrik 2018, është realizuar një studim me studentë të diplomuar nga të gjithë fakultetet e UBT, përfshirë edhe studentët e FEA ku bën pjesë programi i MTR\_s. Nga gjurmimi i studentëve të FEA të cilët kanë mbaruar studimet të paktën një vit më parë se të jenë intervistuar, del që janë të punësuar 47.4 % e tyre. Të dhënat e studimit të realizuar në vitin akademik 2017-2018 i gjenden në *(Aneks 14 Raport Performanca QKA 2018, Fq 10-13)*. Saktësojmë që QKA dhe ZKS-të bëjnë studim dhe intervistojnë studentët në kohën e diplomimit (plotësojnë një pyetësor pikërisht në marrjen e diplomës) dhe bazuar në kontaktet e siguruara në këtë pyetësor, i kontaktojnë dhe intervistojnë një vit më vonë për ti përdorur si të dhëna krahasuese.

2. Ditët e panairit të karrierës të zhvilluara pranë UBT shfrytëzohen edhe për diskutim ndërmjet komunitetit të biznesit dhe institucioneve që mund të jenë ofrues të vendeve të punës dhe studentëve dhe stafit akademik, me qëllim shkëmbimin e ideve dhe ballafaqimin midis kërkesave të tregut të punës dhe mundësive reale që ofrojnë programet e studimit. Qëllimi final i këtyre takimeve është jo vetëm venia në kontakt e studentëve me punëdhënësit potencialë, por edhe përshtatjen e kurrikulave dhe programeve në përputhje me tregun e punës. Ky aktivitet është shndërruar tashmë në një traditë të suksesshme, pasi ai organizohet për të pestin vit radhazi. Kështu, psh në vitin 2018, në panair morën pjesë 51 sipërmarrje, Institucione Publike dhe Organizata të profileve të ndryshme. Bazuar në Raportin e Performancës së QKA, 2018 në çdo panair, mbi 250 studentë kërkohen nga Sipërmarrjet e pranishme për punësim dhe praktika profesionale *(Aneks 14 Raport Performanca QKA 2018 dhe Aneks 23 Foto të Pjesëmarrjen në Panair, Qershor 2016)*.

Hapja e këtij programi studimi (referuar ankesit bashkëngjitur *Aneks 3 Hapja e Programit MTR, Fq 1*), është bërë me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Nr. 272, datë 10.06.2011. Ky vendim është mbështetur me argumentim nga pala propozuese që është Universiteti Bujqësor i Tiranë (konkretisht FEA), dhe që janë paraqitur shkurtimisht në mënyrë të përmbledhur në argumentimin e propozimit të hapjes së programit të MTR\_s *(Aneks 3 Hapja e Programit MTR Fq2-12)*. Ky studim i bere nga ky fakultet u mbeshet me tej permes nje projekti per te finalizuar hapjen e këtij programi ne vitin 2011. Përpara hartimit propozimit të hapjes së Programit të Studimit MTR, FEA, bëri një studim paraprak të tendencave ndërkombëtare të zhvillimit të turizmit dhe të konsumatorëve turistikë (shijet dhe sjelljet turistike); te objektive të projektit (159143-TEMPUS -I-2009-I-HU-TEMPUS-JPCR), “USING Local Resources for Microregional Development- Sustainable Agribusiness and Tourism in the Southern Balkans; të tendencave të viteve të fundit në Shqipëri dhe rajon për zhvillimin e turizmit në zonat rurale si dhe nevojën për vënien në efikasitet të hapësirave të pashfrytëzuara fermave sidomos atyre të vogla, për të cilat turizmi rural është një mundësi punësimi dhe krijimit të ardhurave dytësore nga aktiviteti bujqësor; të drejtimeve të reja të zhvillimit të kurrikulave të disa universiteteve ndërkombëtare dhe të përputhshmërisë së këtij propozimi me programet e ofruara nga këto universitete si Universiteti i Minesotes, Universiteti Stafordshire, Universiteti i Plovdiv, Bulgaria, Universiteti i Azores, Instituti i Studimeve te Turizmit, Malte etj., *(Aneks 3 Hapja e Programit MTR, Fq 4)*; si dhe, të tendencave të zhvillimit të turizmit Shqiptar bazuar në studimin e tregut turistik *(Aneks 17 Studim Tregu 2011)*;



	<p>Propozimi i FEA_s për hapjen e programit të studimeve të MTR u mbështet edhe nga projekti "USING Local Resources for Microregional Development- Sustainable Agribusiness and Tourism in the Southern Balkans, (159143-TEMPUS -I-2009-I-HU-TEMPUS-JPCR). Objektivi kryesor i këtij projekti ishte të arrinte harmonizimin e ofertave në arsimin e lartë me burimet ekzistuese lokale, zhvillimin e agrobiznesit dhe turizmit të qëndrueshëm përmes programeve të përshtatshme studimore në Maqedoni, Shqipëri dhe Kosovë sipas parimeve të Bolonjës. Rezultatet e projektit në fjalë ishte edhe suporti për hartimin e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Menaxhimi i Turizmit Rural" (Aneks 3 Hapja e Programit MTR, Fq. 4) dhe që me hapjen e programit u pasua me marrëveshjen e diplomave të dyfishta ndërmjet Universita Politecnica delle Marche (UPM) dhe UBT-së (<i>Aneks 4 Accordo doppio titolo Albania_firmato, Numër Protokollit 1775, Datë 20.10.2014</i>).</p> <p>Objektivi i marrëveshjes midis UPM dhe UBT ishte tu ofronte studentëve të UPM-se dhe UBT-së që do merrnin pjesë në programin e shkëmbimit, mundësinë të përfitonin në të njëjtën kohë titullin e Diplomë trevjeçare në <i>Shkenca Ekonomike dhe Ndërmarrjesh</i>, me qendër në San Benedetto del Tronto, profili Ekonomi e Territorit dhe e Turizmit të UPM_së dhe Diplomë trevjeçare në <i>Menaxhim të Turizmit Rural</i> të UBT_së</p> <p>Nga hapja e Programit të Studimit të MTR e më pas është kërkuar si nga departamenti ashtu edhe nga zyrat e karrierës, sot ZKS (në nivel fakulteti) dhe QKA (në nivel universiteti) që të ketë ballafaqim me tregun e punës, si me institucione dhe organizata ashtu edhe me biznese private të fushës së turizmit. Kjo me qëllim që tu ofrohet studentëve një program studimi i cili përputhet me nevojat e tregut dhe u jep më shumë shanse punësimi pasi të janë diplomuar.</p> <p>QKA gjithashtu organizon aktivitete për të ofruar dhe lidhur studentët që janë duke studiuar dhe ata të diplomuar me tregun e punës nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme dhe komunikimeve me kanale të ndryshme si fletëpalosje, guida, afishe, libra, panairëve të karrierës (konsulto ftesën që u bëhet punëdhënësve të ndryshëm) (<i>Aneks 21 Shembull i Ftesës që QKA</i>)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Kjo është e mundur përmes kurrikulës së studimeve, e cila ofron për studentët njohje të thellë të teorisë ekonomike dhe të menaxhimit, teorisë dhe praktikës turistike, njohje dhe përdorim shumë të mirë të metodave sasiore të studimit, si dhe një formim të thellë profesional. Të qenit një program unik, si dhe duke u nisur nga nevojat e sektorit si dhe parashikimet e zhvillimit të Turizmit Rural në Shqipëri, përgatitja dhe diplomimi i studentëve në këtë program, është njëkohësisht edhe një mundësi e mirë punësimi e të diplomuarve.</p> <p>Struktura e kurrikulës së programit të MTR_s, rezultatet dhe objektivat e të nxënit për studentët të parashikuara në modulet përkatëse, pjesë e kurrikulës së këtij programi, janë në funksion dhe në përputhje me objektivat e përgjithshme të programit (shih "Përmbledhjen e Rezultateve të Nxënit" për secilin modul të ofruar në programin e MTR_s në dokumentin (<i>Aneks 15 Syllabuset e Programeve MTR</i>)).</p> <p>Bazuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• objektivat e vendosura në rregulloren e studimeve të MTR_s (neni 9)</li> <li>• objektivat e vendosura në programet e lëndëve të ofruara tek studentët në kuadrin e kurrikulës së MTR_s,</li> <li>• rezultatet e arritura nga studentët në përfundim të diplomimit,</li> </ul>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>rezultatet e arritura nga studentët në ballafaqim me tregun e punës dhe në mënyrë të veçantë nga praktikat profesionale pranë bizneseve të ndryshme, arrijmë në konkluzionin se programi i MTR_s garanton përfitimin e kompetencave bazike në fushën e menaxhimit të ndërmarrjeve ekonomike, në politik bërje menaxhimit të ndërmarrjeve turistike, fermave agroturistike, si dhe në fushën e ekspertizës së turizmit alternativ në përgjithësi.</li> </ul> <p>Në angazhimin dhe në detyrim të rregulloreve, me qëllim përmirësimin e nivelit formues të programit të studimit, departamenti harton kurrikulën e studimeve. Modulet mësimore dhe veprimtaritë formuese që ofrohen në programet e studimit dhe kreditet për secilën prej tyre mund të rishikohen. Ndryshimet propozohen nga departamentit përkatës duke ndjekur instancat përkatëse deri në miratimin përfundimtar nga Senati Akademik i UBT_s, në rastin kur masa e ndryshimit të kërkuar nuk e kalon nivelin 20% (Aneks 12 Rregullore e FEA2017, miratuar më datë 29.09.2017, Neni 20, pika 3).</p> <p>Mbështetur në kurrikulat, në fillim të çdo viti akademik, departamenti harton planin mësimor të vitit i cili miratohet nga dekani i fakultetit dhe Rektori i Universitetit. Në planet mësimorë pasqyrohen disiplinat mësimore, raporti teori praktikë, numri i krediteve për secilën disiplinë, detyrimet mësimore për çdo disiplinë, mënyra dhe afatet e shlyerjes së detyrimeve, praktikat profesionale. Planet mësimore miratohen nga Dekani i FEA si edhe nga Rektori i UBT (Aneks 10 Rregullore e Programit të Studimit MTR, miratuar më datë 27.09.2017, Neni 9, Germa a dhe b).</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht ✓

<b>Standardi I.4</b> <b>Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.	<p>Universiteti Bujqësor i Kamzës pavarësisht faktit se është universiteti publik më i vjetër, përbën një IAL të mirëorganizuar midis njësisë bazë dhe brenda saj, duke treguar paralel me garantimin e cilësisë së produktit të nxjerrë në përputhje dhe përshtatje me standartet ndërkombëtare, edhe një efektivitet dhe operativitetet të funksionimit të tij. Rrjedhimisht përvoja dhjetëra vjecare tashmë e këtij institucioni është përcjellë në të njëjtin përkushtim që departamenti më i ri i tij tregon dhe demonstroi qartë përmes këtij programi studimi.</p> <p>Falë historisë së gjatë si institucion, traditës së krijuar në vite, nivelit të lartë të trajnimit të stafit me eksperiencë brenda dhe jashtë vendit dhe punës në UBT, universiteti ka krijuar në vite një staf kompetent, profesional dhe shumë të përgatitur (Aneks 26 Tabela Personel Akademik &amp; Ndihmës Akademik UBT2019)</p> <p>Realizimi i programi i MTR_s është i mbështetur nga staf akademik të vet departamentit të MTR_s si dhe të departamenteve të tjera pjesë e së njëjtës njësi kryesore (FEA). Ashtu si është pasqyruar edhe në të dhënat tabelore bashkangjitur propozimit të dekanatit të FEA dhe e dosjes së</p>





	<p>propozimit për hapjen e programit të MTR_s (Aneks 3 Hapja e Programit të MTR Fq. 11) si dhe në të dhënat e stafit akademik të sotëm të DMTR_s dhe të FEA_s, rezulton që stafi akademik i angazhuar në këtë program është profesional dhe i përgatitur.</p> <p>(Aneks 26 Tabela Personel Akademik &amp; Ndihmës Akademik UBT2019, (tabelë ku është përfshirë edhe stafi Akademik i FEA_s dhe i DMTR_s)</p> <p>(Aneks 30 Tabela e Stafit Akademik Program MTR_s2014-2019)</p> <p>(Aneks 31 Tabela e Stafit Akademik të DMTR_s 2014-2019) dhe</p> <p>(Aneks 32 Tabela Staf Akademik FEA_s)</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi i MTR ofrohet nga Departamenti i MTR i cili është njësi bazë e Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit (FEA) në përputhje me rregulloren e programit të MTR_s, rregulloren e brendshme të FEA_s.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- (Aneks 12 Rregullore e FEA2017, miratuar më datë 29.09.2017, Neni 6 dhe 21) dhe</li> <li>- (Aneks 7 Statuti UBT_Miratuar_2017, Datë 28.03.2017, Organigrama Fq 7)</li> </ul> <p>FEA si njësi kryesore, falë edhe departamenteve të tjera pjesë strukturore e FEA, ofron studimet e larta në nivelin 6, 7 dhe 8 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.- (Aneks 12 Rregullore e FEA2017, miratuar më datë 29.09.2017, Neni 16 dhe Neni 19, pika 3).</p> <p>Programi i studimit i MTR_s është program i ciklit të parë të studimit, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, organizohet me jo më pak se 180 kredite evropiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është tri vite akademike (Aneks 10 Rregullore e Programit të Studimit MTR, miratuar më datë 27.09.2017, Neni 9, pika 9). Ky përcaktim i programit të studimeve të MTR_s është bazuar dhe respekton nenin 70, pika 4 e Ligjit 80/2015, Miratuar 22. 07.2015).</p> <p>Programi i studimit të MTR është konceptuar dhe hartuar në përputhje me fushën akademike e kërkimore specifike të DMTR_s që është: "Menaxhimi i Turizmit Rural" (neni 9) dhe fushën e përgjithshme të fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit (neni 19, pika 3) që është ekonomia bujqësore.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;">✓</p>

### Standardi I.5

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
	<p>Universiteti Bujqësor i Kamzës pavarësisht faktit se është universiteti publik më i vjetër, përbën një IAL të mirëorganizuar midis njësisive bazë dhe brenda saj. Këtë organizim e reflekton:</p>






<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisve respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. ndarja midis fakulteteve dhe marrëdhëniet brenda tyre;</li> <li>2. delegimi dhe përcjellja e procedurave, analizave vjetore nga poshtë-lart-poshtë ka rezultuar mjaft eficiente për departamentet si njësi bazë dhe mjaft të rëndësishme për vetë këtë IAL.</li> </ol> <p>Mbarëvajtja dhe mbikëqyrja e programit të studimit bëhet në formë të koordinuar nga të gjitha instancat drejtuese të UBT. Janë një sërë zyrash dhe njësish përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit mësimor, si: ZSS; Sekretaritet e departamenteve, Zyra e Kurrikulave në Rektorat, Zv. Rektori për mësimin, etj. Një koordinim i punës së këtyre njësive ka sjellë një mbështetje të studimeve në këtë cikël.</p> <p>Realizimi cilësor i programeve mësimore dhe mirëfunksionimi i njësive mësimore shkencore e si rrjedhim mirëfunksionimi i institucionit është rrjedhim i bashkëveprimit të njësive dhe mirëorganizimit të tyre. <i>(Aneks 7 Statuti UBT_Miraturar_2017, Datë 28.03.2017, Kreu V, Nenet 25-28).</i></p> <p>Sipas rregulloreve si të FEA departamentete saj, janë të organizuara në grupe mësimore dhe kërkimit shkencor (GMK) <i>(Aneks 12 Rregullore e FEA2017, miraturar më datë 29.09.2017, Neni 6, Gërma c.)</i></p> <p>Në rastin e DMTR kemi shkruar e dy GMK që kanë ekzistuar deri në Dhjetor 2017, për arsye të plotësisht të kërkesave të Udhëzimit të "Ministritë së Arsimit Sportit dhe Rinisë" nr.13278 Prot, nr. 27 date 29.12.2017, e cili vendos kushtin që një GMK mund të krijohet kur ka akademik në përbërje të tij të paktën 5 anëtarë të stafit.</p> <p>Konsultuar me dokumentacionin, por vecanërisht nga vizitat në IAL, gjykohet se ka një ndërveprim dhe qasje mjaft pozitive të këtij departamenti me departamentet e tjera, jo vetëm në përputhje të plotësisht të misioneve dhe strategjive bazë të UBT në nivel institucioni, por edhe në përditshmërinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies, të përcjelljes dhe ndarjes së mendimeve në lidhje me studentët dhe përmirësimet e vazhdueshme që kjo njësi synon. Pra është e dukshme edhe tek stafi apo studentët ndërvarësia dhe marrëdhënia me departamentet e tjera brenda fakultetit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Megjithëse programi është relativisht i ri në treg, ka vërtetuar jo vetëm përkushtimin në ofrimin e një produkti sa më cilësor dhe në përputhje me tregun vendas dhe nevojat e biznesit, por edhe në mbështetje të plotë me fokusin ndërkombëtar. Një gjykim i tillë është bazuar jo vetëm mbi dokumentacionin e plotë dhe të larmishëm në lidhje me marrëveshjet ekzistuese ndërkombëtare, me sfidat e afërta me universitete të huaja tashmë të përmyllura apo në proces, por edhe me binjakëzimet që kanë rezultuar me diploma të dyfishta.</p> <p>Outputi i rezultuar nga analizat e përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve ka prodhuar një perceptim dhe gjykim cilësor për të gjithë punën masive të bërë deri tani dhe me sigurinë e përputhjes me tregun. Diskutimet mbi rritjen dhe vlerësimin e këtij programi dhe departamenti nuk janë pjesë vetëm e analizave të përvitshme apo periodike, por pjesë e integruar e shqetësimeve të përditshme të përgjegjësit të departamentit, stafit, deri të studentëve, e</p>



**Kriteri 3.** Në mënyrë periodike, njësisia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.

reflektuar kjo edhe në ndërgjegjësimin e tyre mbi vlerën e diplomës së tyre, rëndësinë e saj në tregun e punës apo optimizimin në lidhje me marrëveshjet ndërkombëtare.

Raportet me institucionet ndërkombëtare jo vetëm kanë rritur dhe përmirësuar imazhin dhe rëndësinë e këtij departamenti, por kanë ndikim direkt në promovimin, rritjen dhe ndërkombëtarizimin e të gjithë UBT.

Ndërsa raportet me institucionet dhe bizneset kombëtare mbeten prioritet, janë të shumta përpjekjet që bën i gjithë stafi i këtij departamenti i cili shfrytëzon lidhjet e veta edhe personale duke synuar të ofrojë vazhdimisht guest speaker të huaj apo vendas sipas fushave dhe moduleve përkatëse, t'u ofrojë studentëve përmes praktikave apo vizitave në biznese shqiptare rurale si laboratore kërkimi në terren, etj. Nga ana tjetër nga takimi me studentët rezultoi se këto takime me biznese vendase apo të ftuar të huaj e vendas kanë qënë mjaft eficiente dhe të kërkuara nga ato.

Institucionalisht UBT ka një numër të madh marrëveshjesh me këto institucione ku palët angazhohen për shkëmbim eksperience dhe ekspertize në funksion të përmirësimit të procesit mësimor dhe realizimit të objektivave të programeve të studimit, përmes identifikimit të kërkesave të tregut dhe mundësisë që studentët të prezantohen direkt me biznesin.

Një bashkëpunim të gjerë UBT ka edhe me aktorë biznesi brenda vendit, ku marrëveshjet e nënshkuara ju japin përgjegjësi palëve për tu dhënë mundësi studentëve të kryejnë praktika profesionale në këto biznese.

Panairi i karrierës që zhvillohet çdo vit në UBT është një HUB që sjell së bashku akademinë dhe biznesin dhe ku krijohen premiset për zgjerimin e bizneseve partnere me universitetin.

Programi i Menaxhimit Turizmit Rural që pas hapjes së tij në vitin akademik 2011-2012 ka funksionuar në mënyrë të pandërprerë dhe deri në këtë moment ka diplomuar pesë breza studentësh. Nga vlerësimet e bëra nga departamenti në analizat mësimore-kërkimore dhe nga opinionet e studentëve të programit, ky program ka rezultuar i suksesshëm dhe është vlerësuar: si në tregun e punës ashtu edhe në atë të studimeve të niveleve më të larta siç është ai i studimeve të nivelit të dytë të masterit. Studentë të këtij departamenti kanë rezultuar të suksesshëm edhe në universitetet e huaja ku ata kanë shkuar në kuadrin e shkëmbimeve bilaterale si në rastin e shkëmbimit të studentëve në kuadrin e marrëveshjes për diplomë të dyfishtë me Universitë Politecnica delle Marche, Itali ashtu edhe të shkëmbimeve Erasmus+ (*Aneks 4 Accordo Doppio Titolo Albania\_ Firmato, Datë 20.10.2014*) dhe (*Aneks 5 London Erasmus + Programme -03052018, Datë 02.05.2019*)

UBT, nëpërmjet Qendrës së Karrierës dhe Alumni (QKA), në ambientet e FEA-s, organizon Panairin e Karrierës, aktivitet i shndërruar në një traditë të suksesshme, pasi ai organizohet për të pestin vit radhazi. Kështu, psh në vitin 2018, në panair morën pjesë 51 sipërmarrje, Institucione Publike dhe Organizata të profileve të ndryshme. Përgjatë 5 panireve të organizuara, në total janë nënshkuar 43 marrëveshje midis UBT dhe sipërmarrjeve, Institucioneve Publike dhe Organizatave të ndryshme. Janë dhënë 60 certifikata mirënjohjeje për Bizneset bashkëpunuese me UBT. Në çdo panair,



	mbi 250 studentë kërkohen nga sipërmarrjet e pranishme për punësim dhe praktika profesionale.
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Praktika mësimore e studentëve të FEA realizohet në bazë të një marrëveshje institucionale ndërmjet Universitetit dhe institucionit pritës së studentit për ushtrimin e praktikës mësimore. Kjo marrëveshje formalizohet nëpërmjet nënshkrimit të kontratës përkatëse. Gjithashtu supervizori i studentit në institucionin pritës në fund të praktikës mësimore plotëson formularin e vlerësimit të studentit për ecurinë gjatë praktikës. Ky dokument së bashku me relacionin e vetë studentit për punën e kryer gjatë praktikës përbëjnë bazën e vlerësimit të tij gjatë mbrojtjes së praktikës përpara komisionit përkatës.</p> <p>Bazuar dhe konsultuar me dokumentacionin si: <i>(Aneks 40 Marrëveshje Bashkëpunimi Institucion UBT_Kërkim)</i> dhe <i>(Aneks 35 Lista e marrëveshje UBT me bizneset dhe institucionet, QKA)</i>, rezultojnë se marrëveshja për Diplomë të Dyfishtë firmosur midis Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT) dhe l'Università Politecnica delle Marche (UPM), (Facoltà di Economia "Giorgio Fuà") Italia, datë 20.10.2014 Nr. Protokolli 1775, përfshin edhe shkëmbime për kryerjen e praktikës profesionale prej tre muajsh në një ndërmarrje shqiptare për studentët italianë dhe në një ndërmarrje italiane për studentët shqiptarë që do përfshihen në programin e shkëmbimit (shih marrëveshjen në dy gjuhë italisht dhe shqip, <i>Aneks 4 Accordo Doppio Titolo Albania_firmato, Neni 2, Gërma a dhe b</i>);</p> <p>Marrëveshja midis UBT dhe CMB Albania SHPK, është një marrëveshje tjetër në të cilën parashikohen vizita, shkëmbime, asistencë studentëve dhe te praktikave të tyre mësimore me fokus shkëmbimin e studentëve <i>(Neni 1 i marrëveshjes, Aneks 38 Marrëveshje bashkëpunimi midis UBT dhe Carrefour date 25.04.2014, Nr. Protokolli 880)</i>.</p> <p>Gjithashtu ekzistojnë edhe shumë marrëveshje të tjera të realizuara nga UBT dhe QKA me institucione dhe biznese kombëtare dhe ndërkombëtare në funksion të realizimit të praktikave profesionale të studentëve të programeve të ofruara në UBT, në FEA dhe të programit të MTR në veçanti.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Duke ndërthurur edukimin me kërkimin shkencor dhe transferimin e njohurive të tretët, në nivel të lartë, UBT kërkon të përgatisë jo vetëm specialistë të kualifikuar të fushës së bujqësisë, të ushqimit dhe mjedisit, por edhe <b>qytetarë të përgjegjshëm në shërbim të shoqërisë</b> <i>(Aneks 8 Plani Strategjik UBT_Miratar, Qershor 2016, Misioni dhe Vizioni i UBT-s, Paragrafi 2, Fq 5)</i>.</p> <p>Në funksion të këtij qëllimi, por jo vetëm, institucioni angazhon edhe zyrat mbështetëse si p.sh. zyra e karrierës e cila përmes organizimit të ALUMNI, mbajtjes së marrëdhënieve me studentët përmes përdorimit të gjurmimit të tyre si instrument vlerësues dhe matës sasior, mundohet nga njëra anë të vlerësojë dhe të sigurohet për cilësinë e transmetuar të dijeve dhe përputhjes së tyre me atë cka kërkon tregu, por edhe të përdorë si aset studentët e diplomuar por të pozicionuar në drejtime të rëndësishme dhe strategjike. Pavarësisht sfidave që kjo zyrë përballet, qënësia e saj, mbështetja që i jepet studenteve aktuale apo ato të diplomuar, si dhe marrëdhëniet brenda vetë IAL i i kanë pozicionuar tashmë si mjaft jetike dhe strategjike për të gjithë IAL.</p>





	<p>Nga ana tjetër, në kushtet kur vetë departamenti që ofron programin bën përpjekjet e veta për të optimizuar mbështetjet e mëtejshme për studentët e diplomuar, rezultati është i dukshëm dhe premtues për të ardhmen. Qendra e Karrierës dhe Alumni e UBT dhe ZKS e FEA në bashkëpunim me departamentet dhe Forumin Ekonomik Studentor të FEA realizojnë trajnime të shkurtra të aftësisimit të mëtejshëm të studentëve dhe të diplomuarve (<i>Aneks 14 Raport Performanca e QKA 2018, Tabela 1 Fq 5-7</i>)</p> <p>Përfshirja e studentëve përmes skemave të trajnimeve (AZHBR) dhe përfshirjes aktive bashkë me stafin në projekte kombëtare konsiderohet dhe vlerësohet mjaft përfitues dhe eficient nga studentët por edhe stafi.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓
<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programet e studimit, si i tillë edhe programi i MTR duhet të organizohen sipas ligjit në lëndë e module ku secila vlerësohet me kredite sipas sistemit ECTS. Në këtë kontekst programi MTR është në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke ofruar një tërësi prej 23 lëndë e module të detyrueshme, tre module me zgjedhje si edhe praktikën mësimore dhe tezën e diplomës, me një total prej 180 kreditesh përmes një shpërndarjeje prej 60 kredite në vit.</p> <p>Bazuar mbi një sërë dokumentash duke filluar që me <b>hapjen e programit të studimit, vendimet përkatëse dhe pikat mbi organizimin e programit si edhe më tej me dokumentat e programit mësimor dhe planit mësimor, dhe rregullore e programit të studimeve</b>, ka një shpërndarje sipas ligjit e moduleve dhe e krediteve, gjithashtu duke parashikuar sipas standarteve orët fizike, orët në auditor (leksione, seminare, praktika mësimore) dhe ato të studimit individual, orë për praktikën në terren apo përgatitjen e temës së diplomës. Duket një ndarje e qartë sipas ligjit e moduleve sipas veprimtarive formuese, të formimit të përgjithshëm, karakterizuese, të ngjashme të lidhura me disiplinat karakterizuese, modulet me zgjedhje. Programet e moduleve përmbajnë informacionin e domosdoshëm dhe të nevojshëm në formën e syllabuseve me elementët informues dhe shpjegues të cilat janë referuar në dokumentin “Udhëzues për studentët”, version shqip, viti akademik 2012-2013. <b>Këtu mund të sygjerohet një rifreskim i guidës në të ardhmen me ndryshimet e realizuara për tu përshtatur me tregun.</b></p>



	<p>Duhet vënë në dukje se ka patur edhe ndryshime të miratuara gjatë viteve dhe konkretisht me <b>Vendim të Dekanatit të dt 29.09.2017</b> janë miratuar ndryshimet e propozuara nga departamenti, për të rritur numrin e moduleve me zgjedhje, në mënyrë që të unifikohen politikat e shpërndarjes së moduleve në programet e ndryshme të studimit brenda FEA. Ndryshimet gjithashtu pasqyrojnë kërkesat ligjore dhe kriteret e programit të studimit, ndërkohë që krijojnë mundësi për përshtatje me kërkesat e tregut duke krijuar fleksibilitet dhe duke iu përgjigjur kërkesave të studentëve për shkak të shtimit të moduleve me zgjedhje.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Duke iu referuar programit të studimit, përshkrimi të detajuar të moduleve, mund të thuhet se ka një shpërndarje të duhur të dhënies së njohurive për të krijuar specialistët e duhur në fushën e turizmit rural. Llojshmëria e specialitetëve brenda kësaj diplome mbështetet nga llojshmëria e fushave brenda menaxhimit të turizmit rural, si modulet e formimit bazë, mikroekonomi, makroekonomi, prodhimi bimor dhe shtazor, statistika dhe matematika e biznesit, turizmi dhe marketing, burimet njerëzore, shkenca ekonomike, zhvillimi i qëndrueshëm, administrim dhe drejtim, strategji dhe politika, fusha e mjedisit, ekosistemeve. Pra duket shpërndarja e moduleve për tu dhënë mundësi studentëve që përgjatë periudhës së studimeve të marrin njohuri të shumëllojshme në të gjitha degët e lidhura me diplomën – ekonomi e përgjithshme, turizëm, menaxhim, administrim dhe politika, marketing. Në këtë mënyrë profesionistët e ardhshëm marrin bazat për të ndërtuar njohuritë në të tashmen duke u diplomuar si Ekonomist në degën “Ekonomi dhe Agrobiznes” në profilin e menaxhimit rural. Më tej këto baza do të shërbejnë për të mbështetur specialitetet në të ardhmen duke u fokusuar në tregun e punës si specialist i turizmit rural.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Një aspekt tepër i rëndësishëm dhe themelor në vlerësimin e efektivitetit të cdo programi studimi është mënyra se si ai formon studentët në të menduarin kritik dhe vlerën që ka si në aspektin teorik dhe atë praktik. Në dokumentacionin e ofruar, mund t’i referohemi <b>syllabuseve të detajuara</b>, konkretisht rubrikës, përmbledhje dhe rezultatet e të nxënës, paraqitjes së objektivave dhe synimeve të cdo lënde, ku referohet fusha përkatëse e studimit, mundësitë e përfshirjes së njohurive në tregun e punës, kompetencat të cilat do të duhet të fitojë studenti që përfshijnë krahasime, analiza dhe qasje kritike të njohurive. Gjithashtu vizitat në terren, specifikuat intervistat me pedagogët nga njëra anë dhe studentët nga ana tjetër, treguan dhe identifikuan metodat e përdorura nga pedagogët gjatë procesit të mësimdhënies, ku përdorimi i ndërveprimit, komunikimit dhe dialogut, ndikon në formimin e të kuptuarit dhe të menduarit kritik mbi njohuritë e marra.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i MTR krijon, siç u argumentua edhe më lart kompetencë në mënyrë të vetme në treg lidhur me një fushë ndërdisiplinare që përfshin turizmin dhe agrikulturën. Në këtë kontekst, njohuritë e kërkuara nga tregu dhe të propozuara nga ky program krijojnë mundësi unike për formimin e profesionistëve në një fushë sa profesionale, aq edhe kërkimore e akademike, duke patur parasysh ecurinë dhe zhvillimin e tregut të turizmit shqiptar dhe zhvillimin e vendit tonë mbi shumë resurse buqësore e blegtorale. Këto mundësi bazohen në metodat e propozuara për mësimdhënie dhe kërkim, si edhe evidentimi përmes kontrolleve dhe diskutimeve i cilësisë në procesin e mësimdhënies (dokumenti mbi analizën e punës mësimore dhe vizitat në institucion në pyetjet me studentët shërbyen si mbështetës, përveç analizës së moduleve dhe syllabuseve përkatëse). Njohuritë,</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)





	<p>aftësitë dhe kompetencat e avancuara dhe zgjidhja e problemeve komplekse janë elementë të evidentuar në <b>temat e programit për secilën lëndë, por sidomos edhe në literaturat e propozuara</b> të cilat evidentohet të jenë bashkëkohore dhe të përshtatura me module e programe të ngjashme. Të dhënat mbi stafin përgjegjës për modulet evidentojnë më tej dhe mbështesin kapacitetin e programit për të dhënë këto njohuri të avancuara, duke iu referuar artikujve, studimeve dhe referimeve kombëtare e ndërkombëtare që profesorati ka bërë në fushat përkatëse, në botime me standarte shkencore (bord, ISBN, ISSN), në vende të ndryshme të rajonit, por edhe pjesëmarrje në projekte kombëtare e ndërkombëtare. Kjo u evidentua edhe gjatë vizitave në terren, ku disa pedagogë përmendën mënyrën se si i përfshijnë studimet e tyre gjatë procesit të mësimdhënies dhe komunikimit me studentët, dhënies së detyrave etj.</p> <p>Nëse do t'i referohemi edhe listës së temave të diplomave të studentëve dhe listës së kompanive të miratuara për praktikat mësimore, këto janë argumenta shtesë për rritjen e kapaciteteve të programit për t'iu ofruar studentëve më shumë mundësi në zgjerimin e aftësive për problem -zgjidhje dhe njohuri të kualifikuara.</p> <p>Intervista me GVB, stafin dhe studentët e evidentoi njëkohësisht edhe pjesëmarrje të studentëve në programe kombëtare që përfshijnë turizmin rural, si ai i 100 fshatrave, promovimi i turizmit në Shqipëri si dhe projekte ndërkombëtare si projekti "Gradua", elemente që rritin mundësitë praktike të studentëve për të zgjidhur problemet dhe për tu specializuar në fushën përkatëse të turizmit rural.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Struktura e programit MTR është në përputhje të plotë me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe aktet nënligjore përkatëse, duke përfshirë një tërësi lëndësh formuese dhe specializuese për studentët. Gjithashtu programi është saktësisht i shpërndarë me ngarkesat përkatëse sipas formave të zhvillimit të njohurive, leksione, seminare, laboratore, praktika mësimore, temë diplome. Evidentimi është i qartë përmes planit të detajuar dhe rregullores së programit të studimit.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit, duke u bazuar edhe në Vendimin nr 41, dt 24.01.2018, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë" specifikisht neni 8 paraqiten, grupet e klasifikimit të veprimtarive formuese, të pasqyruara në programin e studimit dhe planet mësimore dhe kurrikulën. Ky klasifikim përfshin modulet e disiplinave të formimit të përgjithshëm, karakterizuese, të ngjashme me ato karakterizuese, modulet e disiplinave me zgjedhje dhe ato të gjuhës së huaj e praktikave, sipas VKM të sipërcituar. Përshtatja e moduleve me kategoritë paraqitet edhe përmes programeve, përmbajtjes, synimeve e objektivave, temave, krediteve, element të cilët janë shpjegues për përfshirjen e secilit modul në kategorinë përkatëse.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				✓

<p><b>Standardi II.2</b></p>	
<p><b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit,</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit FEA, pranë UBT, është njësia kryesore, e strukturuar për të ofruar programe studimi në tre ciklet, bachelor, master, doktoraturë, në përputhje me llojin e institucionit të arsimit të lartë dhe bazuar</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)






përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	mbi Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Bazuar në dokumentat e Strukturës organizative, Statutit dhe rregullores së UBT, si edhe bazuar mbi kërkesat ligjore, pranohet se njësia kryesore – fakulteti përmbush detyrimet ligjore përkatëse. -Ai përbëhet nga 6 Departamente të mirëstrukturuar, ku gjithashtu përcaktohen diplomat që lëshojnë, stafi akademik dhe gjithë elementët e nevojshëm. Në këtë kuadër ofrohet edhe diploma e MTR, nga Departamenti i Menaxhimit të Turizmit Rural, (DMTR) si një nga departamentet e këtij Fakulteti. (Aneks 28 FEA organigrama 2019). Për nga numri dhe kualifikimet e stafit akademik, ndërtimi i strukturave dhe zbatueshmëria e ligjit dhe akteve nënligjore, DMTR përmbush plotësisht detyrimet ligjore.			
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.	Koordinatori i programit të studimit paraqitet të jetë përgjegjësi i departamentit, duke qenë se ka një numër stafi që nuk përmbush kushtet për dy GMK, por gjithashtu duke qenë se departamenti ofron vetëm diplomën e MTR dhe nuk ofron diplomë tjetër. Titullari i departamentit duke qenë përgjegjës për propozimet lidhur me programet mësimore, ndryshimet, propozimet dhe miratimet e programeve, syllabuseve dhe të gjitha aktiviteteve për menaxhimin e kurrikulës dhe mbarëvajtjen e punëve Brenda GMK të departamentit, merr natyrshëm edhe rolin e koordinatorit. <u>Sygjerojmë që në të ardhmen të ketë një vendim formal, për të paraprirë zgjerimin apo zhvillimin e departamentit për ofrimin e diplomave të tjera në të ardhmen.</u>			
<b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Organizimi i njësisë kryesore në departamente, stafet akademike përkatëse për secilin departament përmbushin detyrimet ligjore. Stafi i departamentit përbëhet nga 8 pedagogë dhe ky përbën gjithashtu edhe një GMK dhe si rrjedhim nuk ka organizim të mëtejshëm në GMK. (Aneks 32 Lista e Stafit FEA, viti akademik 2018-2019, Aneks 31 – lista e stafit DMTR 2014-2019). Struktura mësimore dhe akademike përbën një element të rëndësishëm në mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe është e garantuar përmes të gjithë dokumentacionit mbështetës (Aneks 47 Struktura e programit MTR) Si rrjedhim mund të themi se detyrimet ligjore lidhur me organizimin dhe strukturën akademike janë të përmbushura plotësisht.			
<b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.	Organizimi dhe struktura përmbush kushtet ligjore edhe lidhur me njësinë bazë, departamentin, duke qenë se tejkalon kushtin minimal për të patur një numër personeli prej 3 vetësh me tituj e grada. Stafi i departamentit përbëhet nga 8 pedagogë prej të cilëve 2 me gradën Profesor, 2 Profesor i Asociuar, 2 me gradën Doktor i Shkencave dhe 2 pedagogë me Master shkencor. Gjithë stafi akademik i përmbush kushtet për titujt dhe gradat shkencore krahasuar me lëndët, modulet dhe ngarkesën mësimore shkencore që u është përcaktuar. (Aneks 33 Ngarkesa e stafit akademik të MTR dhe DMTR 2019).			
<b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht ✓

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ndërtohen bazuar në gjithë informacionin mbi programin e studimit, stafin akademik dhe strukturat e njësive kryesore dhe njësive bazë. Linja e informacionit lëviz sipas hierarkisë, duke marrë si input dokumentat kryesore në nivel Institucional, ku përfshihen, ligje, vendime, udhëzime rregullore, statuti, të cilat vijnë të protokolluara dhe sipas afateve nga rektorati, përcillen në dekanat, i cili realizon detyrat e tij, miraton rregulloret përkatëse dhe përcjell informacionin mbi vendimet dhe vlerësimet në të dy drejtimet. Rregullorja është</p> <p><i>Përcjellja dhe disponimi i informacionit në funksion të mirëorganizimit dhe strukturës parashikohet në disa dokumenta themelore si në planin strategjik të institucionit, në manualin e cilësisë (Aneks 10 rregullorja e programit të studimit)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Bazuar mbi synimet dhe objektivat e programit të studimit MTR, të cilat përfshijnë ofrimin e njohurive dhe krijimin e aftësive e kapaciteteve të studentëve mbi shkenat e ekonomisë bujqësore dhe sidomos ekonomisë turistike bujqësore e rurale, ky program ka ndërtuar edhe përmbajtjen e tij duke klasifikuar modulet apo lëndët në aktivitete formuese dhe aktivitete praktike. Praktikave mësimore iu është dhënë ngarkesa e parashikuar ligjore prej 12 kredite duke i lejuar studentët që semestrin e fundit të realizojnë aktivitetin e praktikës mësimore, por nga ana tjetër edhe në cdo modul mund të evidentohet përmes syllabusit se i lihet një hapësirë pjesës praktike lidhur me projektet konkrete të kursit. Raporti i moduleve e aktiviteteve formuese si edhe atyre praktike është në përputhje me bazën ligjore në fuqi, vendimet dhe udhëzimet. Evidencat janë në programin, kurrikulën dhe strukturën mësimore, si edhe në marrëveshjet e bëra për qëllim të zhvillimit me sukses të praktikës mësimore me biznese të përshtatshme turistike apo agrare, rurale. (Aneks 34 kurrikula e programit, Aneks 47 struktura e programit)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Programi i studimit MTR bazohet në sistemin e vlerësimit me kredite ECTS, sistem i cili është pranuar gjerësisht në nivel Europian dhe në nivel kombëtar, duke krijuar mundësinë e krahasimit të ngarkesës së nevojshme për realizimin e një programi studimit dhe secilës lëndë dhe/ose modul. Numri i krediteve për secilën lëndë/modul, për secilin grup/kategori modulesh duke u bazuar tek lloji i disiplinës, paraqet gjithashtu një kornizë të krahasimit të moduleve dhe i krijon mundësinë studentit të kuptojë ngarkesën dhe punën e tij semestrare dhe vjetore. Ai gjithashtu pasqyron kritere për kalimin e të gjitha provimeve dhe performancën e studentit në vitin akademik, duke kaluar në një vit pasardhës apo duke përfunduar studimet. (Aneks 11 rregullore e brendshme e DMTR, Aneks 10 rregullore e programit MTR)</p> <p>Konkretisht ndarja në vite e semestra është sipas një balancimi me 180 kredite në tre vite të ndara me 60 kredite në vit (Aneks 20 rregullore e programit të studimit, Aneks 43 plani mësimor MTR). Viti akademik</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



	<p>përbëhet nga dy semestra, ku janë shpërndarë në mënyrë të balancuar, por jo të parabartë, ngarkesa e krediteve të lëndëve në cdo semestër. Lëndët dhe shpërndarja e tyre me kreditet, orët mësimore në auditor dhe jashtë auditorit, pasha që zënë modulet e kategorive të ndryshme janë në zbatim të vendimit nr 41 dt 24.01.2018, udhëzimeve të MASR dhe rregulloreve të institucionit dhe programit.</p> <p>Modulet ndahen sipas kategorive ku ka një përqindje të lejuar për secilën kategori e ilustruar në (Aneks 45 Kategorizimi i lëndëve bachelor). Konkretisht Lëndët bazë 16,6%, Lëndët karakterizuese 50%, lëndët e ngjashme me lëndët karakterizuese 13,9%, lëndë plotësuese 14,4% dhe diploma 5%. Në këtë mënyrë përmbushet kriteri ligjor mbi shpërndarjen sipas disiplinave.</p> <p>Dokumentat ku mund të verifikohet ndarja sipas krediteve dhe ngarkesave janë:</p> <p>Aneks 34 kurrikula mësimore Aneks 43 plani mësimor Aneks 45 kategorizimi i lëndëve bachelor Aneks 47 struktura e programit Aneks 15 Syllabuset e programeve</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Kurrikula dhe plani mësimor janë dokumente themelore që shoqërojnë programin e studimit MTR që prej propozimit fillestar (Aneks 3 hapja e programit). Plani mësimor është përfshirë në Aneksin 43, hartohet nga departamenti bazuar mbi kurrikulën dhe miratohet nga dekani. Ai përfshin informacionin mbi</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• ngarkesën mësimore,</li> <li>• raportin e orëve leksion seminar (kryesisht në raportet 3/2, 2/2, 2/1, 0/2),</li> <li>• raportin e praktikës në pikëpamjen e projekteve me teorinë, ku përcaktohen lëndët që kanë detyrim me projekte,</li> <li>• mënyra dhe koha e kontrollit, duke përcaktuar raportin e vlerësimit gjatë vitit dhe atë përfundimtar, formën e vlerësimit-, kryesisht me provim me shkrim, në pak raste me provim me gojë.</li> </ul> <p>Paraqitet gjithashtu edhe plani i detajuar i ngarkesës sipas pedagogëve. ngarkesën minimale prej 295 orë e ka përgjegjësi i departamentit, dhe gjithashtu pedagog i brendshëm me gradën Master, duke përfshirë këtu ngarkesën dhe mbingarkesën e lejuar, ndërsa ngarkesa maksimale është prej 360 orësh të ndara në dy semestra leksione dhe seminare.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Informacionet për studentët lidhur me programin e studimit janë të paraqitura në Web-site të UBT dhe faqen e Fakultetit dhe Departamentit dhe jepen në dy dokumentat themelore, rregulloren e programit dhe rregulloren e departamentit. Në të dyja këto dokumente jepet gjithë informacioni se si pranohen studentët në secilin cikël të studimeve, informacion mbi transferimet, ndërprerjen e studimeve apo se si ekuivalentohen studimet (nenet 14, 15, 16, 17, 18, 19, rregullorja e DMTR). Sa i përket pranimeve, transferimeve dhe ekuivalentimit sqarohet në rregullore me qartësi se cilat procedura do të duhet të ndjekë student,</p>





	<p>cilat janë rastet përjashtimore, si do të ekuivalentohen programet dhe vlerësohet performance në institucionin nga vjen.</p> <p>Programet dhe kriteret e pranimit janë transparente për studentët jo vetëm në Web-site të UBT, por edhe në portalin U-albania, por kjo garantohet nga MASR. Gjithashtu dokumentat strategjikë statute dhe strategjia e UBT japin informacionin e përgjithshëm mbi studentët duke i udhëzuar ata përgjatë periudhës së studimeve.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Kurrikulat mësimore dhe planet mësimore shoqërohen çdo fillim viti akademik me programet e lëndëve të cilat kanë një strukturë të qartë dhe përmbajnë informacionin e domosdoshëm për studentin që të ndjekë me sukses kursin e modulit/lëndës gjatë semestrit/vitit. Programet e lëndëve i formojnë studentët në fushën e zhvillimit rural të menaxhimit të politikave të zhvillimit të qëndrueshëm, zhvillimit rural dhe agro turizmit. Për të dhënë këtë formim patjetër themelore janë programet e lëndëve dhe syllabuset, të cilat përmbajnë informacionin e detajuar mbi ngarkesën, tipologjinë, vitin akademik, llojin e lëndës, kodin, informacion mbi titullarin dhe konkatin, përmbledhjen dhe rezultatet e kërkuara nga lënda, temat dhe çështjet e detajuara për secilën temë, literaturën për secilën temë, sipas kërkesave të VKM përkatëse, formën e kontrollit dhe literaturën finale (aneks 15 Syllabuset e programit të MTR). Ato janë të pasqyruara edhe në faqet personale të pedagogëve në Web-site e UBT, shoqëruar edhe me informacion shtesë mbi detyrat, praktikën, CV e pedagogut, mënyrën e komunikimit etj, gjë që garanton transparencën dhe mirëinformimin e studentëve.</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Ndryshimet e programeve ndodhin në mënyrë të përvitshme sipas rregullores së programit dhe fakultetit (Aneks 12 Rregullore e FEA). Ky është një proces që ndodh natyrshëm dhe nuk ka një dokument që identifikon ndryshimet, por ky kriter është verifikuar edhe nga pyetjet në vizitat në terren dhe sidomos intervista me pedagogët e departamentit dhe të programit. Procedura e përshkruar lidhur me informimin e studentëve mbi elementët e programit, përfshinte përditimin e programeve çdo vit, duke sjellë ndryshime sipas rastit minore apo më të mëdha, lidhur me shtesa në literaturë, ndryshime në disa tema, apo shtesa në çështje.</p> <p>Ndryshime të programit akademik kanë ndodhur vetëm një herë, duke qenë se është program relativisht i ri, nuk ka nevojë për ndryshime të mëdha pasi është bazuar në programet bashkëkohore, por vetëm ka realizuar disa përshtatje me pjesën tjetër të programeve.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓



<b>Standardi II.4</b>	
<b>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxëniet dhe vazhdimet të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Duke iu referuar Ligjit 80/2015 “Për arsimin e Lartë në RSH”, neni 70 pika 4, programet e studimit në Institucionet e Arsimit të Lartë organizohen në tre cikle të njëpasnjëshëm, i parë, i dytë dhe i tretë, sipas nivelit 6-8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Rregullorja dhe Statuti i UBT parashtrajnë se ofrohen programe të studimeve në tre cikle, si dhe diploma profesionale të nivelit 5 të Kornizës. Ndërsa diploma e MTR përfshihet në nivelin 6 të Kornizës së Kualifikimeve, sipas rregullores së programit MTR. Ngarkesa e programit përmban 180 kredite të shtrira përgjatë tre viteve, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Ngarkesa në orë mësimore dhe orë jashtë auditorit gjendet në Aneks 43 plani mësimor i MTR.
<b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	Emërtimi i diplomës së MTR është specifikisht i përcaktuar në dokumentin e krijimit, në dokumentin e kurrikulës, programit mësimor, planit, rregulloreve përkatëse si edhe moduleve të lëndëve. Ky program diplomon studentë në fushën e menaxhimit të turizmit rural. Modulet / lëndët janë në funksion të krijimit të aftësive dhe njohurive e kapaciteteve si ekonomistë nga njëra anë dhe si specialist menaxhimi të sektorit bujqësor nga ana tjetër. Këto disiplina që ndërthurin ekonominë, turizmin dhe bujqësinë kanë një pikë fokale, pikërisht ndërthurjen lidhur me turizmin si një sektor i ekonomisë dhe biznesit që lidh aspektet menaxheriale me ato bujqësore. Përsëri edhe këtu planet mësimore dhe anekset lidhur me programet e syllabus japin një panoramë të kontributit të secilës lëndë e secilit program në formimin e studentëve. Lidhur me kontributin që programi është ndërtuar të japë tek krijimi i aftësive specifike dhe profesionale si dhe nevoja për këto kontribute, është treguar në Aneks - hapja e programit të studimeve dhe Aneks 17- studim tregu 2011. Përveç njohurive dhe aftësimit të studentëve në një fushë specifike sic është Turizmi Rural, emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive japin mundësi punësimi, sidomos në kushtet e Shqipërisë ku turizmi është një sektor prioritar për ekonominë dhe punësimin, dhe aq më tepër turizmi i lidhur me agrikulturën, në format e fermave agro-turistike po marrin një zhvillim të konsiderueshëm, falë edhe politikave nxitëse të qeverisë në këtë drejtim. Nga vizitat në institucion, specifikisht nga intervistat me pedagogët dhe studentët u identifikua se një shembull ka qenë programi “Akademia 100+ fshatrat”, ku synimi ishte pikërisht lidhja e Institucioneve të Arsimit të lartë, studiuesve dhe sidomos rinisë studentore në fushat përkatëse të studimit, prej të cilave edhe bujqësia dhe Turizmi, me realitetin rural në Shqipëri, për të sjellë ndryshimin në këtë realitet, në ekonominë rurale. Programe të tjera si ai IPARD i BE, apo programet kombëtare të AZHBR kanë përfshirë studentë dhe pedagogë të UBT duke krijuar oportunitete për një lidhje të ngushtë me tregun në vazhdimësi. Disa dokumenta që argumentojnë punësimin e studentëve dhe mundësimin e aftësive në shërbim të punësimit lidhen me procesin e gjurmimit të studentëve dhe QKA, specifikisht Aneks 13/1, 13/2 de 14 dhe Aneks 22.



	Bazuar në shifrat e gjetura, ndikimi i programit në aftësimin për punë dhe mundësitë për punësim është pozitiv dhe i gjurmueshëm. Programi ka ndërtuar struktura për ta gjurmuar në vazhdimësi këtë ndikim.
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Më lart u evidentua mënyra e shpërndarjes së krediteve në vite, vlerësimi në kredite e orë mësimore. Aneks 10, 12 dhe Aneks 43 janë dokumente bazë që tregojnë këtë shpërndarje. Ndikimi i saj në arritjen e objektivave formuese të programit të studimit mund të analizohet bazuar në këto dokumenta. Në rregulloren e studimeve të programit shprehen qartë objektivat e programit në aspektin e formimit të specialistëve të aftë për të menaxhuar bizneset e turizmit rural dhe agroturizmit. Kjo bëhet e mundur përmes dhënies së një ngarkese të konsiderueshme të moduleve karakterizuese dhe të ngjashme me ato karakterizuese, ku pjesa e këtyre moduleve të lidhura specifikisht me turizmin rural zënë rreth 43-45 kredite nga rreth 100 kredite që kanë gjithsej këto dy grupe modulesh, që përbëjnë edhe thelbin e diplomës. Pra rreth 45% të moduleve e zënë module të tilla si ekonomi e burimeve natyrore dhe mjedisit, zhvillim rural i qëndrueshëm, Ekonomi turizmi, Sip dhe drejtim i biznesit të vogël, administrim i fermave, strategji dhe politikat e turizmit, prodhim bimor e shtazor etj. gjithashtu në disiplinat me zgjedhje janë vendosur module të cilat janë me vlerë për punësimin si menaxhim karriere / Njohuri mbi informacionin, Pyjet, peisazhet dhe parqet / e drejtë mjedisore, që edhe nëprogramet e tyre dukshëm mbështesin procese të punësimit të studentëve. Shpërndarja e moduleve është bërë jo vetëm konform akteve nënligjore, por gjithashtu në përputhje me arritjen e objektivave të programit të studimit.</p> <p>Departamenti gjithashtu zhvillon një analizë vjetore mësimore, ku jepen rezultatet e studentëve dhe rezultateve të punës mësimore kërkimore të pëdagogëve dhe departamentit (Aneks 25 Raporti i analizës kërkimore mësimore MTR 2017-2018). Krahasime bëhen dhe me raportin në nivel institucioni (Aneks 54 Analiza mësimore UBT 2016-2017). Analiza tregon se janë arritur objektivat e formimit të programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë, është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përfaqëson me programe të ngjashme ndërkombëtare</p>	<p>Struktura e programit, lëndët dhe emërtimet përkatëse, ngarkesa në kredite, si edhe raporti teori praktikë janë në përputhje me profilin e programit MTR (Aneks 10, Aneks 12, Aneks 43, Aneks 47).</p> <p>Sa i përket ngjashmërisë me programe ndërkombëtare, duhet theksuar se ideja fillestare për krijimin e kësaj diplome ka ardhur si rrjedhim i bashkëpunimit me Universitetin e Marche në një program ndërkombëtar. Fillimi i këtij bashkëpunimi ka rezultuar i suksesshëm pikërisht në ndërtimin e diplomës së MTR, gjithashtu e njohur ndërkombëtarisht, ku diploma është një diplomë e njohur ndërkombëtarisht. Studentët që realizojnë studimet në të dy programet, përkatësisht në MTR në UBT dhe në Diplomën trevjecare në shkencë ekonomike dhe të ndërmarrjes në Universtetin Politeknik të Marche, marrin diplomë të dyfishtë. Kjo është bazuar në marrëveshjen nr 1775 datë 20.10.2014 Midis UBT dhe Universtetit Politeknik të Marche në Itali. (Aneks 4 Acordo doppio titolo Albania, Aneks 41, Aneks 42, diploma dhe supplement diplome Xh. T – shembull i një studenteje që ka realizuar eksperiencën dhe ka marrë diplomën e dyfishtë).</p>






<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Disa dokumenta janë në dispozicion për të identifikuar mundësitë që ndërtimi i programit lejon për mobilitete, transferime dhe punësim në përfundim të studimeve.</p> <p>Aneks 25 i analizës mësimore të programit evidenton se si ndarja e veprimtarive formuese ka ndikuar në arritjen e objektivave të programit. Aty analizohet gjithashtu raporti teori/praktikë si një element i domosdoshëm për mbarëvajtjen e programit. Nevoja për shtim të kapaciteteve lidhur me praktikën mësimore del nga intervistat në institucion, si me departamentin edhe me studentët, por evidentohet fillimi i një praktike të mirë për t'i nohur studentët edhe gjatë zhvillimit të moduleve me strukturat agro-turistike, në udhëtime që lidhen me praktikën (udhëtim tek Mrizi i Zanave për të parë nga afër procesin e një agro-turizmi të mirëfilltë në Shqipëri). Kërkohej nga studentët që këto praktika të shtohen në të ardhmen dhe kjo planifikohet gjithashtu nga departamenti, por duke kapërcyer vështirësitë logjistike.</p> <p>Arritja e objektivave formues – tregohet në vijimësinë e studimeve, ku sipas raportit të regjistrimit në studimet Master (Aneks 56/2) pjesa më e madhe e studentëve të diplomuar kanë vazhduar studimet në nivelin Master profesional MTR dhe pjesa tjetër më e vogël kanë vazhduar në degë të tjera. Lidhur me mobilitetet e studentëve, lëvizjet e disa prej tyre që merren si shembull në Universitetin Politeknik të Marche kanë qenë rezultative lidhur me përfundimin e studimeve dhe marrjen e diplomave. Nuk evidentohen mobilitete të tjera të studentëve, por vetëm mobilitete të pedagogëve në kuadër të programit Erasmus Plus. Megjithatë në Aneks 5, evidentohen kreditet e lëndëve të cilat shërbejnë si bazë për mobilitetet, pra dhe mundësia për njohjen e tyre duke facilituar proceset e mobiliteteve.</p> <p>Regjistrimet e studentëve në Web parashikohen me një proces shumë të qartë i shpjeguar në aneks 57/8 – manual se si regjistrohen studentët në vitin e parë. Procesi i regjistrimit ka rëndësi pasi është prezantimi i parë i studentit me institucionin dhe në këtë rast procesi është pozitiv. Vec aneksit, një shpjegim i detajuar u dha edhe në takimin me përgjegjësin e ZSS i cili tregoi procedurat deri në dhënien e aksesit të studentit në sistem. Disa nga procedurat janë informatizuar në dy vitet e fundit, sidomos ajo e pagesave dhe faturave, për të reduktuar burokracitë dhe kohën e pritjes.</p> <p>Transferimet, cregjistrimet janë paraqitur në Aneks 57/1/2/3, ku jepet numri i studentëve që kanë ndërmarrë këto veprime, cregjistrimet janë në nivel të ulët krahasimisht me gjithë fakultetin (16 nga 109 që nga 2014, ndërkohë që studentë të ardhur me transferim janë 5 nga 106, pra përsëri një numër i vogël. Sidoqoftë shifrat tregojnë se ka mundësi transferimi, cregjistrimi apo regjistrimi, bazuar mbi programet. Nuk ka një raport cilësor lidhur me vështirësitë apo problemet gjatë procesit të transferimeve, ekuivalentimet e lëndëve përkatëse apo të tjera pjesë të procesit, por ky proces realizohet.</p> <p>Mundësitë e punësimit të studentëve pas diplomimit evidentohet kryesisht në Aneks 14 performance e QKA 018, Aneks 18 Raport vlerësimi i Panairit të karrierës 2014. Këto dokumenta tregojnë për marrëveshjet me bizneset për internship dhe punësim të mundshëm të studentëve dhe përfshirjen e</p>
---	---





	bizneseve e cila është në rritje. Megjithatë nuk ka të dhëna të sakta mbi punësimin aktual të studentëve pikërisht në këtë program studimi.
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Në aneks 15 tek programet dhe syllabuset e lëndëve ka ndryshime bazuar në urdhëresat dhe kërkesat e vetë pedagogëve për përshtatjen me literaturën bashkëkohore. Çdo fillim viti akademik bëhen ndryshimet përkatëse dhe ruhen në departament nga stafi mbështetës. Procesi përfshin rishikim, ndryshime dhe shtesa në të gjitha seksionet e programeve, syllabuseve të lëndëve. Shihet se janë zbatuar udhëzimet e fundit të MASR për të riformatuar programet me literaturë në çdo teme dhe jo vetëm në fund të programit.</p> <p>Evidence për këtë pikë janë gjithashtu edhe analiza mësimore (aneks 25), anketat e studentëve, të cilët pyeten mbi cilësinë edhe lidhur me ndryshime, përmirësime apo literaturë bashkëkohore. (aneks - Vlerësimi i procesit mësimor nga studentët)</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Garancia që përmbajtja e programit MTR të japë në përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara jepet vetëm nëpërmjet të dhënave lidhur me studentët e diplomuar dhe se sa ata janë sot të suksesshëm në treg. Element themelor në këtë drejtim janë vlerësimi i brendshëm i procesit mësimor.</p> <p>Vlerësimi i brendshëm i procesit mësimor realizohet nga departamenti çdo fund viti, përmes një anketimi të realizuar tek studentët në javën e 13-të. Ky vlerësim përfshin procesin e mësimdhënies, kontrollin e dijeve për modulet e dy semestrave. Mbi bazën e rregullores, rezultatet e anketimit i bëhen me dije departamentit për të marrë masa lidhur me përmirësimin e punës për secilin modul, apo për programin në përgjithësi, me synim final përmirësimin e aftësimit të studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Ndikimi i përmbajtjes së programeve në vijim të studimeve apo punësim dhe përshtatjen me pritshmëritë e tregut e pasqyron procesi i gjurmimit të studentëve, që është një garanci për gjetje të bazuara në të dhëna reale dhe QKA, e cila shërben ndër të tjera edhe si ndërlidhëse e institucionit me Alumni të UBT.</p> <p>Këto dy element themelorë janë realizuar nga programi i MTR dhe pasqyruar në Anekset 13/1 dhe 13/2 dhe nga vizitat në institucion përkatësisht në intervistat me QKA. Në këto anekse jepet së pari një strukturë e mbledhjes së të dhënave dhe më tej një analizë e punësimit të studentëve që kanë plotësuar formularin e gjurmimit. (aneks 13/1 gjurmimi i studentëve MTR 2016)</p> <p>(Aneks 13/2 gjurmimi i studentëve ilustrim)</p> <p>Kjo është një përpjekje për të ndërtuar një metodë gjurmimi, por sipas aneks 13/1 në 35 studentë që janë marrë në shqyrtim, të dhënat tregojnë për përqindje të ulëta të punësimit sidomos në profil. Kjo nuk reflekton domosdoshmërisht vetëm faktorë të lidhur me institucionin, përkundrazi, pasi ka shumë faktorë të lidhur me vetë tregun e punës dhe gjithashtu mund të jetë larg realitetit për shkak të krahasimit me numrin e formularëve të plotësuar për gjurmim (Aneks 14 – numri i studentëve që kanë plotësuar formularin gjithsej nga FEA është 710) Pra duhet bërë një studim tërësor, ose me kampionim me një metodë më përfaqësuese. Por vlen për tu vlerësuar përpjekje e QKA, që është gjithashtu një zyrë e re (aneks 19</p>





	vendim senati për QKA 2013), në këtë institucion për ndërtimin e sistemit të gjurmimit të studentëve. Nga vizitat në institucion u sygjjerua përmirësimi i formularit për mbledhjen e më shumë të dhënave në mënyrë që të ketë mundësi për analiza më të mira për përafrimin e realitetit të punësimit të studentëve. QKA ka ngritur bordin e përbërë nga ish-studentë të cilët mendohet të kontribuojnë në lobim për çështje të ndryshme të institucionit përfshirë edhe tregun e punës. Panairi i karrierës gjithashtu ka dhënë rezultatet e para (aneks 14 raport performance QKA), ku janë përfshirë rreth 14 institucione dhe biznese dhe është bërë marrëveshje me 2 prej tyre.			
<b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Bahkëpunëtorët dhe partnerët nga tregu i punës janë pjesë e marrëveshjeve të departamentit për praktikantët e studentëve (aneks 35 Lista e marrëveshjeve praktika profesionale). Ndërsa një punë e mirë për të krijuar marrëdhënie me partner të biznesit dhe për të siguruar kushte për punësimin e studentëve është bërë edhe gjatë panairëve të karrierës në vitet e fundit, me biznese pjesëmarrëse 31 në vitin 2014, 51 në 2018 nga të cilët 14 të interesuar për studentët e FEA (Aneks Aneks 14 raport performance QKA, Aneks 18 – raport vlerësimi panairi i karrierës). Studentët përfshihen gjithashtu edhe në një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione shtetërore dhe private (Aneks 36,37,38). <u>Megjithatë formalisht nuk tregohet se si konkretisht po merren parasysh propozimet e tyre në përmirësimin e programeve të studimit.</u> Është positive që ka një sërë marrëveshjesh dhe gjatë bashkëpunimit me këto aktorë ka informacion që mund të shërbejë në përmirësimin e kurrikulës, programeve, por nuk ka një strukturë për të formalizuar këtë bashkëveprim jo thjesht në interes të praktikave apo të bashkëpunimeve të tjera, por edhe në interes të përmirësimit të përmbajtjes së programit të studimit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			✓	

**Standardi II.5**

**Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Bazuar në Ligjin 80/2015, personeli akademik me kohë të plotë dhe ai me kohë të pjesshme kryen veprimtari të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbime në mbështetje dhe zhvillim të institucionit, këshillime për studentët etj. Personeli akademik mund të jetë me orientim mësimor dhe/ose kërkimor shkencor dhe kategorizohet në profesorë, lektorë dhe asistent lektorë. Personeli akademik i Departamentit MTR dhe ai jashtë departamentit që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kushtet sipas ligjit, lidhur me rolin që realizojnë në mësimdhënie dhe aktivitet kërkimor shkencor duke u bazuar në titujt dhe gradat. Staf i brendshëm në total i këtij programi përbëhet nga 30 pedagogë, me tituj dhe grada të ndryshme. Kështu anëtarët e personelit akademik me tituj Profesor (7 prej tyre) /Profesor i Asociuar (12 prej tyre) janë titullarë të lëndëve dhe



	<p>ngarkesa e tyre është shpërndarë sipas VKM, për të lejuar një raport më të madh drejt punës kërkimore shkencore. Kategoria Lektor përfshin personelin akademik me gradën shkencore Doktor (6 prej tyre), punësohet me kohë të plotë dhe ka një ngarkesë më të lartë në mësimdhënie. Kategoria asistent lektor (5 prej tyre) ka kryesisht një ngarkesë të lartë në mësimdhënie, seminare, praktika, dhe është e orientuar drejt mësimdhënies, me kontratë me afat të përcaktuar. (Aneks 30 Lista e stafit akademik MTR DMTR) Aneks 31 Tabela e stafit akademik DMTR Aneks 32</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik i përcaktuar për të realizuar programin është listuar në Aneks 31, 32, si më lart dhe Aneks 33- ngarkesa e stafit akademik MTR, DMTR 2018-2019. Kualifikimi akademik i drejtimit të programit është sipas kërkesave të legjislacionit dhe po ashtu në përshtatje me programin që nga përgjegjësi i Departamentit e në vijimësi me profesoratin e departamentit MTR. Mbulimi i moduleve mësimore nga stafi evidentohet në Aneks 33 dhe ka përshtatshmëri me kualifikimet përkatëse të stafit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Përcaktimi i ngarkesave për stafin akademik është bërë në përputhje të kualifikimit të secilit anëtar të stafit me përmbajtjen e programit dhe specifikën e moduleve. Aneks 33 ngarkesa e stafit akademik dhe aneks 46 CV e stafit akademik tregojnë për përshtatshmërinë e moduleve dhe ngarkesës mësimore të përcaktuar me diplomën dhe kualifikimet pasuniversitare të stafit përkatës. Gjithashtu një rol të rëndësishëm luan edhe puna kërkimore dhe investimi i stafit në tematikat përkatëse kërkimore sipas fushave dhe lëndëve. Rol në vlerësimin e këtij kriteri luan edhe vlerësimi i procesit mësimor duke përfshirë mësimdhënien dhe kontrollin e dijeve, i cili përvec të tjerash realizohet nga shpërndarja e anketave.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Personeli përgjegjës për praktikën profesionale, është personeli i departamentit MTR, i organizuar në komisionin e praktikës profesionale, përgjegjës për mbarëvajtjen e praktikës mësimore. Procesi i praktikave, i mbështetur nga organizata të biznesit dhe administratës publike, në nivele vendore e qendrore, ndiqet nga komisioni dhe procedurat janë të mirëpërcaktuara në dosjen përkatëse (shtojcë dosja e praktikës profesionale Bsc në MTR). Realizohet një kontratë midis studentit dhe kompanisë/organizatës, institucioni (departamenti, komisioni) marrin përsipër garantimin e vendit të realizimit të praktikës, në rastet kur nuk përcaktohet me dëshirën e studentit. Studentët pas periudhës së ndjekjes së praktikës, sjellin në institucion vërtetimin nga kompania/organizata dhe komisioni i praktikës merr në provimin e praktikës studentët, duke nxjerrë listën e notave. Dokumentacioni gjithashtu paraqet listën e studentëve dhe kompanive/organizatave ku ata do të realizojnë praktikën për cdo vit. <u>Në fakt nuk ka një listë të studentëve në përgjegjësi të një pedagogu, por cdo përgjegjësi rregullohet vetëm nga komisioni.</u> Në përfundim të studimeve realizohet punimi i diplomës, ku vendoset në dispozicion personeli akademik udhëheqës i diplomës, Brenda</p>



	departamentit ose dhe nga jashtë departamentit nëse vlerësohet e nevojshme, sigurisht me titujt dhe kualifikimet përkatëse, ( aneks 44 lista e udhëheqësve dhe punimeve të diplomës dhe aneks 60 procesverbal provim diplome).			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Personeli ndihmës akademik kategorizohet në ndihmës akademik me karakter mësimor dhe administrativ, sipas rregullores DMTR. Personeli ndihmës akademik punësohet mbi bazën e procedurave të qarta bazuar mbi aktet e brendshme të UBT dhe ligjet në fuqi, përmes konkursit të drejtuar nga një komision adhoc e të përbërë nga anëtarët e DMTR. Personeli ndihmës akademik administrativ (Sekretare) është pjesë përbërëse e departamentit. Personeli ndihmës akademik mësimor është personel i strukturës së FEA dhe DMI, që u shërben studentëve në seancat e laboratorëve laboratorëve. (Aneks 46 CV e stafit akademik e stafit ndihmës administrativ)			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓




### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b> <b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Në cdo fillim viti akademik, të gjitha njësitë kyesore në UBT zbatojnë një plan masash, ndër të cilat edhe masa lidhur me kujdesin për zhvillimin e metodave të reja të mësimdhënies. Zyra e Rektoratit, Dekanatet dhe Departamentet përkatëse, angazhohen dhe ngarkohen për zbatimin e planit të masave.</p> <p><i>(Aneks 63 Programi i Masave të Mirëfillim Vitit Akademik 2018-2019, Seksioni 2 - Mësimdhënia, gërma b, fq.6. 2018-2019. Miratuar më datë 10.09.2018).</i></p> <p>Përvec kësaj, UBT zhvillimi dhe përdorimi i metodave inovative në mësimdhënie bazohet edhe në një udhëzues në nivel institucional, pasi UBT i ka adaptuar prej kohësh këto metoda. (Aneks 64 Udhëzues Metoda Inovative Mësimdhënie). Të tilla metoda janë: e-learning, google site, Moduli online “Njohuri për informacionin”, MOODLE, TEEAL, Esse3;</p> <p>Plani i mësipërm i masave dhe udhëzuesi institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies janë konsideruar si instrumenta mjaft të konsoliduara tashmë nga UBT dhe i shërbejnë dhe kanë rezultuar mjaft eficiente. Nga ana tjetër, për të vijuar këtë proces por edhe për të konsoliduar kontrollin dhe vlerësimin e mësimdhënies nga stafi akademik dhe ndihmës akademik, strukturat përgjegjëse zhvillojnë më tej mekanizma monitorimi.</p> <p>Monitorimi dhe vlerësimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik realizohet në mënyrë periodike nga UBT/FEA edhe nga departamenti që ofron këtë program studimi. Elementet kryesor që mundësojnë këtë monitorim dhe vlerësim, është realizimi dhe zhvillimi i pyetësorëve prej mëse 4 vjetësh i parashikuar dhe diktuar në Programet Mësimore <i>(Aneks 63 Program Masave Mirefill Vit Akademik 2018-2019, Seksioni 2 - Mësimdhënia, gërma f, fq. 6.2018-2019. miratuar më datë 10.09.2018)</i>. Ky pyetësor realizohet në përfundim të çdo semestri i shtrirë nga e tërë trupa studentore e institucionit, por edhe e DMTR <i>(Aneks 65 Pyetësor Per Vleresim Proces Mesimor/Formular tip)</i>.</p> <p>Ky proces realizohet përmes disa instrumentave:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerësimin nga ana e studentëve: Dy herë në vit, në përfundim të çdo semestri, zhvillohet pyetësori me studentët. Rezultatet përpunohen nga një grup pune me përfaqësues nga dekanati e departamenti dhe më tej analizohen e shpërndahen në departamente. Rezultatet e këtij pyetësori janë pjesë e analizës vjetore të njësisë bazë dhe kryesore. Rezultatet individuale diskutohen gjithashtu ndërmjet përgjegjës të</li> </ul>



	<p>departamentit dhe secilit pedagog duke vënë në pah elemente që mund të kenë nevojë për përmirësim.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Instrumenti i dytë është Dokumenti i Normimit të Proçesit të Mësimdhënies. Ky dokument plotësohet në përfundim të çdo viti akademik nga vetë stafi akademik efektiv (PAE) në bashkëpunim me titullarët e grupeve Kërkimore Shkencore dhe Drejtuesin e Departamentit.</li> <li>- Instrumenti tjetër që përdoret nga FEA, është Dokumenti i Performancës, ku stafi akademik dokumenton ngarkesën mësimore, performancën në kërkimin shkencor e botime si dhe shërbimet ndaj të tretëve (<i>Aneks 67 Performanca Mesimdhënies/Formular tip</i>)</li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Bazuar në vizitat në institucion sikurse edhe nga konsultimi me dokumentacionin e vënë në dispozicion, rezultojnë se Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve. P.sh., ashtu sikurse u theksua edhe më sipër, një nga format për vlerësimin periodik të metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit të dijeve është anketa me studentët. Për këtë qëllim është hartuar një anketë e thjeshtë (një instrument i përdorur për mbledhjen e informacionit nga ana e studentëve), e miratuar edhe në dekanat, e cila synon tërheqjen e opinionëve të tyre lidhur me proçesin e mësimit dhe çdo dukuri tjetër të lidhur direkt apo indirekt me të. Kjo është vlerësuar mjaft positive dhe optimiste nga ana e studentëve të cilët shprehin se janë të lirë për të shprehur opinionet e tyre në mënyrë periodike, dhe inkurajojnë njëri tjetrin për të bërë një vlerësim të tillë.</p> <p>Kjo praktikë tashmë është kthyer në traditë në departamentin që ofron këtë program studimi duke u konsideruar nga përgjegjësi i departamentit por edhe stafi si një instrument i rëndësishëm që ndihmon në përmirësimin e punës së departamentit dhe fakultetit në përgjithësi.</p> <p>Kjo anketë realizohet 2 herë në vit në përfundim të çdo semestri, përpara zhvillimit të provimit përfundimtar.</p> <p><i>(Aneks 65 Pyetsor Per Vleresim Proçes Mesimor/ Formular tip)</i></p> <p>Rezultatet përpunohen nga një grup pune me përfaqësues nga dekanati dhe departamenti, dhe analizohen dhe shpërndahen në departamente. Rezultatet e tij janë pjesë e analizës vjetore të njësisë bazë dhe kryesore. Rezultatet individuale diskutohen gjithashtu ndërmjet përgjegjësit të departamentit dhe secilit pedagog duke vënë në pah elemente që mund të kenë nevojë për përmirësim.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse, njësisia bazë dhe kryesore bëjnë publike rezultatet e anketave, në nivel departamenti, nëpërmjet analizës vjetore të njësisë, e cila diskutohet në një mbledhje të hapur departamenti. Vetëm pas diskutimeve në Departament dhe reflektimeve të ndryshme lidhur me problematikat e gjetura, kjo analizë miratohet dhe përcillet në Dekanat. Sikurse reflektohet edhe nga takimet me stafin, mbledhje të tilla për këtë qëllim janë të shpeshta dhe të rregullta dhe konsiderohen mjaft eficente.</p>





	<p>UBT në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies ka një specifikë në organigramën e saj, që është Dega e Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional. Misioni i saj përveç funksioneve të tjera është kordinimi dhe monitorimi i gjithë procesit mësimor.</p> <p><i>(Aneks 53 Rregullore DZHKKVI &amp; DITNJ_2017, Neni 9).</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Anketat realizohen/administrohen nga Përgjegjësi i departamentit dhe Sekretarja e departamentit me studentët gjatë orëve të leksioneve në Javën e 14 dhe 15 të Semestrit të parë dhe të dytë, në çdo vit akademik. Të dhënat e anketave hidhen në database në Excel ku dhe përpunohen. Rezultatet e anketave sipas kurseve të marra paraqiten në një raport të bërë nga Departamenti dhe më pas edhe në raportin e Dekanatit. Rezultatet individuale diskutohen gjithashtu ndërmjet përgjegjësit të departamentit dhe secilit pedagog duke vënë në pah elemente që mund të kenë nevojë për përmirësim.</p> <p>Nga pikëpamja metodologjike, përpunimi realizohet duke përdorur frekuencat absolute dhe relative si dhe paraqiten trendet me grafikë shtyllë (frekuenca relative në përqindje). Gjithashtu, janë regjistruar dhe komentet përkatëse të bëra nga studentët të cilat bëhen të ditura në mbledhjet e departamentit.</p> <p><i>(Aneks 53 Rregullore DZHKKVI &amp; DITNJ_2017, Neni 9).</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				✓

<p><b>Standardi III.2</b>  <b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Përmirësimi i metodave të mësimdhënies dhe mësimnxënies përbën një ndër prioritetet kryesore të kësaj njësie (departamenti), dhe është e reflektuar edhe në takimet me stafin dhe përgjegjësin e departamentit shqetësimi për të përmirësuar në mënyrë të vazhduar. Metodot e transmetimit të njohurive tek studentët janë bashkëkohore dhe kjo flet për përpjekje serioze nga ana e stafit të këtij departamenti në dobi të rritjes së nivelit të mësimdhënies, i cili përdor mjete bashkëkohore të mësimdhënies siç janë mjetet audio-vizive, përfshirja interaktive e studentëve gjatë orëve të mësimi si dhe angazhimi i tyre në diskutimin e rasteve të studimit, kërkim dhe punë individuale apo në grup. Blerja nga ana e fakultetit të një numri të konsiderueshëm paisjesh audio-vizive (projektorë) ka zgjidhur edhe problemin e disponueshmërisë së tyre. Gjithmonë e më tepër vihet re një anagazhim më serioz i studentëve në terma të përfshirjes së tyre në diskutime gjatë orës së mësimi, qoftë leksion apo seminar.</p> <p>Në programin e studimeve Bachelor, format kryesore të mësimdhënies janë Leksionet, Seminarët/Orët laboratorike dhe Tema e diplomës.</p>



	<p>Leksionet: 885 orë në auditor Seminare: 825 orë në auditor</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Duke iu referuar Rregullores së DMTR mund të thuhet se forma të shumëllojshme të mësimdhënies, mësimnxënies dhe kontrollit të dijes parashikohen në planet mësimore, programet e modileve. Gjithashtu programi përfshin të gjitha format e mësimi teorik e praktik si leksionet, seminarët, ushtrimet, punët laboratorike, praktikat profesionale, detyrat e kursit, projektet e kursit, etj. forma e vlerësimit vec formave të tjera është provimi final i modulit, ku këto të fundit klasifikohen në module të detyruara dhe module me zgjedhje. Format e tjera të kontrollit të dijeve përfshijnë: aktivizimin gjatë orëve mësimore, testimet ndërmjetëse, mbrojtjen e punëve laboratorike, mbrojtja e detyrave dhe e projekteve të kursit, mbrojtja e praktikave profesionale, provimet e kursit, provimet e formimit, mbrojtja e temës së diplomës.</p> <p>Aplikimi i formave, mënyrave, metodave alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi, dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, është gjithnjë në fokusin e stafit të DMTR.</p> <p>Për shkak të karakterit praktik të disa moduleve, si pjesë e kurrikulës së programit të MTR_s, në mënyrë periodike në orët e seminareve, studentët vizitojnë biznese të Agroturizmit apo të Turizmit Rural, duke e bërë jo vetëm praktike e konkrete mësimnxënien, por edhe tërheqëse për studentët.</p> <p>Në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm dhe aplikimit të formave më të reja të mësimdhënies, UBT/FEA ka investuar në teknologji të reja. Kështu p.sh., Salla 201, Godina B është e pajisur me "Smart board", e përdorur gjërësisht nga pedagogë të ndryshëm.</p> <p>Në funksion të moduleve aplikative në këtë program studimi janë vënë në dispozicion salla të pajisura me kompjutera dhe programe kompjuterike. Shih fotot 3 dhe 4 të laboratorëve të informatikës: (Aneks 61 Salla Mësimi dhe Laboratori Informatikës)</p> <p>Në kuadër të respektimit dhe vlerësimit të lirisë akademike stafi motivohet të sjellë risi në mësimdhënie, të propozojë module interaktive apo forma të tjera që rrisin interesin e studentëve, integrojnë elementin e praktikës, nxisin debatin dhe zhvillojnë kreativitetin, për të rritur mësimnxënien dhe aftësitë praktike të studentëve.</p> <p>Në funksion të moduleve aplikative në këtë program studimi janë vënë në dispozicion salla të pajisura me kompjutera dhe programe kompjuterike (6 Labororë në Godinat A dhe B). (Aneksi 42 – Infrastruktura, Lista e Mjediseve në funksion të Mësimi të UBT)</p>
	<p>Departamenti i manaxhimit te turizmit rural edhe përse përbën një departament të ri, bën përpjekje intensive për të rritur cilësinë në mësimdhënie dhe për të përfshirë intensivisht studentët në këtë proces.</p>






<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në vlerësimin e metodave të mësimdhënies nga ana e stafit nuk bëhet vetëm në mënyrë periodike përmes raportimeve të departamenteve dhe analizave të tyre vjetore, kjo është çështje edhe shqetësim i vazhduar ku stafi përfshihet në diskutime të vazhduara për të përmirësuar këtë proces, gjë e cila në fund të fundit ka rezultuar me përmirësim të ndjeshëm të cilësisë së studentëve që zgjedhin këtë program studimi, deri sa është në rritje edhe numri i studentëve që si zgjedhje të parë kanë këtë program studimi, duke përbërë në këtë mënyrë një rrugë të sigurtë të reflektimit të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies si dhe të përfshirjes aktive të studentëve si target i synuar.</p> <p>Për të përmirësuar këtë proces departamenti ngre dhe monitoron grupet e kontrollit. Grupi i punës për çdo vit akademik organizohet në nivel departamenti, vlerëson arritjet dhe problemet që duhen përmirësuar në të ardhmen. Kontrollat e realizuara nga departamenti dhe dekanati (leksione të hapura) lidhur me disiplinën në procesin mësimor konstatojnë, si konkluzion të përgjithshëm, zhvillimin me korrektësi të procesit mësimor nga ana e pedagogeve të DMTR.</p> <p><i>(Aneks 68 Plani i Mësimeve të Hapura 07.04.2014)</i></p> <p><i>(Aneks 69 Plan Masash 2014 dhe Raport Kontroll Mësimdhënie 2015)</i></p> <p>Pjesë e reflektimit dhe organizimit të leksioneve të hapura janë edhe rezultatet e marra nga pyetësi i studentëve, të cilat analizohen edhe në analizën mësimore - kërkimore të përvitshëm të DMTR_s.</p> <p><i>(Aneks 54 Analiza Mësimore UBT Viti Akademik 2016-2017)</i></p> <p><i>(Aneks 25 Raporti i Analizës Mësimore-Kërkimore MTR 2017-2018) miratuar në mbledhjen e DMTR më datë 03. 12. 2018</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p> <p><b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Gjithashtu, metoda inovative që rrisin performancën e mësimdhënies janë</p> <p><i>(Aneks 64 Udhëzues Metoda Inovative Mësimdhënie)</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <b>e-learning</b> është një mënyrë elektronike e të mësuarit, që nënkupton dhënien e njohurive, mësimdhënies ose studimit, duke shfrytëzuar teknologjinë elektronike si kompjuter, pajisje mobile etj;</li> <li>2. <b>google site</b> është një aplikacion online që ndihmon në krijimin e një projekti në web ose të një faqe web-i, Lista e websiteve personale të pedagogeve të UBT: <a href="https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/sitemanager/home">https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/sitemanager/home</a>;</li> <li>3. <b>Moduli online “Njohuri për informacionin”</b> është rezultat i Projektit TEMPUS 517117-1-2011-1-IETEMPUS-JPHES, “Zhvillimi i njohurisë për informacionin për të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe një ekonomi të bazuar mbi dijen në vendet e Ballkanit Perëndimor”;</li> <li>4. <b>MOODLE</b>, i njohur edhe si Mjedisi Virtual i të Mësuarit (Virtual Learning Environment), i cili është një mjet për krijimin nga ana e pedagogut të faqeve web dinamike për studentët e tyre;</li> <li>5. <b>TEEAL</b> është një bibliotekë online e aplikuar në Universitetin Bujqësor të Tiranës;</li> </ol>





	<p>6. <i>Esse3</i> është një sistem i integruar për menaxhimin e mësimdhënies dhe shërbimeve drejtuar studentëve, nga aplikimi në Universitet, jetës universitare deri në mbrojtjen e diplomës.</p> <p>Në bazë të të gjitha formave dhe metodave të mësimdhënies qëndron sensi i autonomisë së studentit, duke u përpjekur për ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjelltë student-mësimdhënës. Ka një komunikim mjaft të mirë mes studentëve dhe pedagogëve si në auditor ashtu dhe në zyrat e pedagogëve gjatë orëve të pritjes, por dhe jo vetëm.</p> <p>UBT ka investuar dhe synon të vazhdojë të investojë në sigurimin e kushteve optimale infrastrukturore, si edhe në teknologjinë bashkëkohore, për të mundësuar mësimdhënie të një cilësie të lartë dhe për të inkurajuar eksperimentimin dhe arritje të punëve kërkimore.</p> <p>Mjediset e reja të UBT-së tashmë ofrojnë një ambient modern dhe të pajisur plotësisht, i cili ka të gjithë kapacitetin infrastrukturor dhe teknologjik për të plotësuar kërkesat e programit të studimit në përputhje me qëllimet e programit.</p> <p>Më gjerësisht, kjo autonomi konsiston në: zhvillimin e seminareve në mënyrë interaktive, formimi në mënyrë të pavarur nga ana e studentëve e grupeve të punës për projektet dhe detyrat e kursit, bashkëpunimi lidhur me zgjedhjen e temave të këtyre punimeve dhe të temave të diplomave dhe asistimi i vazhdueshëm qysh prej hartimit të strukturës deri në mbrojtjen përfundimtare të tyre.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

<b>Standardi III.3</b>	
<b>Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Mjediset e Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit janë në dispozicion si për zhvillimin e të gjitha programeve të studimit edhe për zhvillimin e procesit mësimor të programit të studimit MTR. Godinat kryesore janë Godina A, organizuar në 2 kate me 7 salla leksionesh dhe 14 seminaresh dhe 5 laboratorë dhe Godina B, organizuar në 4 kate me 8 salla leksionesh, 23 seminaresh, 2 laboratorë. Dekanati i FEA ndodhet në godinën B. ndërsa Departamenti i Menaxhimit të Turizmit Rural është i vendosur në Godinën A, kati i dytë, zyra 208 Gjithashtu, në Godinën B është vendosur edhe Dekanati i FEAs. Të dy godinat mirëmbahen dhe pastrohen nga stafi ndihmës i fakultetit. Kurset e programit të studimit Bachelor MTR ndahen në grupe mësimore dhe kjo bën të mundur, që hapësirat në dispozicion në FEA të jenë të mjaftueshme.
<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e	Cilësia në procesin mësimor është përveçse funksion i aspektit human, edhe e varur nga aspekti infrastrukturor dhe mjediset e zhvillimit të mësimin. FEA dhe konkretisht lidhur me programin e studimit që po analizohet, "Menaxhim

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



<p>nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p><i>i Turizmit Rural</i>”, është e pajisur me ambjentet e mjaftueshme në trajtën e sallave të leksioneve e seminareve, zyrave, e laboratorëve, të nevojshëm për realizimin e tij (<i>Aneks 70 Tabela Kapacitetet Infrastrukturore UBT</i>).</p> <p>Pajisja e sallave dhe auditoreve me mjete e nevojshme ku përfshihen kompjutera në zyra dhe laboratore, kompjutera, laptop dhe videoprojektorë, lidhje Interneti, është e një niveli të lartë. Duhet përmendur se infrastruktura e UBT është përmirësuar së fundi në salla, por sidomos me shtimin e 2 laboratorëve të rinj dhe pajisjen krejtësisht nga e para. Mësimi zhvillohet në mjedise që përmbushin të gjitha kriteret sipas VKM. Nr.418, datë 10.05.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucionineve të arsimit të lartë dhe degëve të tyre”, sipas të cilit kërkohen 2.5 m<sup>2</sup>/student e ku kapaciteti i FEA është për 1544 studentë (3860:2.5).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Realizimi i procesit mësimor mbështetet përmes infrastrukturës informatike dhe teknologjisë në FEA dhe në DMTR në dy aspekte. Së pari në aspektin organizativ dhe strukturor përmes Sistemit informatik dhe Website, ku realizohet mbështetja e të gjithë procesit, nga hyrja e studentit e deri në dalje, ku studenti informohet për programin e studimit, modulet, procesin e mësimdhënies/mësimnxënies, vlerësimin si pjesë e tij, ndërsa pedagogu mbështetet përmes mundësisë për shpërndarjen e materialeve, komunikim me studentët etj. Së dyti, infrastruktura ndikon drejtpërdrejt në procesin e mësimdhënies/mësimnxënies përmes laboratorëve kompjuterikë për të realizuar praktikat/seminaret në module të caktuara dhe infrastrukturës me videoprojektorë e laptop në sallat e leksioneve. Seminaret në disa lëndë, si Statistikë, informatike, Kontabilitet realizohen në laboratorë. Për këtë studentët e FEA-s kanë në dispozicion pesë salla të pajisura me kompjutera (rreth 25 kompjutera secila sallë) si dhe dy salla të reja laboratorike me kompjutera të realizuara në muajin Shtator 2017. Programet kompjuterike të instaluar lidhen me lëndët kotabilitet/financë, informatikë dhe statistikë, si dhe paketa office, e domosdoshme në cdo rast. Këto salla janë produkt i projekteve të ndryshme ndërkombëtare që kanë koordinuar anëtarët e stafit të FEA-s, ndërsa dy sallat e reja janë investim i UBT me fondet e veta.</p> <p>(<i>Aneks 98 Të Dhëna për Infrastrukturën e FEA_s</i>)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të</p>	<p>Dijet dhe njohuritë në programin e studimit, të shpërndara në orët në auditor kërkohen dhe gjejnë mbështetjen përmes literaturës së përshtatshme për punën e studentit jashtë auditorit. Modulet e ofruara në këtë program studimi kanë literaturën bazë në gjuhën shqipe, të ofruar për studentët në forma të ndryshme si tekste mësimore, cikle leksionesh, leksione në ppt, materiale në web, etj. Aktualisht, institucioni ju ofron studentëve tekste të përkthyer nga titullarët e lëndëve që janë të aksesueshme në hard copy në trajtën e cikleve të leksioneve ose tekste me ISBN. Duhet thënë se materialet shpërndahen gjerësisht përmes sistemit në google site në web dhe kjo lehtëson aksesin tek materialet e leksioneve, detyrave, projekteve. Studentët mund të përdorin përmes bibliotekës jo vetëm materialet fizike, por edhe ato në formë elektronike, si artikuj dhe libra në Librarinë elektronike TEEAL me akses në disa prej revistave më të mira, e cila u mundësua fillimisht nga projekti</p>





parashikuara në programin e studimit.	<p>AHEED që UBT ka patur me Universitetin e Hawai-it, SHBA. Ndërkohë, përditësimi i kësaj biblioteke duhet të bëhet në vazhdimësi nga IAL.</p> <p>Një library tjetër elektronike është mundësuar në kuadër të Projektit Erasmus+ “<i>Library Network Support Services</i>” (LNSS), pjesë e platformës Springshare, referuar linkut (<a href="https://lnss-albania.libguides.com/?b=p">https://lnss-albania.libguides.com/?b=p</a>)</p> <p>Gjithashtu,, është krijuar për pjesën më të madhe të botimeve katalogu online i Bibliotekës, për të cilin mund t'i referohemi linkut <a href="http://www.al.cobiss.net/scripts/cobiss">http://www.al.cobiss.net/scripts/cobiss</a> (Aneks 71 Statistika Bibloteka “Mentor Permeti”. Dokument 13.03.2019)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>UBT/FEA vënë në dispozicion të studentëve nëpërmjet bibliotekave respektive tekste mësimore të përcaktuara në Syllabus-et e lëndëve dhe literaturë ndihmëse të nevojshme, përzgjedhur mbi bazën e planit të hartuar nga përgjegjësi i programit. Fondi i bibliotekës, në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaja, pasurohet në mënyrë të vazhdueshme, duke synuar reflektimin e ndryshimeve cilësore të programit të studimit si edhe përditësimin me zhvillimet më të fundit të literaturës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Stafi i departamentit shprehte gadishmërinë e departamentit për t'i mbështetur me rifreskime të titujve të fundit për modulet që ata japin mësim.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Ashtu siç u përmend edhe më sipër, në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik akseson librarinë on-line TEEAL që zotëron IAL. Gjithë stafi akademik mund t'a aksesojë këtë librari direkt nga zyrat e tyre ndërkohë që studentët mund t'a aksesojnë nga biblioteka.</p> <p>Sugjerohen zyrat mbështetëse pranë UBT të nxisin më shumë studentët drejt përdorimit të bibliotekave online dhe të gjetjes së mekanizmave që i shtojnë ata drejt këtij burimi informacioni. Gjatë vizitës në bibliotekën qendrore, u vu re se një pjesë e studentëve nuk ishin në dijeni të ekzistencës së librarisë online dhe e përdornin infrastrukturën brenda bibliotekës për bërjen e detyrave të kursit ose për të mësuar në sezon. Për këtë iu sugjerua stafi të bibliotekës që të vendosë njoftime në vende të dukshme brenda bibliotekës për përdorimin e kësaj librarie online. Gjithashtu biblioteka e fakultetit ishte në process hedhjeje të titujve dhe viteve përkatëse dhe nuk kishte një dokument final të tyre.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Nga takimet me studentët dhe stafin por edhe me personelin mbështetës rezultojnë përpjekje të vazhduara për të orintuar studentët drejt përdorimit të bibliotekave dhe njërive të tjera mbështetëse përgjatë të gjithë vitit akademik. Studentët e FEA_s kanë në dispozicion 5 (pesë) salla të pajisura me kompjutera (rreth 25 kompjutera secila sallë), si dhe 2 (dy) salla të reja laboratorike me kompjutera të realizuara në muajin Shtator 2017. Në këto kompjutera janë instaluar paraprakisht të gjitha programet (software) të nevojshëm për realizimin me sukses të punës së pavarur nga studenti. Këto salla janë produkt i projekteve të ndryshme ndërkombëtare, që kanë koordinuar anëtarët e stafit të FEA_s, ndërsa dy sallat e reja janë investim i universitetit me fondet e veta. Përmë shumë informacion mbi infrastrukturën e FEA_s (Aneks 98 Të Dhëna për Infrastrukturën e FEA_s)</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli</p>	<p>Në funksion të procesit të mësimdhënies platforma online e përdorur është google sites, ku vendosen materialet, programi i lëndës e syllabus, leksionet</p>



<p>akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>dhe materiale të tjera. Kjo është pjesë e faqes individuale të cdo pedagogu në web-site të universitetit. Në këtë mënyrë studentët nxiten të përdorin mjetet online dhe duke garantuar lehtësi dhe shpejtësi në ofrimin e informacionit edhe pedagogët janë më të nxitur ta përdorin në mënyrë të vazhdueshme. Mjete të tjera elektronike që lidhen me literaturat, si pjesë shumë e rëndësishme e programit mësimor janë libraritë online, sic u përmend edhe në pikën III.3 kriteri 4, më lart.</p> <p>aksesi i stafit mund të bëhet direkt nga zyrat e tyre, ndërkohë që studentët mund t'a aksesojnë nga biblioteka.</p> <p>Projekte të ndryshme mundësojnë libraritë online, sic janë aktualisht Research4life me 5 (pesë) programet Hinari, AGORA, OARE, ARDI, GOALI) (Aneks 71 Statistika Bibloteka "Mentor Permeti" Dokument 13.03.2019) dhe (Aneks 100 Plani Strategjik i Bibliotekes Shkencore Mentor Permeti 2015 – 2020).</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>Vendosja ne platformën online të të gjithë informacionit dhe mundësia e aksesimit të tyre nga studentët përbën një mundësi efikase të përdorimit të kohës nga studentët dhe rritje të efektivitetit të tyre. Staf i departamentit paraqet në site-t personale në portalin e UBT-së leksione të moduleve përkatëse, raste studimore, detyrat e kursit si dhe materialeve të tjera. Secili staf i departamentit që është i angazhuar në mësimdhënie në programin Bachelor ka site-in e vet ku komunikon me studentët e kursit. Në këtë hapësirë të përbashkët studentët kanë akses në leksionet e modulit, syllabusin e tij, strukturën e modulit si edhe mënyrën e administrimit të tij përgjatë semestrit. <a href="https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/xhdulja/">https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/xhdulja/</a> URL e web-faqes e stafit akademik (shembull)</p> <p>(Aneks 50 web Print Screen Staf DMTR Shembull)</p>
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Personeli akademik orienton studentët në zgjedhjen e temës së diplomës sipas fushave të kërkimit që mbulon Departamenti i programit te ofruar. Studimet e ciklit të parë "Bachelor" në DMTR përmbillen me punim diplome ose me provim, si dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë në fushën e ekonomisë dhe agrobiznesit; profili i Menaxhimit të Turizmit Rural. (Ankesi 10 Rregullore e Studimeve e MTR, neni 37, 38, 39, 40 - fq 11, 12. Miratuar më datë 27.09.2017)</p> <p>Në përfundim të semestrit të pestë, studentët plotësojnë një formular ku paraqesin fushën e studimit dhe një titull potencial të punimit të diplomës i cili konkretizohet më tej nëpërmjet punës që studenti kryen nën udhëheqjen e pedagogut.</p> <p>Departamenti përcakton kriteret dhe standardet e përgatitjes së një punimi diplome të nivelit të parë "Bachelor".</p> <p>Udhëheqësi i punimit të diplomës (personeli akademik) përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të realizimit të tij. Studenti duhet të respektojë afatet e vendosura për të bërë të mundur mbrojtjen me sukses të temës në sezonin normal të mbrojtjes së diplomës. Udhëheqësi përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin, përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë sipas programit të miratuar. Grafiku i konsultimeve është i detyrueshëm të zbatohet nga studentit dhe pedagogu. Para mbrojtjes së punimit të diplomës, udhëheqësi rishikon</p>






	dhe miraton punimin e kryer nga studenti dhe lejon mbrojtjen e tij duke e firmosur atë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

**Standardi III.4**

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>UBT ka institucionalizuar organizimin e njërive që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Kështu, sipas Nenit 26 të Statutit të UBT, Njësitë Ndhimëse në Funkcion të Proçesit Mësimor-Kërkimor janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Spektori i Mësimin, Kurrikulave &amp; Vlerësimin Institucional</li> <li>Spektori i Kërkimit, Koop. Shkencor &amp; Projekteve</li> <li>Spektori i Informacionit &amp; Transferimit të Njohurive</li> <li>Spektori i Marrëdhënive me Jashtë &amp; Publikun i cili përbëhet nga: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zyra e Marrëdhënive me Jashtë</li> <li>- Zyra e Marrëdhënive me Publikun</li> </ul> </li> </ol> <p>Veprimtaria e këtyre sektorëve disiplinohet me rregullore, që miratohen nga Senati i UBT-së. <i>(Aneks 7 Statuti i UBT, neni 25, fq 24. Miratuar më datë 28.03.2017)</i></p> <p>UBT ka hartuar një draft strategji të re, ku ndër të tjera theksi kryesor vendoset në fuqizimin e punës shkencore, për të realizuar një kërkim të integruar, ndërkombëtarizimin e kërkimit, krijimin e një rrjeti bashkëpunimi të qëndrueshëm, kontributin dhe në krijimin e bazës kombëtare të të dhënave në kërkimin shkencor, duke ju referuar kështu Planit Strategjik të UBT-së për periudhën 2016-2025, ku reflektohen qartë ambicjet në këtë drejtim. <i>(Aneks 8 Planit e Strategjik te UBT. Kreu 5. fq 42. 43 miratuar në Qershor 2016)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Departamenti si ofruesi dhe mbështetësi kryesor i programit të studimit Manaxhimi i Turizmit Rural, në bashkëpunim me FEA, kanë në fokus të vazhdueshëm proçesin e mësimdhënies si dhe cilësinë e tij.</p> <p>Në këtë kuadër, të dy këto njësi organizojnë në mënyrë periodike, leksione të hapura. Këto orë të hapura organizohen në të dy drejtimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- stafi i ri ndjek orë leksionesh nga stafi më me përvojë dhe,</li> <li>- stafi i ri asistohet gjatë orëve të hapura nga titullarët e modulit si dhe nga përfaqësues të departamentit dhe fakultetit.</li> </ul> <p>Megjithatë, fakti që ky departament është relativisht I ri, dhe përbëhet nga një numër i vogël staf akademik, përbën një avantazh sepse rrit fleksibilitetin dhe bashkëpunimin midis tyre. Edhe nga takimet në institucion, me stafin e këtij departamenti vihej re qartë komunikimi dhe integrimi i stafit me njeri tjetrin dhe përkushtimi i tyre drejt përmirësimit</p>



<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>dhe rritjes cilësore. Në këtë kuadër, në përputhje me përcaktimet ligjore, veprimtaritë kërkimore bëhen mbi bazën e planeve, programeve dhe projekteve të miratuara, sipas procedurave të përcaktuara në Statutin e UBT. <i>(Aneks 7 Statuti i UBT, Aneksi 4 Modeli i Dokumentacionit në UBT, fq 60, 68. Miratuar më datë 28.03.2017).</i> Një praktikë tjetër e ndjekur janë edhe perfitimet e eksperiencës akademike në mësimdhënie nga mobilitetet e stafit akademik në kuadër të programeve ERASMUS+ ashtu edhe leksionet e dhëna nga lektorë të huaj në FEA. Këta lektorë të huaj mund të jenë personalitete të fushës në Shqipëri, por edhe lektorë të ftuar nga programet ERASMUS+ nga universitete perëndimore. Këto shkëmbime eksperiencë i shërbejnë edhe rritjes së vetëdijes së personelit akademik dhe studentëve për cilësinë e mësimdhënies.</p> <p>UBT ka kapacitete humane dhe infrastrukturore të nivelit të lartë. Prioritetet e kërkimit janë të qarta dhe të përcaktuara sipas të gjitha njësive përbërëse. Departamentet janë bërthamat, të cilat përcaktojnë objektivat e kërkimit, në përputhje me prioritetet kombëtare, si dhe me ofertat europiane. Gjithashtu, departamentet janë ato që kryejnë aktivitetet kërkimore - shkencore. Studentët organizohen në takime dhe orë të hapura për implementimin në praktikë të të rejave të fundit të teknologjisë, aplikimin dhe nxitjen e projekteve inovative.</p> <p><i>(Aneks 64 Udhezues Metoda Inovative Mesimdhënie)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Kualifikimi i stafit akademik është një nga prioritetet e departamentit të menaxhimit të turizmit rural. Pedagogët e programit të studimit Bachelor në MTR sjellin pranë studentëve punimet e tyre të mëparshme akademike si një aset i çmuar, i cili duhet ruajtur dhe përcjellë në brezat e studentëve. Universiteti Bujqësor i Tiranës nxit pjesëmarrjen e pedagogëve në trajnime me qëllim zhvillimin dhe integrimin e -aftësive të tyre. Për këtë arsye, i kushtohet vëmendje kualifikimit profesional të personelit dhe veprimtarive mbështetëse didaktike dhe trajnimeve në fushat përkatëse. Kontributi i personelit akademik dhe shkencor kombinon nevojat e departamentit për mësimdhënie dhe kërkim shkencor, duke përfituar nga eksperiencat profesionale dhe kualifikimet shkencore brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Krahas marrëveshjeve ndërkombëtare dhe kombëtare, departamenti ka patur dhe ka si sfidë dhe mbështetjen e qeverisë në nismat e saj që integrojnë turizmin me bujqësinë përmes agroturizmit dhe turizmit rural, por jo vetëm. Ky këndvështrim ka rritur sfidat e këtij departamenti për të qenë më pranë qeverisë në ndihmë të ndërgjegjësimit të qeverive dhe vendimarrësve pasi departamenti, stafi dhe studentët e këtij programi kanë qenë pjesë integrale në 2 drejtime të medha: në mbështetjen që i është dhënë qeverisë me staf dhe studentët në skema të AZHBR, apo në mbështetjen intensive dhe të shpërndarë në kohë në projektin e 100 fshatrave.</p> <p>Mobilitetet që për momentin janë 2 konkretisht kanë rezultuar me diplomimin aktualë tashmë të studentëve të parë në Universitetin e Ankonës. Këto studentë kanë vijuar studimet më tej në vende të tjera si p.sh., Gjermani.</p>



<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Duhet theksuar se në kontekstin e kërkimit stafi ka përpjekje, stimul dhe arritje të konsiderueshme. Kualifikimi i stafit ndihmon në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. UBT ka mundur nënshkrimin e një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me universitete të huaja, të cilat kanë pasur si qëllim lidhjen e marrëveshjeve të qëndrueshme me institucione partnere të huaja të arsimit të lartë me interes të përbashkët, në mbështetje të fuqizimit të drejtëpërdrejtë të kërkimit shkencor.</p> <p>Ky departament ka realizuar marrëveshje cilësore por që premtojnë siguri dhe jetëgjatësi në këtë program, kështu ka realizuar shkëmbime pedagogësh për lëndë ose module, edhe në modalitetet online, për të përforcuar shkëmbimin e eksperiencës didaktike dhe favorizimin e integritetit didaktik dhe kërkimor midis dy diplomave. Apo një tjetër marrëveshje ndërkombëtare Erasmus + Programme me Sunderland London University. <i>(Aneks 5 London Erasmus + Programme -03052018 for learners and staff – Higher Education Student and Staff Mobility mes UBT dhe Sunderland London University, miratuar më datë 02.05.2018).</i></p> <p>Kjo marrëveshje ka si objektiv kryesor mobilitetin e studentëve nëpërmjet njohjes së dyanëshme të saj të moduleve të kurrikulës reciproke. Gjithashtu, duke realizuar shkëmbime pedagogësh për lëndë ose module, edhe në modalitetet online, për të përforcuar shkëmbimin e eksperiencës didaktike dhe favorizimin e integritetit didaktik dhe kërkimor midis dy Universiteteve.</p> <p><i>(Aneks 35 Lista e Marrëveshjeve UBT_Praktika Profesionale , QKA)</i>  <i>(Aneks 40 Marrëveshjet Bashkëpunime Institucion UBT_ Kërkim)</i>  <i>(Aneks 72/1 Mobilitet Stafi Akademik A. Sulaj)</i>  <i>(Aneks 72/2 Mobilitet Stafi Akademik Sh. DOMI)</i>  <i>(Aneks 72/3 Invitation letter _Staff_ Edmond Kadiu)</i>  <i>(Aneks 72/3 Invitations for Experts-1-4 Bulgari Nov 2018. Xh.Dulja)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p> <p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Në vazhdimësi, personeli akademik, në kuadër të projekteve të ndryshme të bashkëpunimit, por edhe në kuadër të marrëveshjeve që ka me institucione të tjera publike, është trajnuar për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe përdorimit të metodave të reja në mësimdhënie. UBT për realizimin e kërkimit shkencor, ka ofruar të gjithë mbështetjen institucionale, duke vënë në dispozicion të tërë infrastrukturën e UBT_s, për të krijuar dhe për të vendosur në dispozicion të stafeve efektive të departamenteve një infrastukturë bashkëkohore. UBT ka vijuar inkurajimin, zhvillimin dhe rritjen e dinamikës së kërkimit shkencor, duke gërshetuar punën e departamenteve me infrastrukturën mbështetëse si laboratorët, ambientet, resurset elektronike dhe bibliotekat.</p> <p>Faktikisht, ka qënë dhe mbetet përgjegjësi e personelit akademik të trajnuar që të transmetojnë tek studentët metodat dhe praktikat e reja të marra gjatë trajnimit sepse është pikërisht ky staf përgjegjës për realizimin e programit të studimit.</p>





	Këto metoda të reja janë transmetuar tek studentët dhe këto njohuri kanë rezultuar të jenë me vlerë dhe metodat të jenë të suksesshme. Nga ana tjetër, nxitja e këtyre bashkëpunimeve dhe partneriteteve ndikon, jo vetëm në rritjen cilësore të performancës së stafit, por edhe në ngritjen në një nivel më të lartë të transmetimit të dijeve tek studentët (metoda të reja mësimdhënie, mjete të reja mësimdhënie, metoda të reja të përfshirjes së studentëve në diskutim interaktiv).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

**Standardi III.5**

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Format e kontrollit të dijeve përcaktohen në mënyrë shumë të qartë në nenin 57 të Rregullores së studimeve të UBT. Sipas rregullores dhe praktikës që aplikohet në programin e studimit Bachelor në MTR është si më poshtë:</p> <p>a. Format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve që studenti ka përvetësuar gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një moduli janë: aktivizimet në orët e seminareve, testimi i ndërmjetëm/detyrat e kontrollit, projektet apo detyrat e kursit, esetë dhe provimi final.</p> <p>b. Detyrat e kontrollit janë elementë të vlerësimit të vazhduar të nivelit të dijeve. Detyrat e kontrollit organizohen përgjithësisht në javën e tetë të çdo semestri, mbi bazë grupi mësimor dhe vetëm gjatë orëve të planifikuara për seminare. Detyrat e kontrollit organizohen vetëm me shkrim.</p> <p>c. Provimi final mund të organizohet me shkrim, me gojë ose në një formë të kombinuar (me shkrim e me gojë). Në rast të provimit të kombinuar, departamenti përcakton nëse pjesa me shkrim e provimit mund të jetë përcaktuese apo eliminuese.</p> <p>d. Mënyrat e kontrollit të dijeve, sipas pikës (a) të këtij neni, përcaktohen në programin e modulit dhe planin mësimor të studimeve dhe i bëhen të njohura studentit në fillim të procesit mësimor.</p> <p>e. Provimi final organizohet dhe përfundon në datën dhe orarin e përcaktuar në grafikun e provimeve. Grafiku i provimeve hartohet nga Zv/Dekani për mësimin në bashkëpunim me përgjegjësat e departamenteve dhe miratohet nga Dekani. Grafikët e provimeve shpallen jo më vonë se katër javë para fillimit të sezonit.</p> <p>f. Në format e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht, kthehet në notë. Tezat e provimit hartohen nga titullari i modulit dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit. Gjatë zhvillimit të provimit nuk lejohet ndërrimi i tezës.</p>



	<p>Në fillim të çdo moduli të programit të studimeve Bachelor në MTR, pedagogu njih studentët me programin e lëndës, mënyrën e vlerësimit të njohurive dhe literaturën, që do të përdoret në modulën përkatës.</p> <p>Studenteve që në orët e para të leksioneve ju bëhet me dije struktura e lëndës më përqindjet në vlerësimet, ku dallojnë dy zërat kryesor: ai i vlerësimit të vazhduar dhe vlerësimi përfundimtar me provimin përmbyllës. Kjo masë vlerësimi është përcaktuar në rregulloren e programit të studimit (Aneksi 10 Rregullore e Studimeve e MTR. Neni 14. Fq 5, miratuar më datë 27.09.2017).</p> <p>Kontrolli i dijeve gjatë procesit mësimor merr në konsideratë: pjesëmarrjen dhe angazhimin e studentit në leksione, seminare, ushtrime, punë laborator, detyra me shkrim (provime ndërmjetëse), detyra kursi, projekte kursi, praktika mësimore, etj. Pavarësisht pikëve të grumbulluara, studenti që ka munguar apo është vlerësuar negativisht në detyrat e kursit apo në praktikën mësimore, është i detyruar t'i shlyejë ato javën e fundit të zhvillimit të procesit mësimor.</p> <p>(Aneksi 10 Rregullore e Studimeve e MTR. Neni 16. Fq 5, 6 miratuar më datë 27.09.2017)</p> <p>Dy herë në vit realizohen pyetësor, ku në to ju kërkohet studentëve të shprehin mendimin dhe vlerësimin e tyre për pedagogët në mënyrën se si ata zhvillojnë lëndët që mbulojnë dhe se sa praktike apo i sukseshëm ka qënë metodologjia dhe praktika e realizuar nga ta. (Aneks 65 Pyetësor Për Vlerësimin e Procesit Mësimor /Formular tip).</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

<b>Standardi III.6</b>	
<b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>






<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>Vlerësimi i vazhduar përbën një mënyrë të kujdesshme, të shpërndarë dhe të shtrirë në kohë të vlerësimit të studentëve. Kjo është konsideruar nga stafi dhe departamenti si metodë efciente dhe tashmë është institucionalizuar si mënyrë vlerësimi e testimit të njohurive dijeve dhe aftësive. Neni 64 i Rregullores së FEA-s përcakton qartë mënyrën e vlerësimit të studentëve përgjatë gjithë semestrit:</p> <p>Vlerësimi i studentit ndahet në dy pjesë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <b>Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit</b> për elementët e përcaktuar në programin e modulit, i cili përbën 30-50% të vlerësimit total të studentit.</li> <li>2. <b>Vlerësimi përfundimtar</b> në sezonin përkatës i cili përbën nga 50-70% të vlerësimit total të studentit.</li> </ol> <p>Përcaktimi i raporteve mes vlerësimit të vazhduar gjatë vitit dhe vlerësimit përfundimtar bëhet nga pedagogu/pedagogët në programin e modulit dhe miratohet para fillimit të çdo viti akademik nga Përgjegjësi i departamentit.</p> <p><i>(Aneks 12 Rregullore e FEA_s neni 64, 65. fq 32. E miratuar më datë 29.09.2017)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Një ndër pikat e forta të këtij programi, të vlerësuar nga diskutimet me studentët por edhe stafi, por edhe të institucionit në përgjithësi është transparenca dhe mënyra e vlerësimit në kohë të studentëve. Konsiderohet si transparenca dhe mungesë abuzimi nga studentët përdorimi i kësaj metode, ku askush nuk mund të shohë vlerësimet e tjetrit, duke ruajtur në këtë mënyrë privatësinë e studentit dhe rritur të drejtën për informim. Universiteti Bujqësor i Tiranës ka vënë në dispozicion <i>websitin</i>, ku vlerësimi i vazhduar, po dhe ai përfundimtar ju shfaqet për çdo lëndë studentit dhe ai mund të interesohet te pedagogu nëse do të rishqyrtojë testin dhe mënyrën e vlerësimit të bërë për provimin përkatës. <i>(Aneks 11 Rregullore e Brendshme e DMTR. Neni 41, Fq 20, 21 e miratuar më datë 27. 09. 2017)</i>. Në programin e studimit bachelor MTR ka nga ato lëndë, ku provimi përfundimtar zhvillohet në kompjutera si p.sh informatika, ku vitet e mëparshme një pjesë e provimit realizohej në kompjutera për të kontrolluar mënyrën se si studenti realizon ushtrime të caktuara praktike. <i>(Aneksi 15 Syllabuset e Programit MTR)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Brenda departamentit që ofron programin e studimit ka një procedurë të instaluar, e cila në fakt përdoret për të gjitha programet dhe është standarte. Kështu, komisioni i provimit përcaktohet nga Përgjegjësi i Departamentit në bashkëpunim me Zv. Dekanin për mësimin dhe miratohet nga Dekani i Fakultetit. Çdo komision provimi përbëhet nga jo më pak se dy anëtarë.</p> <p>Nëse njëri nga pedagogët nuk mund të marrë pjesë në provim, ose kur përgjegjësi i departamentit e gjykon, ai përcakton pedagogun që do ta zëvendësojë. Në rast pamundësie zëvendësimi, me propozim të dekanit dhe miratim të Rektorit, provimi shtyhet jashtë sezonit brenda 5 ditëve nga përfundimi i tij <i>(Aneks 12 Rregullore e FEA-s neni 69. fq 34. E e miratuar më datë 29.09.2017)</i>.</p>



<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>UBT ka institucionalizuar dhe vlerësimin e njohurive duke standartizuar procesin. Për këtë që në nisje përdoren fletore tip, të cilat janë dizenuar në mënyrë të tillë, ku faqa e parë ka element të sigurisë. Aty bëhet sekretimi dhe ruajtja e anonimatit të studentëve. Nga ana tjetër në ambjentet e FEA_s, ku zhvillojnë mësim edhe studentët e programit Bachelor “Menaxhim i Turizmit Rual”, janë të monitoruara me sistem qëndror kamerash, si edhe me personel shërbimi që ka si detyrë kryesore ruajtjen e qetësisë dhe sigurisë për zhvillimin normal të procesit mësimor dhe provimeve. <i>(Aneks 12 Rregullore e FEA_s neni 64, 65. fq 32. E miratuar më datë 29.09.2017)</i></p> <p>UBT ka nënshkruar një marrveshje dhe panifikon të zbatojë nga Qershori 2019, aplikimin e një programi softëare për korigjimin elektronik të provimeve si dhe sekretimin e tyre.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Ka një rregullore që institucionalizon vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentit dhe variantet e ndryshme të reagimit të studentit si dhe rradhën e veprimeve të kryera. <i>(Aneksi 10 Rregullorja e Studimeve të MTR, Neni 21, Fq 7, 8 e miratuar më datë 27.09. 2017)</i></p> <p>Gjithë stafi akademik gjatë orëve të seminareve u ofron studentëve komente/feedback për performancën e tyre lidhur me përvetësimin e njohurive gjatë seminareve/testimeve të ndërmjetme, nivelit të përgatitjes/prezantimit të detyrave/projekteve të kursit dhe u jep këshilla/orientime atyre se si mund të përmirësojnë performancën në të ardhmen.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Bazuar në Nenin 70 të Rregullores së FEA-s:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndalohet hyrja në provim e personave të jashtëm, qofshin dhe anëtarë të personelit të Universitetit, me përjashtim të Drejtuesit të departamentit, e personave të tjerë të autorizuar me shkrim nga Dekani/Rektori/Rektorati për të kryer monitorim/ kontroll.</li> <li>- Studenti nuk lejohet të futet në provim nëse nuk disponon një nga mjetet e mëposhtme të identifikimit: librezën e studentit/ kartën e studentit/ kartën e indentitetit.</li> <li>- Gjatë provimit mund të lejohet përdorimi i mjeteve ndihmëse, por në asnjë rast i celularëve. Studenti që në provim përdor forma e mjete të palejueshme përjashtohet nga provimi. Në planet afatshkrutra të institucionit është edhe aplikimi i një softëare antiplagjiaturë për të bërë të mundur kontrollin e punimeve të studentëve para se studenti t’ a dorëzojë atë për mbrojtjen finale.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Sipas Nenit 65 të Rregullores së FEA:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve që studenti ka përvetësuar gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një moduli janë: testimi i ndërmjetëm/detyrat e kontrollit dhe provimi final.</li> <li>- Detyrat e kontrollit janë elemente të vlerësimit të vazhduar të nivelit të dijeve. Detyrat e kontrollit organizohen në javën e tetë të çdo semestri, mbi bazë grupi mësimor dhe vetëm gjatë orëve të</li> </ul>



	<p>planifikuara për seminare. Detyrat e kontrollit organizohen vetëm me shkrim.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Provimi final organizohet a) me shkrim, b) me gojë, ose c) i kombinuar (me shkrim e me gojë). Departamenti përcakton nëse pjesa me shkrim e provimit mund të jetë përcaktuese apo eliminuese.</li> <li>- Mënyrat e kontrollit të dijeve si më sipër përcaktohen në programin e modulit dhe planin mësimor të studimeve dhe i bëhen të njohura studentit në fillim të procesit mësimor.</li> </ul> <p>Më tej, Neni 70 i Rregullores së FEA-s përcakton se: Rezultatet e provimit hidhen në sistemin online nga komisioni i provimit brenda dy ditëve kur provimi është me gojë dhe brenda 8 ditëve kalendarike nga data e kryerjes së provimit kur provimi është me shkrim ose i kombinuar me shkrim dhe gojë.</p> <p><i>(Aneks 12 Rregullore e FEA_sneni 70. fq 34. E miratuar më datë 29.09.2017).</i></p> <p><i>(Aneks 12 Rregullore e FEA_sneni 65. fq 32. E miratuar më 29.09.2017).</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Po sipas Nenit 70 të Rregullores së FEA-s:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pas shpalljes së rezultateve dhe hedhjes së tyre në sistemin online, studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi nga ana e tij, ose të kundërshtojë rezultatin e marrë brenda dy ditëve (48 orë) nga data e hedhjes së rezultateve. Komisioni i provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit me tezën e zgjidhur. Mbas këtij afati, nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni ka detyrimin të bëjë mbylljen përfundimtare të procesverbalit në sistem brenda dy ditëve.</li> <li>- Në rastet e hedhjes së gabuar të notës nga ana e komisionit, në lidhje me vlerësimin e studentit, komisioni ka detyrimin të verifikojë dhe të bëjë korrektimin vetëm brenda kohës prej 12 ditësh. Mbas rezultati është hedhur dhe pranuar në sistem, dhe ka kaluar afati kohor i 12 ditëve (nga dita e provimit), sistemi mbyllet dhe komisioni nuk ka më të drejtë të bëjë ndryshim.</li> <li>- Në raste të jashtëzakonshme mbas këtij afati kohor (12 ditëve), komisioni i paraqet një kërkesë me shkrim Përgjegjësit të departamentit ku zhvillohet moduli për ndryshimin e notës së pretenduar dhe me miratimin e Dekanit të Fakultetit korrigjohet nota në sistem nga specialisti përgjegjës i IT-së së UBT, i cili depoziton praktikën dokumentare tek ZSS. Procesverbalit i korrigjuar arshivohet në ZSS.</li> </ul> <p>Mbas hedhjes përfundimtare në sistem të notave, komisioni printon pasqyrën përfundimtare të rezultateve të provimit, i plotëson me firmat e nevojshme (komisionit, përgjegjësit të departamentit /dekanit) dhe e dorëzon tek Sekretaria e departamentit, e cila më tej i dorëzon në ZSS.</p>






	<i>(Aneks 12 Rregullore e FEA-s neni 70. fq 34. E miratuar më datë 29.09.2017).</i>			
<b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	<p>Neni 73 i Rregullores së FEA-s përcakton qartë procedurat e ankimit të studentëve dhe të trajtimit të ankesave:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Studenti ka të drejtë të ankimojë në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat proceduriale gjatë zhvillimit të provimit ose nuk është dakord me vlerësimin e bërë. Ankesa bëhet me shkrim brenda ditës së zhvillimit të provimit, ose brenda 2 ditëve (48 orëve) pas shpalljes së rezultatit dhe i drejtohet Dekanit të fakultetit.</li> <li>- Kjo ankesë shqyrtohet nga Dekani, i cili mund të thërrasë për sqarime Përgjegjësën e departamentit përkatës, Komisionin e provimit, si dhe vetë Studentin. Ai përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës. Ky vendim është i formës së prerë.</li> <li>- Kur ankesa është e drejtë, Dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit për të cilin studentin është ankuar dhe vendos në bashkëpunim me përgjegjësën e Departamentit, që studentin të rijapë provimin, me një komision me anëtarë të tjerë, në një datë tjetër brenda sezonit, ose jashtë tij, por jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i sezonit përkatës të provimeve. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, si dhe vendimi i marrë regjistrohen në regjistrin e ankesave të studentëve që mbahet në dekanat</li> </ul> <p><i>(Aneks 12 Rregullore e FEA-s neni 73. fq 35. E miratuar më datë 29.09.2017).</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

<b>Standardi III.7</b>	
<b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	<p>Që në nisje duhet thënë se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Studentët e kanë gjetur veten në të dy drejtimet në punësim dhe karrierë: në kurrikulave dhe përfshirë në të (gjenden module që furnizojnë me njohuri, aftësi dhe kompetenca në të dy drejtimet) dhe vlerësuar përmes gjurmimit të studentëve (për të marre feed back e tyre pas diplomimit).</li> <li>• Nga ana tjetër rritja e vlerësimit nga studentët ndër vite identifikohet edhe përmes ndryshimit të perceptimit në përzgjedhjen që bëjnë studentët e këtij program, tashmë studentët zgjedhin si degë të parë menaxhimin e turizmit rural në zgjedhjet e tyre.</li> </ul>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nga ana tjetër diplomimi i tyre si menaxhere të turizmit lë hapësirë dhe shteg për profilizime apo trajnime të tjera të mëtejshme përmes profilizimeve të mëtejshme.</li> </ul> <p>Një ndër strategjitë afatmesme të institucionit, në funksion të ritjes së aftësive krijuese të studentit por edhe testimi të identifikimit të të gjithë aftësive të tij, është që në afatin e gjatë synohet që shpërndarja e pikëve brenda një moduli të bëhet 50 me 50, gjykohet që student ti shpërndajë sa më shumë pikët gjatë vitit dhe të mos i ketë vetëm në provim. Kjo ka ardhur ndër vite, është një vendimarrje e kujdeshme që ka vite që propozohet nga stafet, dhe studentët me qëllim që të asimilohet sa më shumë lënda gjatë vitit. Detyra apo projekti i kursit po synohet që të përfshihet sidomos në lëndët/modulet profesionale madje kjo shikohet dhe si penalizuese sepse rrit aftësitë krijuese të studentit. Ky ndryshim gradual është perceptuar pozitiv nga studentët, dhe kjo është treguar nga analizat e pyetësorëve që bëhen në fund të vitit, analizat e pyetësorëve e kanë treguar këtë. Është konstatuese se studentët kanë ndjeshmëri dhe kërkojnë një rezultat sa më të lartë gjatë vitit e cila do t'i cojë ata në një rezultat sa më të lartë në fund, por mbi të gjitha do të shërbejë si instrument të testojë aftësitë e tyre profesionale por edhe të zhvillojë e nxisë edhe ato krijuese.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Program i menaxhimit të turizmit rural përbën një gërshetim unik, të natyrshëm dhe cilësor të kombinimit të moduleve, të aftësive dhe kompetencave që ato zhvillojnë si dhe të plotësimit që i bëjnë njëra tjetrës në funksion të rritjes së kapacitetit të studentëve për t'u përballur jo vetëm me tregun vendas por edhe me atë të huaj. Mjaft prej moduleve janë mjaft bashkëkohore dhe të trajtuara edhe në kurrikula ndërkombëtare mjaft të rëndësishme. Kjo ka bërë që ky program të integrojë qasjen ndërkombëtare në edukimin për turizmin rural me nevojën kombëtare për menaxherë të turizmit rural. Në programin e studimit Bachelor MTR, 50% të lëndëve të kurrikulës e zënë <i>lëndët karakterizuese</i> për zhvillimin e aftësisë në fushën e menaxhimit të bizneseve të turizmit rural, (Komunikim Biznesi, Sjellja e Konsumatorit Turistik, Kontabilitet, Marketingu i Turizmit, Drejt. i Bur. Njerëzore, Drejtim Turizmi, Ek.e Bur. —Nat. &amp; Mjedisit, Zhvill. Rural i Qendrushem, Ekonomia e Turizmit, Sip. &amp; Dr. i Biz. të Vogel, Drejtimi i Fermave, Strategjitë &amp; Politikat e Turizmit). Në kurrikul egzistojnë dhe <i>lëndë ndërdisiplinore</i>, që zënë 14% të lëndëve të kurikulës, si <i>dhe lëndë plotësuese dhe me zgjedhje</i>. (Aneks 45 Kategorizimi i Lëndëve, Bachelor, MTR, 2018-2019) (Aneks 15 Syllabuset e Programeve të MTR)</p> <p>Kompetencat që fiton studenti përvece të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, të analizuara përtej analizave e shqyrtimit në përfundim të çdo lënde, apo përtej analizave periodike e vjetore por në cdo rast të mundshëm qoftë me përgjegjësin e departamentit apo me njëri tjetrin, janë rezultat i përpjekjeve të vijueshme të të gjithë departamentit që në kaq pak vite ka maksimizuar forcat dhe përmirësuar dukshëm cilësinë dhe vijon të përpiqet për të</p>



	<p>rritur cilësinë e produktit duke qënë i ndërgjegjshëm me sfidën me të cilën është përballur në kaq pak vite që kur është hedhur në treg.</p> <p>Në syllabuset e çdo lënde studentët gjejnë informacion në lidhje me kompetencat dhe aftësitë që marrin në modulën përkatës.</p> <p>Në javën e fundit të semestrit, pedagogët e moduleve realizojnë një përmbledhje dhe rishikim të kompetencave dhe aftësive që synoheshin të arriheshin nga ana e studentëve në përfundim të modulit. Njëkohësisht, merret edhe feedback nga ana e studenteve lidhur me objektivat e vendosura për këtë qëllim.</p> <p>Në javën e fundit të semestrit studentët orientohen në lidhje me çështjet më të rëndësishme ku do të përqëndrohet përgatitja e tyre për provimin final, strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë ky provim si edhe për peshën që do të ketë ai në notën përfundimtare.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Përgjithësisht personeli akademik i brendshëm integron të reja më të fundit të shkencës dhe teknologjisë në informacionin që iu jepet studentëve gjatë orarit normal të zhvillimit të modulit dhe jashtë tij kur është e nevojshme. Përsa i përket personelit të ftuar, departamenti ka krijuar ekperiencën e vet si me të ftuar brenda vendit ashtu edhe me jashtë tij, si me akademikë e profesorë ashtu edhe me menaxhere të bizneseve turistike, si të ftuar në UBT ashtu edhe në bizneset ku zhvillohet agroturizmi, si bazuar në përpjekjet individuale të stafit ashtu edhe në ndërgjegjësimin tashmë të kthyer në traditë të të gjithë departamentit për rrugëtimin e bashkëudhehequr nga filozofia e drejtuesit të këtij departamenti. Nga ana tjetër, edhe projektet Erasmus të ftuar nga Universitetet partnere në kuadër të projekteve Erasmus+ të cilët japin leksione me studentët për përmbajtjen e të cilave bihet dakort paraprakisht me departamentin.</p> <p>Synohet që përmbajtja e leksioneve jashtë programit të studimit të përfshijë të reja më të fundit të shkencës dhe/ose teknologjisë së informacionit. Format e mësimdhënies në programin e studimit Bachelor MTR, përveç leksioneve janë dhe seminarët, të cilat aplikojnë çdo njohuri të marrë në leksione duke i zbatuar ato me asistimet në bizneset e agroturizmit apo bizneset e turizmit rural. Por, duke konsideruar, gjithashtu se Teknologjia e Informacionit dhe komunikimit është tashmë esenciale në formimin e menaxherëve të bizneseve turistike, rëndësi e madhe u është dhënë edhe përdorimit të softëare, që ndodhen të instaluar në laboratorët e programit të studimit. Këto softëare shkarkohen në fillim të fillimit akademik dhe instalohen në kompjuterat e laboratorëve përkatës p.sh Dev C++, SQL server, Ubuntu, Visual Studio, që përdoren përkatësisht për lëndët, Hyrje në Informatikë, Database dhe Menaxhimi, Sistemet e Shfrytëzimit, ASP.net dhe C#.</p> <p><i>(Aneks 15 Syllabuset e Programit të MTR)</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e</p>	<p>Për module të caktuara të kurrikulës, pas dhënies së informacionit teorik për grup kompetencash, studentët testohen t'i aplikojnë këto kompetenca në laboratorë kompjuterikë. Pas kësaj vihen të punojnë në grupe prej tre apo katër studentësh, punë e cila materializohet në një</p>





<p>problematikave/çështjeve të caktuara.</p> <p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>detyrë apo projekt kursi ku qëllimi është testimi i kompetencave të fituara. Personeli akademik në mënyrë të vazhdueshme mbështet, orienton dhe instruktin grupin e studentëve në realizimin e detyrës së caktuar (raste studimi / situatë reale tregu apo simulim i zgjidhjes së një problemi biznesi).</p> <p>Për të siguruar një vijimësi dhe siguri që përpjekjeve që stafi dhe përgjegjësi i departamentit bën për të integruar studentët dhe rrisin cilësinë, me ate cka kanë interes studentet nga ana e tyre, I gjithë departamenti mundohet të përfshijë studentët në opinione e mendime si për mësimdhënien ashtu edhe në sugjerimet që ata mund të japin për studime të avancuara apo nevoja të ndryshme që mund të kenë. Në këtë proces, personeli akademik mbështet idetë novative të studentëve në zgjidhjen e problemeve të biznesit dhe identifikon fushat dhe momentet që kanë nevojë për më tepër informacion dhe studim të mëtejshëm. Këto probleme pastaj bëhen objekt i kërkimeve të mëtejshme duke u materializuar në tema masteri, por edhe tema doktorature për kërkuesit e rinj në të ardhmen.</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p> <p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Një nga elementët e pjesëmarrjes në kërkimin shkencor për studentët është pjesëmarrja në temat e diplomave. Ato janë etapat e para të cilat përfshijnë studentët në procesin e kërkimit. Studentët e MTR realizojnë diplomat bachelor në nivelin e parë ku kërkimet të vlerësuara më mire, me nota me të larta, mund të shërbejnë si bazë për tu prezantuar në konferencat e posacme të shoqatës studentore. Shoqata e studentëve të ka organizuar 6 konferenca studentore, një për secilin vit në 6 vitet e fundit, synimi është përfshirja e materialeve kërkimore nga studentët që synohet të gjejnë zgjidhje inteligjente për probleme të ndryshme që prekin sektorët e bujqësisë, agrikulturës e agroturizmit, financë-kontabilitetin, informatikën e lidhur me biznesit ejt. Studentët e vitit të tretë të diplomës bachelor janë vetë organizatorë të këtij aktiviteti duke u atachuar gjithashtu me studentë të Masterit Shkencor të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit, sigurisht të ndihmuar edhe nga pedagogët e rinj të FEA.</p> <p>Në funksion të trainimit të vazhdueshëm të personelit akademik për përmirësimin e atyre në procesin e mësimdhënies DMTR në kuadër edhe të marrëveshjeve të UBT ka marrëveshje të tilla që mundësojnë gjithashtu mobilitetin e studentëve. <i>(Aneks 4 Accordo Doppio Titolo Albania_ Firmato, Marrveshja për diplomë të dyfishtë mes UBT dhe Universita Politecnica delle Marche, miratuar më 20.10.2014)</i> Marrëveshja me Universitetin politeknik të marche ka pikërisht si funksion kryesor mobilitetin e studentëve për të përfutur diplomë të dyfishtë, nëpërmjet njohjes së dyanëshme të saj dhe të kurrikulës. Tashmë dy studentët janë marrë diplomë të përbashkët. <i>(Aneks 4 Accordo Doppio Titolo Albania_ Firmato, Marrveshja për diplomë të dyfishtë mes UBT dhe Universita Politecnica delle Marche, miratuar më 20.10.2014).</i></p> <p>Në funksion të mësimdhënies edhe mobilitetet e pedagogëve kanë qënë të rëndësishme si në programin e mësipërm ashtu edhe në programin Erasmus +.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



	<p>Kështu Marrëveshja ndërkombëtare Erasmus + Programme me Sunderland London University, ka qenë gjithashtu në këtë funksion si edhe në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të pritshëm në një marrëveshje dypalëshe për departamentin. <i>(Aneks 5 London Erasmus + Programme -03052018, Mobility for learners and staff – Higher Education Student and Staff Mobility mes UBT dhe Sunderland London University, miratuar më 02.05.2018).</i></p> <p>Krahas dy marrëveshjeve të sipërpërmendura, programet e tjera të bashkëpunimit në FEA kanë krijuar përfitime në mobilitete për studentët dhe pedagogë të DMTR.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

<b>Standardi III.8</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final</p>	<p>Lidhur me provimin final dhe mbrojtjen e diplomës DMTR harton një procedurë të posaçme ku përfshihen disa hapa. Kështu departamenti u bën të njohur programet e provimit të formimit studentëve të vitit të tretë brenda një periudhe një mujore nga fillimi i vitit akademik. Këtu përfshihet si mbështetëse Sekretaria Mësimore dhe ajo e DMTR_s dhe informon studentët rreth organizimit të provimeve të formimit. <i>(Aneksi 10 Rregullore e Studimeve të MTR_s, Neni 39, 40. Fq. 12 miratuar më datë 27.09. 2017)</i></p> <p>Gjithashtu brenda muajit të parë DMTR, bën një listë të studentëve që planifikohen të mbrojnë diplomën me një kërkim të tyre, bazuar në mundësitë e departamentit për udhëheqje dhe rezultatet e studentëve. Mund të përfshihen në këto udhëheqje edhe specialist të kualifikuar nga institucione të tjera kërkimore, në rastet kur kërkesat e studentëve për tema diplome janë më të mëdha sesa mundësitë që ofron departamenti,</p> <p>Temat e diplomës udhëhiqen nga punonjësit mësimor-shkencor të DMTR_s_që kanë titull ose gradë shkencore (së paku Master), nga punonjësit shkencorë të instituteve kërkimore, që i përshtaten studimeve në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit dhe që kanë kualifikim të lartë, si dhe nga shkencëtarë të huaj të fushës përkatëse të diplomimit.</p> <p>Kjo përbën edhe një mënyrë për të integruar stafin e brendshëm me eksperiencën e atij të jashtëm, ose për më shumë për të patur një mundësi që studentët të realizojnë një kërkim sado të vogël në biznese aktuale shqiptare duke pasuruar bibliotekën e departamentit por edhe duke vijëzuar mbështetjen që departamenti i bën biznesit vendas në çështje të agroturizmit dhe turizmit rural, por jo vetëm, edhe në manaxhimin e përgjithshëm të turizmit.</p>



apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.	<i>(Aneksi 10 Rregullore e Studimeve të MTR_s. Neni 41. Fq. 12, 13 miratuar më datë 27.09. 2017)</i>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p> <p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p> <p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Institucioni por edhe i gjithë departamenti organizohet në mbështetje të studentit duke konsultuar dhe orintuar jo vetëm me literaturë më të mirë dhe përshtatshme për studentët por edhe orintuar për të shfrytëzuar burime individuale, kërkime të vetë pedagogëve mbi fushën, e gjitha kjo me qëllim për të rritur gamën e literaturës së konsultuar apo studimeve të ngjashme. I gjithë stafi është i ndërgjegjshëm për rëndësinë e diplomimit dhe vlerësimit sa më cilësor të tij, për këtë arsye cdo anëtar i stafit mbështet cdo student, pavarësisht udhëheqjes personale me pedagogë të caktuar, duke maksimizuar në këtë mënyrë mundësinë e bërjes së një diplome dhe studimi sa më cilësor.</p> <p>Udhëheqësi i punimit të diplomës përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të realizimit të tij. Studenti duhet të respektojë afatet e vendosura për të bërë të mundur mbrojtjen me sukses të temës në sezonin normal të mbrojtjes së diplomës. Udhëheqësi përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin, përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë sipas programit të miratuar. Grafiku i konsultimeve është i detyrueshëm të zbatohet nga studentit dhe pedagogu.</p> <p>Në përfundim të kursit të plotë të studimeve, studenti ka të drejtë të diplomohet për të fituar diplomën përkatëse.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Diplomimi bëhet me mbrojtjen e një punimi diplome, ose me provim të përgjithshëm përfundimtar.</li> <li>- DMTR përcakton fushën e punimeve të diplomave në fillim të semestrit të pestë për studimet e ciklit të parë dhe në fillim të semestrit të dytë për studimet e ciklit të dytë. Ky përcaktim bëhet duke u mbështetur në fushat e studimit, që mbulon DMTR.</li> <li>- Drejtuesit e temave të diplomës miratohen nga përgjegjësi i departamentit.</li> <li>- Formatit i paraqitjes së punimit të diplomës për tëdynamit përcaktohet në rregulloren e departamenteve.</li> </ul> <p><i>(Aneks 11 Rregullorja e Brendëshme e DMTR_s dhe Aneks 1. Fq. 33. Miratuar më datë 27.09.2017)</i></p> <p>Temat e diplomës dhe provimet e formimit në DMTR vlerësohen nga i njëjti komision vlerësimi. Komisionet e vlerësimit përbëhen nga jo më pak se 5 anëtarë, propozohen nga DMTR dhe miratohen nga Dekani i FEA_s.</p> <p>Për vlerësimin e temave të diplomave, komisionet e vlerësimit konsiderojnë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. punimin e paraqitur në formë të shkruar e të lidhur;</li> <li>b. prezantimin e punimit për diplomë nga ana e studentit gjatë mbrojtjes në komision;</li> <li>c. përgjigjet e studentit ndaj pyetjeve të komisionit;</li> </ol>






	<p>Para mbrojtjes së punimit të diplomës, udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studenti dhe lejon mbrojtjen e tij duke e firmosur atë. Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar është gjithpërfshirës, me tematika nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në përfundim të studimeve në bachelor MTR, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës. <i>(Aneksi 10 Rregullore e Studimeve të MTR_s. Neni 42. Fq. 13 miratuar më datë 27.09. 2017)</i></p> <p>Studenti që kalon me sukses temën e diplomës/provimin e formimit pajiset me diplomën përkatëse, e cila i jepet atij së bashku me “Shtojcën e Diplomës” <i>(Aneks 96Diploma Supplement)</i>.</p> <p>Diplomat e Ciklit të Parë të Studimeve (Bachelor) shoqërohen me Shtojcën e Diplomës.</p> <p>Modeli i miratuar i Shtojcës së Diplomës, i bashkëlidhet Rregullores së Studimeve Universitare.</p> <p><i>(Aneksi 10 Rregullore e Studimeve të MTR_s. Neni 42. Fq. 13 miratuar më datë 27.09. 2017)</i></p> <p>Përgatitja, dhënia e diplomës dhe diplomës suplement.</p> <p><i>(Aneks 53 Rregullore DZHKKVI &amp; DITNJ_2017, Neni 15. Fq 12 miratuar në Shtator 29.12.2017)</i></p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p> <p><b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>Studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, vetëm në rastet, kur ai e kërkon këtë gjë. Në raste të tilla, studentët depozitojnë pranë ZSS (Zyra e Studimit dhe Studentëve) një kërkesë dhe brenda një afati të caktuar u jepet një kopje e firmosur dhe e vulosur e programit të ciklit të studimit bachelor Menaxhim i Turizmit Rual.</p> <p>Dokumentacionit për studentët ruhen nga IAL për një periudhë të pacaktuar në hard kopje (regjistrat e mëdhenj të studentëve), si dhe në databazën digitale, që tashmë disponon UBT, sistemi ESSE3.</p> <p>Dokumentacioni hard copy ruhet në ambjentete e ZSS_së UBTs.</p> <p>Diplomat e Ciklit të Parë të Studimeve (Bachelor regjistrohen në regjistrin shtetëror të diplomave dhe çertifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, që mbahet në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve. Neni 44</p> <p>Regjistrimi i diplomave në regjistrin shtetëror të diplomave <i>(Aneksi 10 Rregullore e Studimeve të MTR_s. Neni 45. Fq. 13 miratuar më datë 27.09. 2017)</i></p> <p>Sekretaritë e sistemit të ZSS_s(Punonjësit e shërbimeve ndaj studentëve).</p> <p>Pranimi i kërkesave të studentëve për ndryshim profili, sistemi dhe transferim studimesh.</p> <p>Përgatitja dhe dhënia e vërtetimeve të ndryshme pas përfundimit të ciklit të studimeve.</p> <p>Konfirmimi i përfundimit të ciklit të studimeve.</p> <p>Përgatitja dhe dhënia e vërtetimeve, sipas kërkesës së studentëve si: (vërtetime si studentë, listës së pjesshme të notave, listë notash, vërtetime diplomimi etj).</p>






	Përgatitja, dhënia e diplomës dhe diplomës suplement. Konfirmimi i vërtetësisë së diplomës. Përgatitja dhe dhënia e listave të notave. Përgatitja dhe dhënia e vërtetimeve të diplomës me foto. Përgatitja dhe dhënia e programeve të studimit. (Aneks 53 Rregullore DZHKKVI & DITNJ_2017Neni 15. Fq 12. Miratuar në Shtator 2016)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.	Dokumentacioni lidhur me personelin e institucionit, përfshirë personelin akademik dhe atë mbështetës menaxhohet nga drejtoria e menaxhimit të dokumentacionit personal të punonjësve dhe regjistrave themeltar (Aneks 58/1 rregullorja e burimeve njerëzore UBT 2018). Drejtoria e Burimeve njerëzore menaxhon dosjet personale të të gjithë punonjësve, dokumentacionin personal të cdo punonjësi, librezën e punës dhe ndryshimet në dosje për shkak të zhvillimit të karrierës dëshmitë e kualifikimeve të mtejshme të stafit. Aneksi 76 paraqet formatin e dosjes personale që duhet të ketë cdo pedagog me të gjithë elementët. Nga vizita në zyrën e burimeve njerëzore, u evidentuan mbajtja e të dhënave dhe dosjeve me të gjithë elementët, duke bërë një përzgjedhje me dy anëtarë të stafit dhe u pa saktësia e mbajtjes së informacionit për stafin .
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	UBT ka hartuar “Rregulloren për Rekrutimin e stafit akademik ndihmës dhe administrative në UBT”, e cila bazohet në Ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë, Kodin e Punës në RSH, statutin dhe rregulloren e UBT. Drejtoria e Burimeve Njerëzore ndjek gjithë procedurat për plotësimin e vendeve vakante në strukturë me rekrutimet. Procedura e verifikuar nga dokumentacionet mbështetëse dhe nga vizita në terren përfshin disa hapa të rëndësishme që nga shpallja e vendit vakant në APP, hartimi i ofertës së punës, kriteret e pranimit, ngritja e komisioneve, vlerësimi i dosjeve, zhvillimi i konkursit, informacioni përfundimtar dhe vendimi i emërimit. Procedurat, afatet e dorëzimit të dokumentacionit, procedura e konkurrimit, rezultatet, afatet e ankimimit janë objekt i rregullores



	(Aneks 58/2 – rregullorja për rekrutimin e stafit UBT, Aneks 78 Urdhër i ngritjes së komisionit të rekrutimit).			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	Kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit janë pjesë e rregullores së Drejtorisë së burimeve njerëzore. Një element i rëndësishëm përgjatë procedurës është përcaktimi i kritereve të rekrutimit ku një rol të rëndësishëm luan komunikimi me departamentin dhe dekanatin përkatës, sipas intervistës me drejtorin e burimeve njerëzore. Ndërsa kriteret e përgjithshme përcaktohen nga Senati i Institucionit, kriteret e vecanta përcaktohen nga njësia bazë, sipas nevojave të saj për staf akademik dhe miratohen nga Rektori. Në rastet kur ka kritere të vecanta ato lidhen kryesisht me kualifikimet e mëtejshme, eksperiencën brenda e jashtë vendit dhe sidomos të lidhur me pozicionin vacant, lëndët apo modulet e pambuluara dhe detyrat lidhur me programin specific. (Aneks 79 kriteret e vlerësimit të kandidatëve të punësimit UBT).			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Ashtu sikurse u argumentua edhe në kriterin 3 të standartit IV.1 kriteret e përgjithshme dhe kriteret specifike përcaktohen përkatësisht nga Senati dhe Departamenti. Aneksi 58/2 evidenton gjithë procedurën, ku një pjesë të rëndësishme e zën mënyra e përcaktimit të kritereve dhe procedura. Edhe nga vizita në institucion, pranë zyrës së burimeve njerëzore u evidentua se kriteret specifike lidhen me departamentin dhe çfarë kërkon ai nga stafi lidhur me kualifikimet, trainimet, diplomat, specializimet, puna kërkimore, fusha e studimit, gjithnjë që të jetë në përputhje me modulet, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

**Standardi IV.2**

**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Angazhimi i institucionit për krijimin e mjedisit dhe mundësive të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit, përfaqësohet nga nivelet drejtuese të institucionit në përgjithësi dhe nga nivelet drejtuese të departamentit në vecanti. Në të gjitha dokumentet strategjike bazë, Statuti, Strategjia rregullorja e UBT, rregullorja e DMTR, shprehet garancia për lirinë akademike të pedagogut dhe për trajtimin e përshtatshëm e të barabartë të stafit akademik. Garant për këtë është përgjegjësi i departamentit, që drejton gjithë veprimtarinë mësimore-shkencore në department, dhe ka përgjegjësinë për mundësitë e barabarta, lirinë akademike dhe të kërkimit, të drejtat e studentëve. Përgjegjësi i departamentit është garant i realizimit të duhur nga të gjithë të veprimtarive mësimore kërkimore, për këtë është përgjegjës për kontrollat e ushtruara nga institucioni. (Aneks 11, Aneks 12)
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e	Personeli që mbulon programin e studimit përbëhet nga 32 pedagogë efektivë, staf i jashtëm dhe i ftuar (Shiko Aneks 33, Ngarkesa e stafit).

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



<p>mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Personeli i brendshëm përbëhet nga 30 pedagogë (7 Prof. Dr; 12 Prof As; 6 Dr; 5 Msc), ndërsa personeli i jashtëm nga 2 pedagogë (1 Dr dhe 1 Msc). Kualifikimi i pedagogëve të DMTR ashtu sikurse edhe pedagogëve të tjerë të fakultetit dhe Universitetit ka qenë ndër shqetësimet e drejtimit të Universitetit. Kushtet që ky drejtim duke u nisur nga nivelet e larta, në nivel fakulteti dhe më pas në nivel departamenti lidhen kryesisht me krijimin e lehtësive të nevojshme për realizimin e zhvillimit profesional, lehtësi të lidhura me kohën në dispozicion, organizimin dhe menaxhimin e aktiviteteve, por edhe krijimin e mundësive për pjesëmarrje në konferenca, Brenda e jashtë vendit, duke mbështetur pjesërisht këto pjesëmarrje. U jepet mundësia dhe informacioni stafit për realizimin e mobiliteteve me programin Erasmus+, por edhe me projekte apo programe të tjera të punës kërkimore shkencore. Si rrjedhim i kësaj mbështetjeje por sidomos edhe bazuar mbi kërkesën e vazhdueshme të vetë stafit për kualifikime, evidentohen disa raste të rritjes dhe zhvillimit të karrires së pedagogëve (Aneks 81 – të dhëna të plota mbi kërkimin shkencor të stafit). Në FEA janë realizuar një numër i madh projektesh, rreth 61 të tilla në 3 vitet e fundit dhe kjo është evidencë e krijimit të kushteve të mira për një punë kërkimore – shkencore.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Lidhur me metodat e mësimdhënies, UBT ka qenë i përqendruar për të përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme ato, me qëllim që të përshtaten me tregun, por edhe të jetë më shumë konkurrues me institucione të tjera brenda vendit. Aneksi 64,) udhëzues për metoda inovative në mësimdhënie), është dokumenti që parashton metodat dhe përdorime teknologjive të informacionit në mënyrën sa më efektive gjatë procesit të mësimdhënies, me synimin për të nduhmuar atë.</p> <p>UBT është angazhuar së pari në metodat inovative që lidhen me e-learning, ose Mësimin elektronike, ndryshe të mësuarit përmes përdorimit të Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit. Në këtë kontekst përdorimi i TIK në mësimdhënie, si pjesë e fakultetit dhe departamentit MTR, ka ndikuar për standartizimin e formave dhe mjeteve të mësimdhënies, duke u bërë më tërheqës për studentët, më fleksibël, duke krijuar akses më të lehtë për studentët dhe kështu duke përmirësuar cilësinë.</p> <p>Ndër format e e-learning të evidentuara se po përdoren nga programi aktual i studimit janë Google Site, i cili po përdoret aktualisht për të ndërtuar faqet e pedagogëve individuale, dhe duke u mundësuar atyre që të mbledhin lehtë dhe shpejt gjithë materialet në një pikë të vetme aksesit për studentët dhe të interesuarit. Aty pedagogu mund të përditojë në mënyrë të vazhdueshme përmbajtjen, si leksione, syllabus, prezantime, detyra në mënyrë të lehtë dhe intuitive, duke mos patur nevojë për njohuri të sofistikuar profesionale.</p> <p>Forma tjetër është MOODLE, si një prej aplikacioneve që lejojnë menaxhimin e materialit mësimor dhe administrimin e procesit mësimor. Moodle krijon mundësi për një sallë virtuale, mjedis i dedikuar për mësimdhënie, që krijon mundësi për pedagogun për të publikuar</p>






	<p>materialet didaktike, për të zhvilluar aktivitete të ndryshme vlerësimi dhe të menaxhojë komunikimin me përdoruesitn.</p> <p>Një aspekt i tretë inovativ është përfshirë në kurrikul dhe lidhet me modulin me zgjedhje “njohuri mbi informacionin” në programin Bch të MTR. Ai është rezultat i projektit Tempus “Zhvillim i njohurive për informacionin, të mësuarit gjatë gjithë jetës”. Ky modul jep njohuri studentëve mbi mënyrat e gjetjes së informacionit, fokusimi tek çështja e kërkimit, realizimi i pyetjeve dhe rëndësia e strukturimit të burimeve të informacionit, aftësimi për të realizuar një punim shkencor etj.</p> <p>Gjatë vizitave në institucion kemi evidentuar gjithashtu edhe aspekte të metodave inovative që nuk lidhen vetëm me teknologjinë, por gjithashtu me përdorimin e literaturave bashkëkohore dhe metodave bashkëkohore në klasë që përfshijnë mësimin përmes veprimt, komunikimit dhe punës në grupe të studentëve. Janë përmendur këto si instrumenta nga pedagogët, po në disa raste edhe nga intervista me studentët.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Burimet njerëzore të institucionit janë angazhuar në mënyrë optimale për përbushjen e objektivave të programit. Ka një shpërndarje të ngarkesave mësimore sipas kualifikimeve në lëndët përkatëse të stafit të departamentit. Gjithashtu lëndët bazë dhe disiplinat karakterizuese, realizohen nga stafi i FEA. Ka personel mbështetës administrative dhe mësimor (labororet). Duke qene se DMTR nuk ka laboratore të veta, atehëre stafi mbështetës që mund të përbëjë problem, lidhur me ngarkesën dhe shërbimet që duhet tu ofrojë stafit pedagogjik, mund të duhet të përmirësohet, të shtohet, në varësi edhe të nevojave të departamentit. Gjithashtu institucioni merr profesorë të jashtëm ose profesorë të ftuar për të mbështetur procesin e mësimdhënies, duke përshtatur me modulin/lëndën që do të japë mësim.</p> <p>Mund të themi se angazhimi i institucionit është apotimal në përbushjen e këtij kriteri, për përbushjen e objektivave të programit. Për këtë institucioni ka sygjëruar dhe shërbyer për të implementuar një program të detajuar dhe të saktë të orëve të hapura të mësimdhënies, dhe gjithashtu orët që një mësimdhënës do të jetë në mësim të hapur, për të parë dhe për të marrë eksperiencë.</p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përbushet</b></p>	<p><b>Përbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p>
				✓

<p><b>Standardi IV.3</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p> <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të</p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p> <p>Ambjentet e FEA janë në dispozicoin të të gjithë studentëve dhe pedagogëve të fakultetit e si rrjedhim edhe të studentëve të degës së MTR. Ambjentet fizike vendosen në dy godina me salla leksionesh</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al






<p>numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>seminaresh dhe laboratorë për zhvillimin e lëndëve aplikative si Informatikë-, Ekonometri, kontabiliteti etj. Përkatësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Godina A, -me 2 kate, 7 salla leksionesh dhe 14 seminaresh si edhe 5 laboratorë</li> <li>• Godina B, me 4 kate, 8 salla leksionesh, 23 seminaresh dhe 2 laboratorë.</li> </ul> <p>Studentët dhe pedagogët kanë akses në dy ambjente bibliotekë, Ajo e Universitetit dhe ajo e FEA, ku hapësirat janë të bollshme dhe ka student që e frekuentojnë (vizita në institucion). (-Aneks 70 – kapacitetet infrastrukturore UBT) (Aneks 98 të dhëna për infrastrukturën e FEA)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Çdo sallë e leksioneve është pajisur me videoprojektor dhe pedagogët janë pajisur me laptop personal. Për cdo leksion mundësohet pra prezantimi PPT. Laboratorët janë të pajisur me një numër të konsiderueshëm kompjuterash duke patur parasysh grupet e studentëve. Pajisjet janë të reja në dy prej laboratorëve dhe situata është relativisht e kenaqshme për realizimin e orëve laboratorike (një kompjuter 2 student ose 1 student sipas rasteve të grupeve) Në laboratorë mungon videoprojektori apo pajisje që do ta bënin mësimin më ndërveprues dhe funksional në to.</p> <p>Biblioteka në kontekstin fizik është një aspekt i rëndësishëm për studentët dhe pedagogët, aty ka mjediset e domosdoshme për studim dhe kompjutera desktop në dispozicion për të aksesuar edhe bibliotekën dixhitale. UBT ka patur akses në bibliotekën dixhitale TEEAL (The Essential Electronic Agricultural Library), një bazë të dhënash me tekst të plotë). Nga vizita në ambjentet e bibliotekës u pa se akses në TEEAL ishte i kufizuar, për shkak të abonimit. Por ka akses në bibliotekën dixhitale në sistemin RASH.</p> <p>UBT po vzhdon përpjekjet për dixhitalizim në procesin e korrigjimeve të provimeve, vendosjen e barkodeve në provimet e studentëve, në marrëveshje me Albanian American Development Fund.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Sipas vizitave në institucion dhe në strukturat e FEA, u pa se laboratorët janë të përshtatur për realizimin e orëve të informatikës, financë, kontabilitet, ekonometri, duke patur mundësi të softëareve përkatës aplikativë për realizimin me rigorozitet të programit të këtyre lëndëve. Nuk ka akses në programe të cilat mund të shërbejnë specifíkisht degës së turizmit, por duhet thënë se ky aspekt nuk është i vendosur në programet e lëndëve përkatëse, ndaj mund të shihet si një aspekt për zhvillim dhe përmirësim të pak moduleve të tilla në të ardhmen.</p> <p>Anketimet e studentëve kanë dhënë vlerësim pozitiv për laboratorët dhe programet lidhur me profesionin e tyre.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose</p>	<p>Zhvillimi i praktikave profesionale realizohet sipas një procedure të qartë të përmendur më lart, në standartin II.5, kriteri 4 dhe që garanton</p>



në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	realizimin e praktikës mësimore në mjediset e kompanive/organizatave përkatëse. Për këtë realizohet një marrëveshje e qartë me institucionet që i garanton studentit vendosjen në mjediset e kompanive/organizatave përgjatë gjithë periudhës së praktikës (Aneks 35, Aneks 40). Është me rëndësi të theksohet se departamenti është përgjegjës për përcaktimin e vendit të praktikës, duke përfshirë dhe mjediset. Edhe në rastet kur student përzgjedh vetë vendin e praktikës, DMTR verifikon subjektin dhe fakulteti lidh marrëveshje bashkëpunimi me të. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e studentit dhe udhëheqësit të praktikës janë të shprehura në rregulloren përkatëse (Aneks 12, rregullore e FEA)			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

<b>Standardi IV.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Sic u përmend edhe në Standartin IV.3, kriteri 2 dhe 3, duke qenë se biblioteka është pjesë përbërëse e mjediseve të UBT dhe FEA, mundësitë e shfrytëzimit për të dy bibliotekat janë të barabarta për të gjithë studentët. Nga vizitat u vu re se biblioteka e FEA frekuentohej nga student, por më tepër në pjesën e kompjuterave, për projektet e kursit (pyetje e studentëve).</p> <p>Biblioteka përmban gjithë literaturën e nevojshme dhe të domosdoshme të lidhur me programet e studimit. Gjithë literaturat në formën e librave dhe revistave në gjuhën shqipe dhe të huaj janë të kategorizuara sipas standarteve të bibliotekave, ka punonjës të trainuar lidhur me organizimin dhe menaxhimin e bibliotekave. Numri i titujve është i lartë sin ë bibliotekën e UBT ashtu edhe në ate FEA (Aneks 71 statistika Biblioteka Mentor Përmeti). Ka patur përfitime të titujve nga Irlanda sipas një projekti Tempus – developing information literacy in western Balkans Countries. Ka po ashtu tituj të revistave, proceedings te konferencave kombëtare e ndërkombëtare, revista të Bankave dhe Instat, etj.</p> <p>Por patjetër që kërkohet një përditim me literaturat më të fundit. Sot ka vlerë më shumë aksesit on-line në bibliotekat dixhitale dhe kjo duhet të garantohet. Duke qene se ka bibliotekë dixhitale në dispozicion, do të ishte me vlerë garantimi i cilësisë së lartë të sinjalit internet ëireless, ku studentët dhe pedagogët mund të përdorin Laptop edhe personal, për të frekuentuar më shumë ambjentet e bibliotekës, duke përmirësuar cilësinë e kohës së tyre të studimit dhe kërkimit.</p>



<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Sic u përmend edhe më lart, Biblioteka e UBT ka patur akses falas në TEEAL, por tashmë ky akses është shumë i kufizuar vetëm në titujt dhe jo në aksesin e përmbajtjes së materialeve. Institucioni ka krijuar akses falas në burime të ndryshme online nga projekte të ndryshme si Research4life, Erasmus +, –si Springshare, LNSS. Megjithatë janë kryesisht burime për stafet akademike, por edhe studentët duhet të informohen dhe nxiten më shumë në përdorimin e këtyre burimeve. Duhet thënë se studentët e UBT dhe si rrjedhim të MTR kanë mundësi të menjëhershme për përdorimin dhe aksesin e burimeve online duke qenë se kanë një llogari në system dhe adresa e-maili institucionale.</p> <p>Programet kompjuterike dhe pajisjet teknike janë në nivele korrekte, <u>por sygjerojmë rritjen e infrastrukturave në dispozicion të bibliotekave, sidomos me aksesin on-line, që tani sigurohet edhe nga RASH, por edhe dhënie e mundësisë duke shtuar kompjuterat apo laptop për përdorim të studentëve, sinjalin e internetit etj</u></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>UBT ka një plan për përmirësimin e burimeve të bibliotekës dhe përditimin e fondit ekzistues në mbështetje të të gjitha programeve të studimit, si rrjedhim edhe të programit të MTR (–aneks 71 statistika biblioteka Mentor Përmeti).</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka u vihet në dispozicion studentëve në oraret e qëndrimit të studentit në universitet. Në statistikën e vendosura në dispozicion bien në sy numri i literaturave të përdorura dhe numri i përdoruesve 400-500 përdorues në muaj. Kapacitetet e bibliotekave me sallat përkatëse janë të përshtatshme dhe në mbështetje të zhvillimit të procesit mësimor, numrit të studentëve (–statistikat mbi numrin e posteve në secilën bibliotekë).</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			✓	

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>UBT është i organizuar dhe menaxhuar në mënyrë të tillë që në mbështetje të gjithë veprimtarisë së tij funksionon sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit. Ky system është në shërbim primar të studentëve me synim kryesor rritjen e cilësisë së shërbimit të tyre në cdo hallkë të procesit që kur regjistrohen e derisa diplomohen dhe sigurisht në këtë kontekst edhe të stafit pedagogjik, mësimor kërkimor dhe stafit administrativ. Sistemi i UBT, ESSE3 është i lidhur me rrjetin telematik Shqiptar për funksionimin e tij. Përmes ESSE 3 mirëmenaxhohet gjithë procesi duke ofruar gjithë funksionalitetin e nevojshëm për regjistrimin</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423


E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al






	<p>e studentëve, ofrimin e informacionit për programin e studimit, kurrikulën, planin mësimor, syllabuset, sistemin e vlerësimit dhe informacion mbi vlerësimet në cdo kurs dhe diplomimin. Sistemi ofron edhe informacionin e domsdoshëm për transferimet nga një universitet në tjetrin.</p> <p>Funskinet kryesore të ESSE3 realizohen përmes disa moduleve, si hapësira për përdoruesit si:</p> <p>-Zona didaktike, oferta akademike, menaxhimi i marrierës së studentit, provimi dhe diplomimi.</p> <p>Zona administrative: pranimi dhe regjstrimit, menaxhimi i studentëve hyrës dhe dalës, tarifat dhe menaxhimi i tyre, bursat, periudha financiare pas diplomimit, provimet e shtetit, shkolla e doktoraturës, specializime, internship.</p> <p>Kontakti i parë me studentin është regjistrimi përmes Zyrës së Studimeve dhe Studentëve (ZSS), e cila ka për objekt mbajtjen e të gjitha rekordeve të studentëve përgjatë viteve të tyre të studimit, në mënyrë të shkruar, në regjistra dhe në mënyrë elektronike. Ajo i pajis studentët me Username dhe passëord sapo ata realizojnë procesin e regjstrimit pas fitimit të të drejtës së studimeve. ZSS ka një përshkrim pune për secilën sekretare e cila menaxhon procesin e ruajtjes së informacionit dhe gjithashtu jep një ngarkesë të balancuar në programe për secilën prej tyre.</p> <p>Dokumentacioni i nevojshëm për mbajtjen e të dhënave dhe struktura e këtij dokumentacioni, përcaktohet në bashkëpunim me Zyrën e Zhvillimit të kurrikulave, karrierës dhe Vlerësimit Institucional –dhe miratohet nga rektori. Për të gjitha shpjegimet e funksionet të cilat janë shteruese lidhur me sistemin e brendshëm të menaxhimit të informacionit është ne dispozicion Aneks 53 rregullore e DZHKKVI dhe DITNJ.</p> <p>DZHKKVI është njësi ndihmëse e rektoratit, pjesë e strukturës organizative të UBT e ngritur bazuar në Ligjin 80/2015 dhe kalidhje të drejtpërdrejtë me zëvendësrektorin për mësimin. Ajo ndjek drejtpërdrejt gjithë problemet që kanë lidhje me procesin mësimor dhe si e tillë luan një rol të rëndësishëm në gjithë sistemin e menaxhimit të informacionit, por edhe në gjithë procesin e menaxhimit për ofrimin e shërbimit në UBT. Funksionimi i kësaj zyre tregon për një funksionalitet të mirë në menaxhimin e informacionit.</p> <p>Nga vizita në institucion vlen të vihet në dukje se funksionimi i sistemit ESSE3 dhe zyrave të sipërpërmendura ka cuar edhe në përmirësime dhe sygjerime të tilla si:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. gjenerimi automatikisht i të dhënave nga futja e mandateve të pagesave të studentëve</li> <li>2. futja e opsioneve lidhur me statusin përsëritës të studentit në mënyrë që të gjenerohen automatikisht nga sistemi në dokumentacionin përkatës</li> <li>3. futja e opsioneve të nevojshme si statuset “fiton”, “nuk u paraqit” etj duke parashikuar cdo gjendje të studentit lidhur me provimin dhe vlerësimin.</li> </ol>
--	--





	<p>4. Të ketë një alert sistemi kur ka plotësime të gabuara në vlerësime, apo të dhëna të tjera</p> <p>5. Dalja automatike e notave mbi bazën e sistemit</p> <p>6. Gjenerimi automatikisht i suplementit</p> <p>ZSS pretendon edhe sfida për të ardhmen në këtë drejtim, sidomos në lidhje me përditimin më të shpejtë të informacionit dhe opsionet lidhur me mirëmenaxhimin e kohës së pranimit të faturave (mundësi për pagesa me këste), për të përmirësuar cilësinë e shërbimit ndaj studentit.</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit të informacionit menaxhon informacionin lidhur me personelin akademik që lidhet kryesisht me syllabuset, programet, mësimdhënien dhe lidhjen me faqen e pedagogut (-aneks 82 print screen ESSE3).</p> <p>Edhe personeli ndihmës administrativ ka hapësirën e vet në system, sidomos sekretaret mësimore</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Akresi i dedikuar në informacionin e ESSE3 është i garantuar përmes username dhe passëord për secilin pedagog dhe për secilin student. (procesi u shpjegua më lart). Secili pedagog gjithashtu menaxhon vetë faqen e vet në google sites lidhur me web-in e UBT. Në informacionet në Web mund të aksesojnë lirisht të gjithë aktorët Brenda dhe jashtë universitetit.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Përmes platformës aktuale studentët marrin gjithë informacionin e nevojshëm mbi lëndët, semestrat, vlerësimet. Komunikimi interaktiv garantohehet përmes postës elektronike, por nuk ka forma të tjera komunikimi në platformën e brendshme. Gjithsesi komunikimi garantohehet midis stafit akademik studentëve por edhe me stafin administrative.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Sistemi ESSE3 sipas RVB garanton raportim të performancës së studentëve, respektimin e afateve të pedagogëve, lidhur me detyrat, vlerësimet, hedhjen në system të informacioneve të tjera dhe gjenerimin e aksesimit në kohë reale. Nuk ka dokumentacion tjetër verifikues.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Duke studiuar Web-site të UBT shohim se ky kriter përmbushet pjesërisht pasi informacioni është i përdituar, por nuk është i vendosur plotësisht në dy gjuhë. Është hapësira e gjuhës angleze, por informacioni nuk është i përkthyer plotësisht.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				✓



<b>Standardi IV.6</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Ligji i arsimit të lartë 80/2015 krijon gjithë hapësirat ligjore për ndërtimin e mekanizmave të duhur për menaxhimin financiar të institucionit dhe pjesëve përbërëse të tij. Në bashkëveprim me ligjin e buxhetit, si edhe me udhëzimet përkatëse, por edhe me komponentin administrative, tashmë të ndarë nga ai kërkimor shkencor, në universitete, është e mundur të kalohet deri në nivelin e programeve të studimit. Në aneks 83 – kosto mesatare e studentit jepet një raport financiar i kostove të studentëve. <u>Por nuk ka evidencë për koston mesatare vetëm të studentëve MTR, pra vetëm të këtij programi studimi.</u> Gjithsesi kjo kosto ndryshon në varësi të grantit dhe numrit të studentëve. Parashikimet për vitet e arshshme bëhen në projekt buxhetin afatmesëm (Aneks 99 relacion mbi projekt buxhetin afatmesëm). Do të ishte me vlerë që zyra e financës të nxirrte një kosto totale për secilin program studimi dhe gjithashtu një kosto për student për programet e ndryshme të studimit dhe jo vetëm një kosto totale.
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.	Në nivel institucioni realizohet një plan financiar në kuadër të planit strategjik të institucionit. Sipas të dhënave të planit strategjik dhe të dhënave financiare financimi i institucionit realizohet rreth 60% nga buxheti i shtetit në formën e grantit dhe rreth 40% nga të ardhurat e veta (aneks 85 tregues buxheti). Plani i financimit nuk është i detajuar vetëm për programin e studimit, por t-ë dhënat mund të përpunohen për të nxjerrë disa rezultate, pasi ekzistojnë të gjithë zërat e shpenzimeve për burime njerëzore, shpenzime operative, shenëzimet për mjediset, bibliotekën, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontrata e shërbimeve, të cilat përbëjnë një burim të mirë financimi për kërkimin shkencor. Sipas të dhënave ka një sërë programesh të tilla të cilat parashikohen të mbështesin programet e studimit në UBT dhe FEA, si grantet nga marrëveshjet bilaterale, me italianë dhe Austrinë, apo IPA, Tempus, Erasmus, por nuk përmendet konkretisht për DMTR. Gjithashtu planifikohet edhe pasurimi i literaturës me bibliotekat on-line.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	Ligji i arsimit të lartë 80/2015 në nenin 116 tregon se kontrolli dhe auditimi në IAL bëhet përmes njësive të auditimit të brendshëm të institucionit. Auditimi i brendshëm në UBT realizohet nga njësia përkatëse bazuar mbi ligjin 80/2015 evidentuar kjo në aneks 86 rregullore e auditit të brendshëm. Objekt i auditimit është kryerja e auditimit në të gjitha subjektet e sistemit UBT, strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset përfshirë edhe ato që mbështeten me fondet e BE. Rregullorja e Auditit të Brendshëm parashikon të gjitha funksionet e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, të cilat garantojnë realizimin me efektivitet të procesit të auditimit. Ka një plan vjetor të auditimit për të paktën një herë në vit, por mund të bëhet edhe disa herë. Plani vjetor



	dhe raportimet miratohen nga Bordi i Administrimit i universitetit. Njësia raporton tek Drejtoria e Harmonizimit në ministërinë e financave një herë në vit në fund të vitit buxhetor dhe përfshin në raportim një pasqyrë të hollësishme të të ardhurave dhe shpenzimeve, mjeteve financiare. Kontrolli dhe auditimi i jashtëm mund të bëhet nga auditues të brendshëm ose të jashtëm të përzgjedhur nga ministria përgjegjëse për arsimin, nga lista e përdituar e audituesve nga ministria e financave.			
<b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Analiza financiare dhe raportet, paraqiten në Rektorat, Senatit akademik dhe marrin miratimin përfundimtar në Bordin e Administrimit. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi institucioni dokumenton raportet financiare për tre vitet e fundit dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij. (Aneks 85 tregues buxheti UBT 2018).			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	Bazuar në treguesin e buxhetit si edhe në përpjekjet e institucionit për të rritur të ardhurat jo vetëm nga studentët dhe tarifat e tyre, por edhe nga shërbimet dhe grantet nga projektet, si institucion që me fakultetet e tij ka një traditë në pjesëmarrjen në projekte edhe për shkak të mundësive në shkencat e aplikuara. (intervista dhe vizita në institucion). Gjykojmë që institucioni ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓



## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Hartimi dhe zbatimi i politikave dhe procedurave që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, është përgjegjësi e disa hallkave të UBT, që nga nivelet drejtuese, organet drejtuese, administrate, stafet pedagogjike, duke u pasqyruar në dokumentat themelore strategjike të UBT.</p> <p>Politikat e hartuara nga UBT pasqyrohen në planin strategjik 2016-2015 (Aneks 8 plani strategjik UBT) dhe parashikojnë orientimet e punës së institucionit, njësisive kryesore dhe njësisive bazë, duke vendosur përgjegjësitë e drejtimit dhe duke orientuar procesin e mësimdhënies dhe punës kërkimore shkencore, të cilat do të ndikojnë në ciklin e plotë akademik të studentëve dhe në garantimin e cilësisë, përmirësimin e kurrikulave, forcimin e orientimit të studentëve drejt tregut, përmirësimin e kompetencave, etj. Një element themelor në garantimin e cilësisë që ndikon në process është Njësia e Sigurimit të Cilësisë dhe Manuali i cilësisë (Aneks 93, Aneks 94).</p> <p>Ndër të tjera janë dy zyrat nën varësinë e rektoratit përkatësisht Dega e Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional, DZHKKVI dhe Dega e Informacionit dhe Transferimit të Njohurive, DITNJ, që ndërtojnë procedurat për studentët nga momneti i hyrjes e deri në daljen e tyre në tregun e punës (Aneks 53 – rregullore e DZHKKVI dhe DITNJ). –Të dyja këto zyra janë përgjegjëse për përcaktimin e aspekteve procedurale që ndihqen nga –studentët që në fillim me regjistrimin, marrjen e informacionit dhe aksesit për Sistemin e Menaxhimit të informacionit, përfshirjen në procesin e mësimdhënies, përmes mësimnxënies, vlerësimeve semestrale, vjetore, detyrave, përfshirjes në projekte, aktivitete të institucionit, përkatësisht FEA dhe DMTR për diplomën në fjalë, pjsëmarrjen në proceset zgjedhore Brenda UBT, garantimin e ofrimit të aspekteve aplikative dhe praktike në UBT e deri në marrjen e diplomës dhe daljen në tregun e punës. Procedurat kanë zbatuar ligjin, VKM-të dhe udhëzimet përkatëse, në ofrimin shërbimit gjatë ciklit të plotë akademik, lidhur me ngarkesat mësimore, shpërndarjen e ngarkesave, përcaktimin e stafëve akademike përgjegjëse, ndjekjen e përgjegjësisive, të drejtave dhe detyrimeve të studentit, të drjetat dhe detyrimet e stafit.</p> <p>Pjesë e rëndësishme përgjatë ciklit të plotë akademik është edhe bashkëveprimi i departamentit me QKA, bashkëveprimi i cili mbështet studentët në procesin e zhvillimit të karrierës, praktikat studentore dhe lidhjen me tregun e punës. Prezenca, roli i QKA dhe bashkëveprimi në procesin e studimeve doli e qartë edhe nga intervistat e studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta</p>	<p>Sipas Rregullores FEA Aneks 12, studimet në DMTR mund të ndiqen nga shtetas shqiptarë, shqiptarë etnikë dhe të huaj sipas kritereve të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	përcaktuara. Strukturat e njësisë bazë, DMTR, ZSS dhe QKA japin shërbimet dhe mbështetjen e tyre pa asnjë dallim dhe diskriminim për të gjithë studentët duke i trajtuar ata në kushte të barabarta. Ofrimi i informacionit dhe shërbimeve bëhet sipas nevojave të studentëve. ESSE3 dhe transparenca e informacionit mbështet procesin për garantim të të drejtave të njëjta.
<b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Transparenca është një nga kriteret e punës në UBT dhe gjithashtu në programet e ndryshme të studimit pra edhe në programin dhe departamentin MTR. Ka disa mënyra se si shpërndahet informacioni mbi kriteret e pranimit të studentëve, së pari në bashkëpunim me QKA promovohet njësi bazë dhe programi tek shkollat e mesme (aneks 20 broshurë promovuese UBT). Publikohen kuotat e pranimit kriteret dhe programet e studimit në portalin U-Albania. Informacioni mbi përparimin përgjatë kursit të studimit, transferimet dhe njohja e studimeve të mëparshme është i aksesueshëm për studentët e interesuar përmes sistemit të menaxhimit të informacionit, por edhe përmes marrjes së shërbimit dhe dokumentacionit nga stafet mbështetëse administrative, sekretaritë etj. Në rregulloret e UBT, FEA janë të qarta kriteret dhe procedurat e pranimit të studentëve, kriteret e transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme dhe vlerësimi i dijeve. (Aneks 11 dhe aneks 12). Publikimi i informacionit për sa më sipër në web-site e UBT dhe gjithashtu në faqet sipas departamenteve për programet e studimit, është garanti themelor për aksesueshmërinë nga publiku. Por edhe mjete tradicionale të marketingut dhe informimit si banera dhe stenda në ambientet e UBT përdoren për informimin e publikut dhe studentëve.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Kriteret e pranimit të aplikantëve maturan të i propozohen MASR nga senati akademik (Aneks 97 Vendim Senati nr 8, 2019). Departamenti shqyrton dhe propozon cdo vit kuotat dhe kriteret e pranimit të aplikantëve (Aneks 12 rregullore e brendshme e FEA). Këto procedura janë të zbatueshme dhe transparente duke nxjerrë dhe transmetuar në institucion dhe jashtë tij në MASR vendimet përkatëse.
<b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Rregullorja e brendshme e FEA pasqyron në nenin 22 se pranimet në FEA bëhen duke ndjekur udhëzimet dhe kuotat e përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse nga Këshilli i Ministrave dhe MASR për vitin akademik në vijim (Aneks 12). Për më tepër MTR vendos disa kriteret të tjera sic janë përfundimi i shkollës së mesme të përgjithshme apo profesionale, kriteri i meritës, rëndësisë, nota mesatare etj. Sipas Rregullores FEA Aneks 12, studimet në DMTR mund të ndiqen nga shtetas shqiptarë, shqiptarë etnikë dhe të huaj sipas kriterëve të përcaktuara.
<b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Informacioni për aplikantët maturan të, lidhur me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të programit MTR përgatitet nga njësi bazë DMTR në koordinim me QKA. Ky informacion është në formën e një pakete orientuese dhe përdoret gjatë vizitave në shkollat e mesme në fushën promovuese (aneks 20 – Broshurë e Promovimit të UBT). Programet e studimit, kuotat së bashku me kriteret e pranimit publikohen dhe janë lehtësisht të aksesueshme në portalin U – Albania. Zyra e





	karrierës dhe studentëve pranë FEA luan një rol të vecantë promovues për të nxitur studentët të zgjedhin FEA dhe në këtë kuadër edhe MTR për karrierën e tyre të ardhshme. ( Aneks 53 rregullore			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

**Standardi V.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Kohëzgjatja e studimeve, kushtet e kalimit në vitin pasardhës dhe ecuria e studimeve janë elemente të parashikuara në rregulloret e FEA dhe rregulloren e studimeve të DMTR (Aneks 11 dhe aneks 12). Aksesimi nga publiku garantohet nga publikimi i rregulloreve në web-site e UBT. Procedurat e përparimit akademik lidhen me procesin e mësimdhënies, informacioni për të cilin bëhet transparent në web-site e pedagogut për modulën përkatës, si edhe përgjatë semestrave dhe vitit akademik nëpërmjet sistemit të menaxhimit të informacionit. Çdo pedagog vendos në dispozicion syllabusin, me informacion mbi kreditet, synimet, temat, mënyrën e vlerësimit dhe këto shërbejnë për informimin e studentit se si do të mund të përparojë gjatë studimeve në cdo modul. Takimet informuese me studentët e kursit të parë nga përgjegjësi i departamentit dhe stafi akademik përbëjnë edhe një element shtesë për informimin mbi modulet, procedurat dhe mënyrat e përparimit të studentëve përgjatë gjithë periudhës së studimeve. Zyra e studimeve dhe studentëve, sekretaritë mësimore dhe laborantet e departamenteve janë në dispozicion të studentëve të interesuar për të marrë më tepër informacion për cdo çështje me interes përgjatë periudhës së studimeve.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesëshme.	Pranë UBT realizon veprimtarinë edhe Komisioni i Ekuivalentimit të Moduleve dhe Programeve mësimore, i cili ka për qëllim vlerësimin e rasteve të kërkesave për transferim nga një program studimi në një tjetër Brenda UBT ose dhe me institucione të tjera. Qëllimi dhe objekti i veprimtarisë së tij paraqitet në statutin e UBT, neni 55 (Aneks 7). Rregulloret e njësisë kryesore dhe njësisë bazë përcaktojnë kriteret dhe procedurat për transferimin e studimeve, transferimin në të njëjtin cikël studimit, ekuivalentimin e programeve që transferohen, regjistrimin pas pranimit të transferimit, apelimin, transferimin e studentëve të UBT drejt institucioneve të tjera, ndërrimin e programit të studimit, ndjekjen e një programi të dytë. (Aneks 11 dhe Aneks 12). ZSS shërben për informimin e studentëve dhe për përgatitjen e dokumentacionit lidhur me kërkesat për transferim. ( aneks 53 rregullore e brendshme e DZHKKVI dhe DITNJ)
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve	Vlerësimi i dijeve është pjesa më e rëndësishme në procesin e përparimit të studentit gjatë periudhës së studimeve, ndaj dhe ndërgjegjësimi i tij për

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




e aftësive të studentëve në programin e studimit.	<p>metodat e vlerësimit, kriteret e vlerësimit të dijeve dhe informimi në mënyrë të vazhdueshme për gjendjen e studentit në procesin e vlerësimit të dijeve është pjesë e rregulloreve të FEA dhe DMTR (Aneks 10 dhe Aneks 12).</p> <p>Informacioni mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit gjendet në syllabuset e lëndëve të botuara në faqen e Internetit të pedagogut për cdo modul dhe situatë e vlerësimit të studentit paraqitet në llogarinë e tij në sistemin e informacionit të UBT.</p> <p>Nga intervista me pedagogë dhe studentët vihet re se procesi është transparent dhe nuk shprehen probleme apo pakënaqësi lidhur me procesin. Në fakt paraqitet se ka dhe një komunikim në klasë që mbështet procesin dhe ndihmon në një mbarëvajtje sa më të mirë në procesin dhe transparencën e vlerësimit, ashtu sikurse në feedback-un e kërkuar nga pedagoget mbi ecurinë e procesit të mësimdhënies.</p>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	<p>Rregulloret e FEA dhe DMTR parashikojnë edhe procedurat dhe kriteret e diplomimit të studentëve MTR (Aneks 10 dhe Aneks 12). Kriteret lidhen me numrin e krediteve të fituara dhe shlyerjen e të gjitha lëndëve /moduleve sipas rregullores. Punimi i diplomës ka kriteret të përcaktuara për tu punuar, dorëzuar dhe mbrojtur në jurinë finale dhe të gjitha këto informacione ndodhen të publikuara ose vendosen në dispozicion të studentit përmes komunikimit me stafin administrative dhe stafin pedagogjik (udhëheqësin e temës). Lista e udhëheqësve afishohet dhe është në dispozicion të studentëve. Informacion të mëtejshëm mund të japë edhe stafi mbështetës i departamentit.</p>			
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	<p>Takimet e hapura organizohen nga QKA sic u tha edhe më lart, në bashkëpunim me DMTR. Ato realizohen duke paraqitur gjithë informacionet e duhura në formën e guidave si edhe duke komunikuar me nxënësit në takimet e shkollave të mesme që realizohen kryesisht për promovimin e njësisë, programeve të departamentit, stafit pedagogjik, mësimor e kërkimor shkencor, infrastrukturave, oportuniteteve që krijon ndjekja e degës MTR (Aneksi 20- broshura e promovimit)</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

**Standardi V.3**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	<p>Struktura, organizimi dhe kohëzgjatja e programit të studimeve janë subjekt i rregulloreve të DMTR dhe FEA. Informimi i studentëve mbi këto elemente bëhet përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Botimit të rregulloreve në web-site</li> <li>• Prezantimit me rregulloret që në fillim të regjistrimit të studentëve në UBT dhe në takimet e para informuese</li> </ul>





	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sekretarive dhe ZSS si edhe personelit mbështetës administrativ në department</li> <li>• Banerave dhe stendave të vendosura në ambjentet e UBT ( aneks 10 dhe 12 , web-site</li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Mënyra se si institucioni informon studentët mbi programet e studimit dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese është përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Botimit të kurrikulës së detajuar me informacion për lëndët/modulet, kreditet, përmbajtjen dhe kategorizimin e veprimtarive në web-site</li> <li>• Botimit në web-site të pedagogëve të programeve dhe syllabuseve të lëndëve përkatëse</li> <li>• Botimit të Guidës së FEA ku gjendet informacion i detajuar (aneks</li> <li>• Prezantimit me informacionin që në fillim të regjistrimit të studentëve në UBT dhe në takimet e para informuese</li> <li>• Sekretarive dhe ZSS si edhe personelit mbështetës administrativ në department</li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Elementi primar që i shërben institucionit dhe specifikisht DMTR për të promovuar studentët në tregun e punës është praktika profesionale. DMTR mbështet studentët në procesin e praktikës duke sygjerruar dhe garantuar marrëveshje me kompani/organizata/administratë (Aneks 10). Kjo i ndihmon ata për të bërë një prezantim të mirë fillestar në tregun e punës.</p> <p>Koordinimi me QKA është hapi i dytë përmes së cilit DMTR mbështet studentët në përballjen me tregun e punës. Ky process bashkëpunimi ka rezultuar efikas (intervistat me studentët) në aspektin e këshillimit për ndërtimin e CV, aplikimit për punë, letrës së motivimit, kërkimit të informacionit për punë, etj. Panairi i karrierës ka qenë dhe procesi përmes të cilit mbështeten studentët me oportunitete më konkrete në tregun e punës. Përpilimi i skedës së punësimit është dokumentacion mbështetës që ndihmon në process dhe në bazën e të dhënave. Projekti më i fundit GRADUA, paraqitet nga pedagogët dhe nga intervista në QKA si një projekt që do të rritë oportunitetet e studentëve falë krijimit të platformës për informacion në tregun e punës.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Informacioni i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij, gjendet dhe vendoset në mënyrë të dukshme në të gjitha hapësirat fizike. Informacioni mbi orarin dhe sallat është i afishuar në stenda, sallat janë të etiketuara me numra të cilat përputhen me informacionin në orar, zyrat e pedagogëve, stafit administrative gjithashtu kanë numrat dhe emrat përkatës. Sinjalistika shërben për të orientuar studentët në mënyrën e duhur për shfrytëzimin e mjediseve, infrastrukturës dhe shërbimeve.</p>
<p><b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm</p>	<p>Dy komponentë të sistemit të informacionit mbështetin studentin për tu informuar lidhur me programin e studimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Faqet individuale të pedagogëve përmes përdorimit të google apps</li> <li>• Sistemit ESSE3 përmes të cilit ndiqet ecuria e lëndës</li> </ul>



nga studentët edhe në distance.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓
<b>Standardi V.4</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	UBT përmes Zyrës së Informacionit dhe Statistikës në bashkëpunim me ZSS grumbullon dhe përpunon të dhënat lidhur me regjistrimet/aplikimet duke përpunuar të dhënat lidhur me moshën, shpërndarjen gjeografike, trajtimin me bursa, numrin e të diplomuarve, etj (Aneks 53 rregullore e DZHKKVI dhe DITNJ dhe aneks 56/1 studentë të diplomuar)			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Numri i studentëve gjithsej në DMTR për 5 vitete e fundit akademike është si më poshtë:			
	Viti akademik		Numri i studentëve të regjistruar	
	2014-2015		270	
	2015-2016		283	
	2016-2017		264	
	2017-2018		280	
	2018-2019		299 ( 287 Bch + 12 Master)	
	Burimi (Aneks 57.3 studentë të regjistruar në UBT).			
	Shihet së fundi se dega e MTR ka prodhuar edhe studentët e parë të Masterit në këtë degë dhe kjo tregon një ecuri të mirë të procesit të studentëve deri në përfundimin e studimeve në DMTR.			
	Në programin e studimit numri i studentëve të diplomuar është rritur në mënyrë të qëndrueshme duke vënë në dukje një interes në rritje për këtë program dhe duke testuar tregun. Kështu në 5 vitete e fundit ka patur një numër të diplomuarish për Bch e MTR prej 40 në vitin 2013-2014 dhe 2015-2015			
	Viti akademik		Numri i studentëve të regjistruar	
	2013-2014		40	
	2014-2015		40	
	2015-2016		35	
	2016-2017		54	
	2017-2018		63	
	Burimi (Aneks 56/1 studentë të diplomuar)			
	Institucioni përmes zyrave të mësipërme gjithashtu mban informacion për të gjithë studentët që janë larguar nga programi përpara përfundimit (6 të regjistruar në vitet 2014-2019, sipas Aneks 57.1 numri i të regjistruarve në UBT) apo për mospërfundimin me sukses			



	<p>të programit. Numri i të transferuarve në këtë program është 5 në 5 vitet e fundit, sipas Aneks 57.2, Numri i të ardhurve me transferim. Evidentimi për këtë fakt u bë në ZSS në regjistrat, duke marrë një kampionim për programin e studimit dhe për të parë standartet e ruajtjes së informacionit. Gjthashtu evidence tregojnë edhe dokumentat e mëposhtëm.</p> <p>Aneks 57/1 evidencë e numrit të studentëve të regjistruar Aneks 57/2 studentë të ardhur me transferim</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Një sërë dokumentash tregojnë për të dhënat që disponon institucioni që prej fillimit të regjistrimit të studentëve në UBT, si rrjedhim edhe studentët e programit MTR si dhe deri në diplomim. Këto janë:</p> <p>Aneks 55 – mesataret e studentëve të diplomuar MTR Aneks 57/3 studentë të regjistruar në UBT Aneks 57/4 evidencë e studentëve të regjistruar Aneks 57/5/6/7/ nota mesatare të pranimeve në vite Aneks 56/1 studentë të diplomuar</p> <p>Të dhënat janë të disponueshme në fillim dhe në fund të studimeve. Nuk ka evidence të të dhënave mbi kalueshmërinë, vlerësimet dhe të tjera në proces.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Menjëherë pas regjistrimit dhe dhënies së username dhe passwordit, çdo student hap llogarinë e tij në ESSE 3. Të dhënat e studentëve ruhen mbi bazën e ligjit mbi ruajtjen e të dhënave personale. Ato garantohet se nuk do të përdoren në mënyrë të paautorizuar. Ato verifikohen vetëm nga personat që kanë akses në system dhe janë të kufizuar sipas detyrave që kanë për mirëmbajtjen e sistemit. Ruajtja e të dhënave është përgjegjësi e ZSS, e cila i ruan ato ndër vite dhe mund të shërbejë për gjenerimin e informacioneve sipas kërkesave.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Të dhënat lidhur me regjistrimet/aplikimet duke përpunuar të dhënat lidhur me moshën, shpërndarjen gjeografike, trajtimin me bursa, numrin e të diplomuarve, notën mesatare në hyrje dhe në dalje etj përpunohen nga ZSS dhe Ayra e Informacionit dhe Statistikës, statistikë të cilat tregojnë për profilin dhe cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve. Në këto statistika janë edhe studentët e MTR.</p> <p>Aneks 55 – mesataret e studentëve të diplomuar MTR Aneks 57/3 studentë të regjistruar në UBT Aneks 57/4 evidencë e studentëve të regjistruar Aneks 57/5/6/7/ nota mesatare të pranimeve në vite Aneks 56/1 studentë të diplomuar</p> <p>Një bazë të dhënash ndërtohet edhe nga QKA në momentin e gjurmimit të studentëve përmes formularit të gjurmimit, i cili duhet të plotësohet përpara se sa student të tërheqë diplomën. Në këtë mënyrë garantohet plotësimi i të dhënave. QKA gjeneron raport mbi ecurinë e studentëve dhe pas diplomimit bazuar në të dhënat e formularit të gjurmimit. Ky raport i dërgohet rektorit për vendimmarrje të mëtejshme, mbi programet e studimit.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>



				✓
--	--	--	--	---

<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Studentët janë pjesë e strukturave drejtuese sipas ligjit 80/2015, përkatësisht përbëjnë 10% të senatit akademik, që do të thotë 3 studentë prej 25 anëtarë të senatit (Aneks 7 statuti i UBT) Studentët përfaqësohen edhe në përbërje të komisioneve të përhershme përvet në komisionin e dhënies së gradave dhe titujve. Studentët organizaohen në këshilla studentore në nivel fakulteti dhe UBT. Këshillat e studentëve janë organizata të pavarura të cilat nuk ushtrojnë veprimtari ekonomik apo politike, por sigurojnë pjesëmarrjen e studentëve në procesin zgjedhor dhe koordinojnë pjesëmarrjen me përfaqësim në organet drejtuese, sipas ligjit për arsimin e lartë 80/2015. Studentët përfshihen gjithashtu edhe në veprimtari të tjera ldhur me institucionin, psh., në QKA, përmes një anëtarit të angazhuar vullnetarisht.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	E drejta e studentëve për të zgjedhur dhe për tu zgjedhur në mënyrë që të përfaqësohen në organet drejtuese dhe komisionet e përhershme garantohej nga statute të UBT. Nga ana tjetër studentët marrin pjesë në procesin e vlerësimit të punës së programit dhe pedagogëve përkatës, kjo përmes formularit të anketimit të studentëve. Ky proces u jep atyre një fuqi reale për të ndikuar në proceset e mëtejshme për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Studentët kanë rol në organizimin e panairit të karrierës, duke punuar vullnetarisht për këtë organizim. Gjithashtu ata kanë marrë pjesë edhe në promovimin tek shkollat e mesme. UBT siguron gjithashtu mbështetje për veprimtaritë e studentëve jashtë kurrikulës, që mund të jenë veprimtari muzikore, sportive, bamirësie etj.
<b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	Departamenti i MTR ka në rregulloren e tij nenin 3 që pasqyron mbajtjen parasysh të ngarkesës akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme. (Aneks 77 ligji për arsimin e lartë, Aneks 11 rregullore e brendshme e MTR).
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe	Dy janë momentet ku pasqyrohet marrja parasysh e mendimeve të studentëve për hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programeve:

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmes plotësimit të anketave, ku një informacion i kërkuar është përmes pyetjes së lidhur me procesin mësimor dhe programet apo informacionin në lidhje me lëndën.</li> <li>• Përmes komunikimit në klasë mbi kuptimin e lëndës, tematikës, bashkëveprim në seminare, shqyrtime rreth studimit, apo pyetjeve nëse kërkojnë dicka të ndryshme apo tjetër lidhur me metodat dhe procesin e mësimdhënies. (Intervistat me student dhe pedagogët e departamentit).</li> </ul>			
<b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Procedurat e ankimimit të studentëve lidhur me barazinë dhe paanshmërinë e procesit të vlerësimit, janë vendosur me rregulloren e FEA dhe rregulloren e MTR. Aneks 12 dhe 10 paraqesin gjithë procedurat për ankimim, kohën e pritjes, të drejtat dhe detyrimet e studentit dhe të komisionit, etj. pra qartësisht jepet një procedurë ankimimi, që garanton vlerësimin e paanshëm të kontrollit të dijeve.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

**Standardi V.6**

**Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Struktura drejtuese e UBT e njësisë kryesore dhe e njësisë bazë DMTR, janë në shërbim të vazhdueshëm të studentëve të kësaj dege. Dy fushat që bazohet shërbimi i studentëve janë: mesimdhënia dhe zhvillimi i karrierës. Ofrimi i shërbimeve dhe informacioneve është funksion dhe symin kryesor i ZSS. Ajo u ofron studentëve informacion mbi gjithë hallkat e procesit të arsimimit, informacion të dobishëm për mbarëvajtjen e procesit akademik të tyre si edhe informacion në raste transferimesh, midis IAL-ve Edhe QAKS ofron informim për studentët, por sidomos në pjesën e fundit të studimeve të tyre, në qasjen me tregun e punës, por edhe lidhur me praktikën dhe kompanitë në treg.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	ZSS ofron informacionin kryesor për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Cështjet për të cilat mund të informohen studentët nga ZSS më konkretisht janë të lidhura me regjistrimin, plotësimin e diplomave, programet dhe kurrikulat e diplomimit, transferimet nga një fakultet në tjetrin, zhvillimi i procesit mësimor. ZSS jep gjithashtu edhe shërbime për studentët si suplementin e diplomës, marrjen e vërtetimeve të studentit, programe lëndësh, transferim studimesh, vendim rregjistrimit etj.



<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Qendra e Karrierës dhe Alumni QKA u shërben studentëve, duke u ofruar si zyrë e rektoratit, por e shpërndarë edhe në fakultet dhe departamnete, për të mbështetur zhvillimin e karrierës së studentëve. QKA në bashkëveprim dhe me ZKS apo DMTR oforn informacion mbi punësimin e mudnëshëm, praktikat, internship n bazë të programeve përkatëse. QKA ka mbështetur studeëntët në njohjen më të mirë të procesit të aplikimit për punë dhe dokumentacioneve të nevojshme. QKA ka ndërtuar dhe pozbaton formularin e studimit. Ajo gjithashtu ka krijuar shumë mundësi për punësimin në tregun e përshtatshëm të punës, përmes promovimit.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Njësia bazë është ajo e DMTR dhe në bashkëveprim me QKA mbledh dhe përpunon të dhëna për studentët pas diplomimit. Kjo realizohet falë plotësisht të formularit të gjurmimit, i cili kërkohet të plotësohet nga studentët përpara marrjes së diplomës. Studimi evidenton dhe analizon këto aspekte:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Profile i studentit</li> <li>• Vlefshmëria e diplomës së UBT për tregun e punës</li> <li>• Punësimi i tyre.</li> </ul> <p>Studimi është i përvitshëm dhe raporti publikohet dhe është në dispozicion të cdo student në UBT por që mund ta aksesojnë në QKA. (Aneks 14 – raport performance QKA)</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				✓

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				✓

## VLISIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<p><b>Standardi VI.1</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Sipas manualit te cilesise, misioni, vizioni (aneks ne raport), UBT e mbështet punën e vet në ndershmërinë, kreativitetin, lirinë akademike, bashkëpunimin dhe shkëmbimin për kërkimet në shkencë, dhe edukim. Universiteti Bujqësor i Tiranës ka përgjegjësinë që ti ofrojë shoqërisë shqiptare një cilësi të lartë të programeve akademike, hulumtuese dhe shërbimesh; të tregojë se po bën përpjekjet e mundshme për të përdorur në mënyrë efektive dhe efikase burimet e ofruara dhe të sigurojë që janë plotësuar standardet e cilësisë. Për të arritur sigurimin e cilësisë, UBT ka zhvilluar një politikë të sigurimit të cilësisë dhe ka ngritur një</p>






<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>sistemin të menaxhimit të cilësisë. Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë në UBT-së është konceptuar si</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përgjegjësi e menaxhimit - angazhimi i strukturave drejtuese për të garantuar cilësinë;</li> <li>- sigurimi i burimeve për garantimin dhe përmirësimin e cilësisë;</li> <li>- mësimdhënia, mësimi, hulumtimi dhe shërbimet – përmes zhvillimit dhe shpërndarjes së programeve cilësore që plotësojnë nevojat e shoqërisë;</li> <li>- analiza dhe përmirësimi – përmes përcaktimit të parimeve, standardeve, procedurave dhe metodave për monitorimin, vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë. / Për këtë arsye Universiteti zhvillon një sistem eficient në lidhje me:       <ul style="list-style-type: none"> <li>- Monitorimin, menaxhimin dhe politikën e vendim marrjes</li> <li>- Sigurimin e autonomisë së punës së pedagogëve dhe pozicionin jo diskriminues të studentëve</li> <li>- Internacionalizimin e edukimit të arsimit të lartë</li> <li>- Monitorimin e ecurisë së të diplomuarve dhe programet e postdiplomimit.6</li> <li>- Stabilizimin e lidhjeve dhe bashkëpunimin me ekonomine dhe shoqerine në shkalle te gjere.</li> <li>- Monitorimin e infrastruktures se kerkuar per zhvillimin sa më cilësor të arsimit te larte.</li> </ul> </li> </ul> <p>Universiteti në mënyrë të vazhdueshme gjithashtu përmirëson cilësinë e shërbimeve të veta dhe ka për qëllim të realizojë një performancë solide financiare. Kjo arrihet përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Organizimit të proceseve të mësimdhënies, të menaxhimit dhe mbështetjes.</li> <li>- Parashikimit të resurseve</li> <li>- Matjes së efikasitës së proceseve</li> </ul> <p>Nga vizita ne institucion, nga takimet me stafet, njesite dhe qendrat brenda universitetit dhe raportet tashme te ngritura e bera funksionale midis tyre dhe departamenteve, nga gjykimi mbi bazen e dokumentacionit konkludohet se:</p> <p>UBT e konsideron dhe ka ndertuar nje system te tille qe sigurimin e silesise e konsideron te vazhduar, te kujdesshem dhe te monitoruar nga te gjitha hallkat/njesite/qendrat pergjegjese.</p> <p>UBT ka ngritur prej disa vitesh nje sistem te brendshem te testimit, kontrollit, monitorimit te cilesise.</p> <p>Ka ndertuar nje procedure efikase te maredhenieve midis departamenteve, fakulteteve dhe njesive/qendrave dhe rektoratit/senatit.</p> <p>Përmes këtij sistemi ka ndikuar në një vendimarrje të kujdesshme të senatit, të bazuar mbi një informacion të mbledhur nga poshte (studentet/stafi), të përmbledhur e diskutuar në analizat e departamenteve, të përgjithësuara me tej përmes analizave të fakulteteve për të vijuar në një analizë të vetme vjetore, periodike të institucionit. E bere kjo procedure ne menyre te pervitshme ne fund te cdo viti akademik, ka sjelle nje permiresim dhe impact direct ne mesimdhënies duke rritur ndjeshem standartin e mesimdhënies por edhe rritur perceptimin dhe ndergjegjesimin e stafeve dhe studenteve per nevojën e permiresimit te vazhduar.</p>
--	---



	<p>Shtylla kryesore eshte kerkimi, eshte arritur nga universiteti disa mbeshtetje online qe ndihmon dhe mbeshtet pedagoget dhe studentet kerkimin, gjetjen e informacionit dhe te burimeve qe mbeshtesin kerkimin dhe permiresojne cilesine.</p> <p>Universiteti Bujqësor i Tiranës harton politika dhe procedura konform parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi. UBT ka njësinë e vet të sigurimit të brendshëm të cilësisë akademike e cila monitoron në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore. <i>(Ankesi 9 Rregullorja e Studimeve UBT. Neni 90. Fq 56. Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë. Miratuar në Mbledhjen e Senatit Akademik, datë 28.03.2017 )</i>.</p> <p>UBT përmes proceseve te vlerësimit të jashtëm të akreditimit realizon sigurimin e jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë. Të gjitha institucionet e arsimit të lartë dhe programet e studimit që ato ofrojnë, i nënshtrohen vlerësimit të parë, vlerësimit periodik dhe vlerësimit krahasues. <i>(Aneksi 9 Rregullorja e Studimeve UBT. Neni 91.a.b. Fq 56. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë. Miratuar në mbledhjen e Senatit Akademik, më datë 28.03.2017)</i>. Programi i MTR_s po i nënshtrohet për herë të parë akreditimit dhe sigurimit të cilësisë së jashtme.</p> <p>Me qëllim që të përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme puna mësimore, Departamenti i Menaxhimit të Turizmit Rural organizon vlerësimin e brendshëm të procesit mësimor dhe të kontrollit të dijeve nga studentët nëpërmjet anketimit në fund të çdo semestri pranveror (java e 13-te e semestrit).<i>(Aneksi 10 Rregullore e Studimeve e DMTRs. Neni 12. Fq. 4. Vlerësimi i Punës së Pedagogëve nga Studentët. Miratuar në Mbledhjen e Departamentit Më datë 27.09.2017)</i></p> <p>UBT dhe FEA organizon në fund të çdo viti akademik rishikimin periodik të programit të studimit dhe rregullores mësimore të tij. Dekani i FEA_s aktivizon komisionin ad-hoc për rishikimin e programeve të studimit dhe rregullores së tyre, i cili është përgjegjës për këtë proces. Gjatë këtij rishikimi vëmendje i kushtohet shumë elementëve të rëndësishëm. <i>(Aneksi 9 Rregullorja e Studimeve të UBT_s, Miratuar në mbledhjen e Senatit Akademik, më datë 28.03.2017, Sigurimi i jashtëm i cilësisë, Neni 92.a.i, a.ii, a.iii, a.iv, a.v, a.vi, a.vii, a.viii, a. ix Fq 57.)</i>.</p> <p>Realizimi me sukses i procesit të rishikimit kërkon grumbullimin e të dhënave të nevojshme përgjatë vitit akademik. Dekanati i FEA_s organizon procesin e tërheqjes së opinioneve të studentëve në lidhje me zhvillimin e procesit mësimor në të gjitha modulet. <i>(Aneksi 9 Rregullorja e Studimeve të UBT, miratuar në mbledhjen e Senatit Akademik, më datë 28.03.201. Sigurimi i jashtëm i cilësisë Neni 92. b. Fq 57)</i>.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht ✓






Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Njësia bazë që ka të drejtën dhe profesionalizmin e përmirësimit, ndryshimit, rregullimit apo propozimit të kurrikulave të reja është departamenti. E vendosur midis tregut të punës, literaturave bashkëkohore, studentëve, biznesit, nevojës për përmirësim/ndryshim dhe përmirësime të vazhduara, stafi i departamentit nën drejtimin dhe i mbështetur nga drejtuesi i tij, është gjithnjë në kërkim të mënyrave të përmirësimit, rregullimeve në kurrikula, përshtatje të tyre, përmirësimit të syllabuseve të vecanta, riorganizimit të pikëve brenda cdo syllabusi, riorganizim dhe ndarje midis lëndëve që formojnë e standartizojnë aftësitë e vecanta nga ato profesionale, etj; e gjitha kjo me qëllim studentin, dijet dhe njohuritë e tij si dhe përthitjen e tyre të plotë nga tregu kombëtar dhe ndërkombëtar. P.sh., nevoja e krijimit të këtij program studimi ka ardhur në kuadër të një projekti, por e propozuar nga vetë stafi kompetent dhe njohës i mirë i fushës së studimit.</p> <p>Nga ana tjetër, institucioni ndërton një skemë/procedure të tillë të kontrollit dhe manaxhimit të të gjithë ndryshimit të përvitshëm, dhe e standartizon atë përmes kanaleve përmes së cilave vijon i gjithë procesi. Duke kaluar përmes viteve, e gjitha kjo kthehet në një procedure të nevojshme e cila përveçse përmirëson procesin por edhe rrit cilësinë.</p> <p>Keshtu:</p> <p><i>Zyra mesimore dhe e kurrikulave</i> e ndertuar dhe krijuar prej 2016 me funksionet e veta mbështet këtë mision, dhe jo vetëm, pas daljes së produktit (kurrikulave të reja apo përmirësuara) nga departamentet kontrollon brendësinë e tyre në formë përsa i përket sistemit të krediteve, shpërdarjes në semetra, etj, si dhe përditëson sistemet dhe studentët me cdo ndryshim. Metodologjia e përdorur dhe instrumentat për ta standartizuar këtë process janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rishikimi i kurrikulave është procedurë normale. Rektorati cdo fillim viti njofton fakultetet dhe departamentet për inicim të përditësimeve të kurrikulave duke i dhënë mundësi departamenteve cdo fillim viti të shprehen për ndryshime e rregullime. Kurrikulat miratohen cdo vit nga departamentet, vulosen dhe firmosen, dhe para se të kalojnë në rektorat kalojnë në zyrën e kurrikulave, e cila okupohet që nga verifikimi i krediteve (psh, totali në 180 kredite, etj). Kurrikulat, procesi mësimor dhe përmirësimi i tyre janë përgjegjësi jo vetëm e përgjegjësive të departamenteve por edhe e zv rektorit për mësimin dhe zyrat përkatëse, duke bërë të mundur që kurrikulat kalojnë në disa duar me qëllim mirëmanaxhimin, testimin dhe kontrollin e tyre të vazhduar;</li> <li>• Analiza mësimore (meret zyra e kurrikulave që manaxhohet nga zv rektori i mesimit). Zyra kurrikulave për efekte të backgroundit në informatike dhe funksioneve që kryen manaxhon edhe faqen por edhe me hedhjen dhe përditësimin e informacionit, urdhëresat, vendimet e senatit të cilat afishohen në Eëb dhe përditësohen në këtë mënyrë sigurohen se i gjithë procesi i vendimarrjes është jo vetëm</li> </ul>



**Kriteri 3.** Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.

transparent por vecanërisht i bazuar në një proces të standartizuar, të kaluar përmes të gjithë etapave dhe të kujdesshëm.

- Anketimi. Për herë të parë për këtë vit u bë anketimi online i cili u manaxhua nga zyra e kurrikulave
- Nëse ka ndryshime në kurrikul, zyra e kurrikulës bën hedhjen në system me qëllim që studentët të jenë të përditësuar me lëndët dhe kreditet që do të japë në provim sipas kurrikulave të reja dhe të përditësuara.
- Analiza shkencore merret zyra e zv rektorit të kërkimit

Zyra mësimore dhe e kurrikulave merret me manaxhimin e procesit të rishikimit vjetor dhe periodik të kurrikulave, manaxhon hedhjen e vendimarrjes në system, anketimet, etj. Rezulton nga kjo zyrë se mësimdhënia ka ardhur në përmirësim, pra shumë pak raste negative kur këshilli etikës ka marrë masa drastike në bazë të anketimeve. Duke e deklaruar rezultatin dhe duke mos e fshehur rezultatin në një farë mënyre është mbështetje për pedagogët që punojnë po ashtu për ata që kanë patur probleme. Këto anketime jo vetëm ndahen midis pedagogëve por publikohen edhe online, në këtë mënyrë edhe studentët ndjehen mirë në lidhje me atë që kanë deklaruar vetë.

Kjo zyre manaxhon edhe informacionin, ne fakt cdo department vendos nje person pergjegjes qe eshte pergjegjes per informacionin brenda departamenti dhe per percjelljen e tij tek njesite e tjera, dhe kjo zyre kordinon hedhjen e informacionit te ndryshuar ne system.

Performanca akademike është proces i qendëruar nga institucioni dhe sfidues jo vetëm për qendrën por për të gjithë stafin dhe njësitë përkatëse. Një moment tjetër i bashkangjitur performancës është edhe divulgimi: Performanca e pedagogeve lidhet vecanërisht me testimin dhe vlerësimin e aftësisë që ka pedagogu që dijet e veta t'i bëjë publike dhe në shërbime të shoqërisë, pra të thirret në komisione jashtë UBT apo të japë kontributin e vet në shoqëri. Në këtë mënyrë institucioni ka marrë në konsideratë, dhe jep kontributin e vet në shoqëri përmes përmirësimit të cilësisë, kontrollim dhe manaxhimit të mësimdhënies dhe përmirësimit të kurrikulave. Në këtë mënyrë stafi dhe studentët do të mund të japin kontributin e tyre direkt.

Funksionojnë këshillat e studentëve, komisionet e janë zgjedhur në 2016. Studentët janë pjesë e komisioneve, disa prej tyre edhe nuk kanë funksionuar plotësisht. Së fundmi janë zgjedhur komisionet e fakultetit dhe ato të senatit, në tek to ka përfaqësues edhe nga studentët. Përmirësimi i cilësisë është proces i vazhduar, dhe në fund të vitit akademik kur dalin raportet nxjerrin dhe prodhojnë masat për të përmirësuar cilësinë.

Në vitin 2015 fakultetet përgatisin raportet e tyre të vlerësimit të brendshëm, pra të shqetësimit të departamenteve se si e perceptojnë studentët kurrikulën, stafi dhe përmirësimet. Janë konsideruar dhe vlerësuar nga institucioni si shumë të rëndësishme.

*Zyra e karrierës dhe studentëve* merret me zhvillimin e karrierës së studentëve të të gjithë fakultetit të ekonomisë, që në 2013, ka ekzistuar në formë më të zgjeruar dhe jo kaq specifike dhe të fokusuar në objektiva të qartë sa është sot, por para pak viteve është fokusuar në standartizimin dhe në karrierën e studentëve. Janë arritur mjaft sfida që e kanë bërë këtë qendër mjaft të rëndësishme, kritike dhe me peshë për hallka kyce e specifike, sikurse janë studentët, biznesi, etj. Zyrat e



karrieres së fakulteteve të UBT e mbeshtësin dhe ndihmojnë zyrën qëndrore të karrierës. Janë 5 zyra karriere në të gjithë fakultetet dhe kordinojnë përmes qendrës së karrierës.

Së fundmi, edhe informimi i studentëve nëpër shkolla të mesme tek maturantët përbën një sfidë të vendosur nga kjo zyrë por në kuadër të rritjes dhe përmirësimit të cilësisë së studentëve. Kjo bëhet me qëllim tërheqjen e studentëve të një niveli dhe cilësie më të mirë. Pastaj, sapo vijnë studentët, në fillim të vitit akademik ata njihen me cka mund të mbështeten, dhe në fund me praktikë/intership/punësim. Kjo bëhet para panairit me qëllim që të dihet sa është mundësia për punësim që përpara.

Një funksion tjetër, i cili nuk mbetet brenda qendrave individuale të karrierës apo zyrës së përgjithshme të UBT për karrierën, por i shërben objektivave dhe strategjisë së institucionit, lidhet me faktin se cdo student para se të marrë diplomimin, plotëson një formular që quhet gjurmimi i karrierës. Për cdo program studimi, cdo student e ka detyrim të vijë të plotësojë të dhënat e tij. Dhe momenti i fundit i të gjithë procesit, është që: 1 vit pas përfundimit të studimeve, pra pasi studenti ka mbi 1 vit që është larguar nga UBT, intervistohen studentët se sa u ka vlejtur diploma, praktika profesionale në gjetjen e punës, a janë të punësuar, a janë të punësuar brenda profilit, si dhe çfarë sugjerojnë studentët për të përmirësuar më tej. Rreth 300 studentë kanë plotësuar në 2017, pra para dy viteve. Me tej raportin që përgatit zyra e karrieres e con në rektorat.

Të gjitha funksionet që kryen zyra e karrieres i shërbejnë qartë dhe mirë një objektiv: përmirësimit të cilësisë, zgjerimit të pranisë së bizneseve, qëndrimit dhe mbështetjes përpara, gjatë dhe pas diplomimit të tyre, etj.

#### *Zyra e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimi institucional*

Funksioni, roli dhe pesha e kësaj zyre është pjesë e metodologjisë së universitetit për të standartizuar cilësinë, për t'a bërë pjesë të filozofisë së përditshme, me qëllimin e krijimit të një kulture cilësore të mësimitdhënies, komunikimit, etj, duke synuar më lehtë dhe mbështetur më mirë procesin e ndërkombëtarizimit të UBT si dhe përafruar qasjen më të madhe dhe cilësore me biznesin vendas dhe atë të huaj.

Procesi dhe funksionet e kësaj zyre paraqiten sipas etapave të zhvillimit të procesit mësimor. Fillon me një metodologji që në fillim që përcaktojnë se cilat janë detyrat që duhet të bëhen në një vit akademik, kur dhe kush duhet t'i realizojë.

Hartimi i pyetesorëve përbën një moment kritik dhe të rëndësishëm dhe mjaft të vlerësuar nga i gjithë institucioni, prandaj hartimi dhe përpilimi i tij kalon në të gjitha hallkat përpara se të miratohet para hedhjes në rektorat e senat.

Në këtë vit akademik janë lançuar 2 pyetesorë:

është bërë edhe një pyetesor hard copy në fund semestri i cili është përpunuar nga zyra, është specifik për cdo lëndë dhe për cdo pedagog dhe është bërë raporti si pjesë e analizës mësimore të universitetit. Bëhet raport për cdo vit dhe më tej për të gjithë universitetin. Mbi bazën e kësaj nxirren pikat e dobëta dhe u shperndahen departamenteve; mbi bazën e rezultateve më tej ndërtohet edhe plani i masave për vitin tjetër.

Pyetesori online, por që nuk është plotësuar në masë të ndjeshme nga studentët, dhe është bërë në kohën e protestave të studentëve të



	<p>DShjetorit 2018, për të kuptuar se çfarë kërkojnë studentët për të përmirësuar.</p> <p>Për procesin mësimor organizohen kontrole jo vetem të provimeve por edhe të mësimi, janë të organizuara paraprakisht dhe bëhen me komisione. Rrisin stimulimet e pedagogëve për të punuar më shumë, mbështesin studentët. Megjithatë, dy shtyllat kryesore ku bazohet e gjithë veprimtaria e institucionit janë mësimi dhe kërkimi, por edhe divulgimi është synim dhe sfidë.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>I gjithë dokumentacioni i cili përfshin jo vetem kurrikulat e rishikuara por edhe analizat mësimore, përfundimisht zhvillohet në mënyrë graduale dhe të kontrolluar nga njësitë/qendrat përkatëse (startojnë nga departamenti), kalon nga poshtë lart, pra drejt senatit dhe rektoratit i cili mbi këtë bazë merr vendimet, i bën të ditura përmes sistemit por edhe në auditoret e brendshme të universitetit, dhe finalizon procesin me një plan masash (në fund të vitit akademik). Finalizimi i këtij procesi me këtë plan masash krijon tendencën e natyrshme të përmirësimit të cilësisë, mësimdhënies, të gjithë sistemit të shërbimit në funksion dhe për studentët, etj.</p> <p>Zyra kurrikulave për efekte të backgroundit në informatikë dhe funksioneve që kryen manaxhon edhe faqen por edhe me hedhjen dhe përditësimin e informacionit, urdhëresat, vendimet e senatit të cilat afishohen në web dhe përditësohen. Në këtë mënyrë sigurohen se i gjithë procesi i vendimarrjes është jo vetem transparent por vecanerisht i bazuar në një proces të standartizuar, të kaluar përmes të gjithë etapave dhe te kujdesshem.</p> <p>Ky plan masash përbën një output të cilësuar mjaft eficient nga të gjithë aktorët dhe palët e interesuar vecanerisht sepse është ngritur mbi një sistem transparent, cilësor dhe të kontrolluar mirë.</p>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				✓


**Standardi VI.3**

**Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësi e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Vlerësimi i brendshëm i programit është process që kryhet periodikisht, kalon në shumë etapa dhe hallka dhe tashmë është institucionalizuar përmes metodologjisë së përdorur. Këtë informacion që rezulton si output i procesit dhe që prek dhe përfshin të gjitha hallkat e tij, institucioni e reflekton përmes procesit të përmirësimit periodik të cilësisë, duke e kthyer këtë process në një standart dhe instrument vlerësimi.</p>



<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Procesi i sigurimit të cilësisë së brendshme realizohet duke përdorur një metodë nga poshte-lart. Universiteti përcakton filozofinë, politikat dhe procedurat në rang UBT të cilat më pas aplikohen në rang departamenti. Sigurimi i brendshëm i cilësisë bëhet në tre mënyra kryesisht: a) nëpërmjet pyetësorëve të drejtuar studentëve (sqsuar në kriterin më sipër) të cilat plotësohen cdo semestër; b) nëpërmjet asistimeve të pedagogëve të rinj nga pedagogë me eksperiencë dhe c) nëpërmjet vlerësimit të performancës së cdo pedagogu mbi baza viti akademik. Analiza e këtyre elementëve bëhet në rang departamenti dhe konkludohet në 2 dokumenta bazë - analiza e punës mësimore dhe analiza e punës shkencore. Këto dokumenta që i bëhen të njohura dhe diskutohen në departament i percillen më pas dekanatit dhe më pas integrohen ne raportet e analizës në rang Fakulteti dhe në rang Universiteti.</p> <p>Të gjitha strukturat e institucionit sigurojnë një shërbim cilësor dhe nxisin rritjen e cilësisë në të gjitha nivelet. I gjithë personeli akademik dhe administrativ ka një rol kyç në menaxhimin dhe zbatimin e procedurave të sigurimit të cilësisë përmes një bashkëpunimi të vazhdueshëm me Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor të Institucionit dhe me Zyrën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimin Institucional që ka përgjegjësinë institucionale. Senati si organi më i lartë akademik ka përgjegjësinë përfundimtare për miratimin, monitorimin dhe rishikimin e të gjitha procedurave të sigurimit të cilësisë.</p> <p>Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga Komisionet e përhershme për vlerësimin e sigurimit të cilësisë dhe zyrat përgjegjëse në nivel Dekanti dhe Rektorati.</p> <p><i>(Aneksi 95 Raporti i Analizës së Veprimtarisë Kërkimore UBT 2017-2018).</i></p> <p>Pyetësorët me studentët zhvillohen në mënyrë semestrale, vlerësimi i stafit dhe ai i performancës së mësimdhënies dhe kërkimit çdo vit akademik. Rezultatet gjetjet e këtyre vlerësimeve analizohen gjithashtu në mbledhjen e fundit të vitit kalendarik ku edhe miratohen në Analizën e punës Mësimore e Kërkimore të DMTR_s.</p> <p><i>(Aneks 25 Raporti i Analizës Mësimore-Kërkimore MTR 2017-2018, miratuar më datë 03. 12. 2018)</i></p> <p>Institucioni në mënyrë të përvitshme harton raportet e veprimtarisë institucionale të cilat përmbledhin analizën e procesit mësimor me të gjithë komponentët e tij si dhe raportin e analizës së kërkimit me të gjithë komponentët e vlerësimit të tij. Pjesë e kësaj analize janë edhe metodat e vlerësimit të procesit të mësimin, si pyetësorët e studentëve, performance e stafit etj.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si</p>	<p>DMTR u referohet standarteve shtetërore të cilësisë në arsimin e lartë për të vlerësuar mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe të gjitha proceseve mbështetëse në këtë program studimi. Metodat dhe metodologjitë janë të mirëpërcaktuara në Manualin e NJSBCsë.,</p>





<p>vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Institucioni realizon një analizë vjetore të punës mësimore kërkimore, në kuadër të së cilës edhe DMTR realizon analizën e vet duke dhënë një vlerësim për a) Programet e studimit, b) Procesin mësimor, c) Stafin akademi. (<i>Aneks 25 Raporti i Analizës Mësimore-Kërkimore MTR 2017-2018, miratuar më datë 03. 12. 2018</i>)</p> <p>d) Studentët, e) Organizimin dhe menaxhimin e brendshëm, f) Veprimtarinë mbështetëse dhe aspekte të tjera të veprimtarisë.</p> <p>Metoda dhe instrumente të ndryshme vlerësimi janë përdorur në këtë drejtim, në përgjithësi, por dhe për vlerësimin e mbarëvajtjes së programit të studimit MTR. Këto metoda përfshijnë sondazhet e studentëve, intervista në panairin e karreirës, anketime nga të diplomuar në UBT Në këtë mënyrë vlerësohet performanca e programit të studimit, si gjatë zhvillimit të moduleve me anketimin në përfundim të vdo semestri për të gjitha modulet, ashtu edhe në dalje, me anketimet e karrierës dhe të diplomuarve. (<i>Aneksi 94 Manuali i NJBSC Vlerësimi sipas Standarteve</i>).</p> <p>Në UBT është ngritur së fundi dhe bordi i Alumni, si pjesë të strukturave të saj konsultative për përmirësimet e kurrikulare dhe lidhjen me rregullon e punës. Në procesin e përmirësimit të krijimit të kompetencave profesionale të studentëve, UBT ka lidhur më shumë se 50 marrëveshje me biznese dhe institucione për realizimin e praktikave profesionale</p> <p>Konsiderohet nga përgjegjësi i departamentit, nga stafi por edhe organet drejtuese se përpjekjet që ka bërë ky departament i ri në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies por edhe në drejtim të ndërkombëtarizimit kanë qenë për t'u vlersuar. megjithatë Departamenti nuk e konsideron të përfunduar punën në këtë drejtim, përkundrazi e sheh si një sfidë të vazhdueshme për zhvillim në të ardhme, së bashku me një qasje më domethënëse me bizneset, me synim kryesor rritjen e numrit të marrëveshjeve për një mbështetje të fuqishme të DMTR.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
<p>✓</p>				
<p><b>Standardi VL4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</b></p>				
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>			
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin</p>	<p>Garantimi dhe parashikimi për procedurat e vlerësimit të cilësisë në UBT pasqyrohen në Rregulloren e Studimeve të UBT (<i>Aneks 9 Rregullorja-e-Studimeve UBT_Final 2017, i miratuar në mbledhjen e Senatit Akademik, datë 28.03.2017, Kreu XIII, Neni 90, Fq 56. Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë.</i>) Si dhe (<i>Aneks 9 Rregullorja-e-Studimeve UBT_Final 2017, miratuar në mbledhjen e Senatit</i></p>			



<p>dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p> <p><b>riteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p><i>Akademik, më datë 28.03.2017, Kreu XIII, Neni 91, Fq 56. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë</i></p> <p>Programi i studimit DMTR zbaton të gjitha dokumentat e brendshëm dhe rregulloret, vendimet, etj të cilat garantojnë përfshirjen e njësive akademike, personelin dhe studentët si edhe strukturat e sigurimit të cilësisë në UBT. Programi i studimit ka pësuar ndryshime për përshtatjen me tregun dhe situatatën në institucion e më gjerë. <i>(Aneksi 94 Manuali i NJBSC, Vlerësimi sipas Standardeve).</i></p> <p>Statuti i UBT (Aneksi 2) në nenin 69 të tij, parashikon hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë ku pranë Degës së Mësimit, Kurrikulave &amp; Vlerësimit Institucional është organizuar dhe funksionon Njësia e Sigurimit Brendshëm të Cilësisë me këtë fokus veprimtarie:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Evidentimin e problematikave të lidhura me mësimin.</li> <li>- Evidentimin dhe ndjekjen e problematikave të lidhura me cilësinë e mësimdhënies.</li> <li>- Sigurimin e bazës së të dhënave për cilësinë e mësimdhënies.</li> <li>- Vlerësimin periodik i rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore.</li> <li>- Realizimi i studimeve për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga Universiteti.</li> <li>- Organizimi dhe ndjekja e zhvillimit të pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies për çdo programi studimi.</li> <li>- Orientimin dhe udhëheqjen metodike të procedurave të veprimit për vlerësimin e brendshëm në departamente dhe fakultete.</li> <li>- Vlerësimin e performancës së stafit akademik.</li> </ul> <p>Raportet e vlerësimit, të kryera nga njësitë për sigurimin e brendshëm të cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë, përdoren si burim për vlerësimin e jashtëm dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. <i>(Aneks 9 Rregullorja-e-Studimeve_UBT_Final 2017, miratuar në mbledhjen e Senatit Akademik, më datë 28.03.2017, Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë Kreu XIII, Neni 90, Fq 56).</i></p> <p>Në planin e masave të publikuar nga rektorati i UBT, janë përcaktuar qartë detyrat, dhe përshkallëzimi i tyre nga njësia kryesore, tek njësia bazë e deri në nivel GMK. Një sërë detyrash brënda këtij plani masash lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë, si kontrolli i vazhdueshëm i kurrikulave, syllabuseve, organizimi i pjesëmarrjeve në orë leksionesh të hapura apo ftesa ndaj lektorëve të jashtëm me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë etj.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për</p>	<p>Vlerësimi i cilësisë është një proces i vazhduar i cili përfshin të gjithë anëtarët e departamentit që ofron programin që nga përpjekjet e tyre individuale në përmirësimin e syllabuseve, mësimdhënies, cilësisë së mësimin, marrëdhënieve me biznesin dhe studentët, etj, e deri tek</p>



<p>programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>kordinimi cilësor i perpjekjeve individuale në një produkt cilësor departamental: atë të programit që ofron.</p> <p>Përfshirja e të gjithë aktorëve, duke filluar nga njësia bazë, anëtarët e personelit akademik e joakademik dhe studentët e programit është një element thelbësor i garantuar në vlerësimin e sigurimit të cilësisë së programit të studimit bachelor MTR. Ngritja e GVB është një shembull tipik në këtë drejtim, pasi nuk ka shumë raste të tjera kur mund të jetë dashur të ndiqet një procedurë e tillë edhe për shkak të moshës relativisht të re të programit. GVB i DMTR u caktua me vendim Nr. 20 datë 26.09.2018, të Dekanatit të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit dhe Numër Protokolli 261 i datës 02.10.2018, dhe Numër Protokolli të arkivës së UBT Nr 541/1 i datës 07/03/2019 (<i>Aneks 6 Vendimi i Dekanit GVB, MTR, më datë 26.09.2018, fq 3 dhe 4</i>).</p> <p>Ndër 5 anëtarët e GVB, janë 3 të cilët janë pjesë e stafit akademik, ku njëri është përgjegjësi i departamentit (E. K, Xh. D. dhe E. S.) znj E. C., është staf ndihmës i Departamentit të MTR, ndërsa një është përfaqësuese e studentëve, përkatësisht znj E. M studente e nivelit bachelor të DMTR.</p> <p>Procesi i vlerësimit është shoqëruar hap pas hapi me pjesëmarrjen e studentëve, sidomos në pjesët që ju takon lidhur me fushën e vlerësimit të performacës në mësimdhënie, si edhe pjesëmarrjen e stafit akademik dhe ndihmës në të gjitha pjesët e angazhimit të tyre me informacion përkatës, të domosdoshëm në këtë proces.</p> <p>Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit bashkëpunon intensivisht me aktorët e biznesit si edhe strukturat e tjera publik edhe private duke i përpjekur ti përfshijë ata në përmirësimin e procesit të mësimdhënies, kërkimit apo rritjes së cilësisë së programit të studimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- (<i>Aneks. 35 Lista e Marreveshjeve UBT_Praktika Profesionale, QKA</i>)</li> <li>- (<i>Aneks 40 Marreveshjet Bashkepunime Institucion UBT_Kërkim</i>)</li> </ul> <p>Për këtë personalitetet e fushës apo ekspertë ftohen për orë të hapura dhe si lektorë të ftuar në mënyrë të vazhdueshme në auditorët e UBT/FEAs.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;">✓</p>

**Standardi VI.5**

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al






<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Njësia bazë që ka të drejtën dhe profesionalizmin e përmirësimit, ndryshimit, rregullimit apo propozimit të kurrikulave të reja është departamenti. Nga ana tjetër, institucioni ndërton një skeme/procedure të tillë të kontrollit dhe manaxhimit të të gjithë ndryshimit të përvitshëm, dhe e standartizon atë përmes kanaleve, përmes së cilave vijon i gjithë procesi. Duke kaluar përmes viteve, e gjitha kjo kthehet në një procedurë të nevojshme e cila përveçse përmirëson procesin por edhe rrit cilësinë.</p> <p>Universiteti Bujqësor i Tiranës ka parashikuar politika dhe strategji për organizimin dhe veprimtarinë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në dokumentet më të rëndësishëm të tij të cilët janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe gjithë të interesuarit. Këto dokumente janë Statuti i UBTsë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>(Aneks 7 Statuti UBT, Miratuar në Mbledhjen e Senatit Akademik të UBT_s, më datë 28.03.2017, Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë, Kreu IX, neni 69, fq 42).</i></li> <li>- <i>(Aneks 9 Rregullorja-e-Studimeve_UBT_Final 2017, miratuar në mbledhjen e Senatit Akademik, datë 28.03.2017, Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë Kreu XIII, Neni 90, Fq 56).</i></li> <li>- <i>(Aneksi 93 Manuali i Cilësisë. I miratuar më datë 2018, IV, V, VI. Fq. 24, 26, 31).</i></li> <li>- <i>(Aneksi 94 Manuali i NJBSC)</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Lidhur me aspektin e vlerësimit, në UBT, si rrjedhim në FEA dhe në këtë program studimi, ruhen dy parime themelore, ai i transparencës dhe ai i respektimit të lirisë dhe etikës akademike. Kjo realizohet duke bërë transparente për stafin akademik, rezultatet e përgjithshme të anketave përmes analizave vjetore të veprimtarisë Mësimore-Kërkimore. <i>(Aneks 25 Raporti i Analizës Mësimore-Kërkimore MTR 2017-2018, i miratuar më datë 03. 12. 2018).</i></p> <p>ZSCVI bën pjesë të raporteve të pjesshme dhe atyre vjetore të gjitha të dhënat e rezultatet e anketave, duke i përfshirë edhe në raportin vjetor të përgjithshëm në fund të çdo viti akademik. Metodot për kryerjen e vlerësimit janë të shumëllojshme, të drejtpërdrejta dhe jo të tilla, duke përfshirë këtu sondazhet, intervistimet anonime me shkrim dhe në mjedise auditoresh ballë për ballë, pjesëmarrje në mbrojtjen e tezave, ndjekjen e ecurisë së studentëve, punësimin, opinionet e tyre mbi rezultatet e të nxënit dhe orientimit në tregun e punës, etj.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>UBT operon me procedura të sigurimit të cilësisë që demonstronë transparencë dhe përgjegjësi për të gjithë aktorët e saj. Të gjitha strukturat e institucionit sigurojnë një shërbim cilësor dhe nxisin rritjen e cilësisë në të gjitha nivelet. I gjithë personeli akademik dhe administrativ ka një rol kyç në menaxhimin dhe zbatimin e procedurave të sigurimit të cilësisë përmes një bashkëpunimi të vazhdueshëm me Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor të Institucionit dhe me Zyrën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimin Institucional që ka</p>






<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>përgjegjësinë institucionale. Senati si organi më i lartë akademik ka përgjegjësinë përfundimtare për miratimin, monitorimin dhe rishikimin e të gjitha procedurave të sigurimit të cilësisë</p> <p>UBT, vlerëson dhe favorizon përshkallëzimin e metodikës në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Në këtë kuadër përfshirja dhe aktivizimi i të gjithë aktorëve të brendshëm në proceset e vlerësimit është një nga objektivat kryesore të IAL në këtë drejtim.</p> <p>UBT është gjithashtu shumë transparente lidhur me çfarëdo informacioni, mase apo aktiviteti që duhet të ndërmeret lidhur me përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Kjo transparencë duket mjaft qartë në mbledhjet e departamentit të DDA apo dhe të vetë rektoratit me asamblenë. UBT mendon se fryma e transparencës që ajo ka arritur të aplikojë, është baza e shmangies të çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p> <p>Megjithëse jo akoma në formë të institucionalizuar, Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe departamenti konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me aktorë të jashtëm dhe palë të treta, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Rëndësia për cilësinë në përgjithësi dhe sigurimin e cilësisë për programin e studimit duhet të vijë si ndërgjegjësim përmes metodave të ndryshme. Ndaj dhe UBT përdor jo vetëm anketat dhe metodologjonië e saktë të tyre, por edhe mbledhjet e hapura të asamblesë për ndërgjegjësimin e studentëve dhe stafit akademik.</p> <p>Të gjitha politikat që UBT do të ndjekë për periudhën 2016-2020 janë pasqyruar në Planin Strategjik të UBT 2016-2022.. Ky është një dokument i publikuar në website të UBTsë (<i>Aneks 8 Plani Strategjik UBT_Miratur Qershor 2016-2025, miratur në Qershor 2016, Pjesa e Parë, Kreu 5, fq 42) si dhe Pjesa e Dytë, Kreu 6, fq 84)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				✓

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				✓






**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Menaxhimi i Turizmit Rural” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Bujqësor i Tiranës”**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

Disa prej pikave të forta të lidhura me oportunitete në treg përbëjnë edhe sfida për të ardhmen e programit:

1. Marrëveshjet ndërkombëtare që Departamenti i këtij programi ka lidhur, janë shumë të rëndësishme dhe mundësojnë një numër gjithnjë e më të madh të studentëve të angazhuar në kuadër të projekteve Erasmus+. Konsiderohet këtu edhe diploma e dyfishtë që MTR zotëron me Universtetin Politeknik të Marche, IAL ndërkombëtare.
2. Standartizimi i praktikave dhe rritje e pranisë së bizneseve në program, lidhur kjo kryesisht me realizimin e marrëveshjeve për realizim të praktikave të studentëve dhe panairin e karrierës.
3. Një sistem i mirë i brendshëm i menaxhimit të informacionit, që përbën sfidë për t’iu përgjigjur në të ardhmen edhe më shpejt ndryshimeve dhe për të integruar pjesët në mënyrë që të rritë cilësinë e shërbimit të studentëve.
4. Ky program favorizohet edhe nga orientimi në rritje i agrobizneseve drejt modeleve agroturistike e të turizmit rural dhe njëkohësisht fokusi i veçantë i qeverisë për të mbështetur zhvillimin e turizmit rural, për mbështetjen e sektorit privat. Sfida për të ardhmen është përshtatja në vazhdimësi me kërkesat dhe ndryshimet apo rritjen e sektorit dhe politikat publike në këtë drejtim.
5. Rritja e ndjeshme e kërkesës si kombëtare dhe ndërkombëtare për të konsumuar këtë lloj të ri të produktit turistik, nxit nevojën në rritje për menaxherë të aftësuar në drejtimin e këtij lloji të ri agrobiznesi. Ky është një program unik si titull diplome i vetëm në IAL shqiptare dhe në këtë aspekt nuk ka konkurrencë, por brenda kërkesave të Fakultetit Ekonomik ka sfidë për rritjen e cilësisë së studentëve në hyrje për t’iu përgjigjur rritjes së kërkesës.
6. Ky program studimi zotëron një kurrikul studimesh bashkohore, vlerësuar kjo në kontekstin e:
  - a) Hartimit të saj, bazuar tërësisht mbi nevojat e agrobiznesit, agroturizmit dhe turizmit rural.
  - b) Zgjidhjes së duhur të raporteve teori-praktike.
  - c) Vënies rëndësi kontrollit të studentëve gjatë vitit (mesatarisht, rreth 40 % të detyrimeve për çdo modul, studenti e shlyen gjatë vitit.
  - d) Cilësisë së lartë në formimin praktik të studentëve brenda dhe jashtë kampusit universitar.
  - e) Konsiderimit me përparësi të angazhimit të studentëve në projekte dhe detyra kursi.
  - f) Përfshirjes së studentëve në tema të kërkimit shkencor.
  - g) Identifikimit paraprak të kompetencave profesionale që duhet të zotërojnë të diplomuarit e kësaj fushe, në fokus: (menaxhim, turizëm, marketing, ligj, informatikë, finance & kontabilitet).

**Pika të dobta:**

1. Përdorim i strukturave të bibliotekës nga studentët duhet të jetë në nivele më të mira, për të rritur edhe shfrytëzimin e mundësive të bibliotekave on line.
2. Lidhja e studentëve me tregun e punës duhet të përmirësohet. Një proces më i mirë i gjurmimit për të identifikuar çfarë bëjnë studentët pas studimeve dhe se si ata zhvillohen në tregun e punës mund të sigurojnë përmirësime të programit në të ardhmen dhe gjithashtu të arrihen nivele më të larta të punësimit në profesion, si në strukturat e turizmit rural, agroturizmin, etj






**Rekomandime:**

1. Zgjerimi i përpjekjeve për zyrtarizimin e mbështetjes dhe bashkëpunimit me bizneset dhe kthimin e tyre në instrument apo katalizator të nxitjes së përmirësimeve të cilësisë. Marrja parasysh e këndvështrimit të kompanive dhe tregut në përshtatje të kurrikulës përmes evidentimit sistematik të të dhënave nga biznesi.
2. Në këtë kuadër dhe gjendje të cilësisë, sfidave por veçanërisht të arritjeve të realizuara në një kohë të shkurtër, rekomandohet një rritje e përpjekjes së ndërkombëtarizimit të kësaj diplome. Kjo do të ndihmojë për një promovim me intensiv për programin Bachelor, njohjen më të mirë nga grupet e interesuara, evidentim të vlerave të programit, sidomos në zona që nuk kanë informacionin e duhur, duke iu përshtatur edhe kërkesës në rritje të tregut të punës për këtë figurë profesionale.

**Conclusions on the Evaluation of the Bachelor Study Program in "Rural Tourism Management"  
Higher Education Institution "Agricultural University of Tirana"**

**Strengths and affirmations:**

Some of the strengths related also with opportunities in the market are explained in the light of the challenges they pose for the program in the future.

1. The International agreements signed from the department of this program are very important and enable an increasing number of students engaged in the Erasmus + projects. The agreement that must be considered of special importance is the dual diploma that MTR owns with the Polytechnic University of Marche, International HEI.
2. Standardization of internships and increased presence of businesses in the program, mainly related to the realization of agreements for internship implementation and career fair.
3. A good internal information management system, which poses a challenge to respond to changes in the future and to integrate parts in order to increase the service quality to the students.
4. Favorable opportunities for the program include the growing trend of agribusinesses towards agro-touristic and rural tourism models and, at the same time, the special focus of the government to support the development of rural tourism as private sector support. The challenge for the future is to adapt to the requirements and changes or growth of the sector and public policies in this regard.
5. The significant growth of demand, both national and international, to consume this new type of tourist product, promotes the growing need for skilled managers in running this new type of agribusiness. This is a unique degree program as a single degree in the Albanian HEI and in this regard there is no competition, but within the requirements of the Faculty of Economics there is a challenge to increase the quality of incoming students to respond to the increasing demand.
6. This study program holds a curriculum of contemporary studies, evaluated in the context of:
  - a) Its design, based entirely on the needs of agribusiness, agro tourism and rural tourism.
  - b) Proper solution of theory-practice relationships.
  - c) Emphasis on student evaluation methods during the semester (on average, about 40% of the evaluation for each module is given to semester obligations)
  - d) High quality in practical training of students inside and outside the university campus.
  - e) Priority in considering student engagement in project and course assignments.
  - f) Involvement of students in research topics.
  - g) Previous identification of the professional competencies that the graduates of this field should have in focus (management, tourism, marketing, law, computing, finance & accounting).






**Weaknesses :**

1. The use of library structures by students should be at a much better level, to ensure an increasing access to the on-line library opportunities.
2. The Connection of students with the labor market should be improved. A better tracking process for identifying what students do after their studies and how they evolve in the labor market can ensure improvements of the program in the future and also reaching higher levels of employment in their field of study, rural tourism structures, agro-tourism, etc.

**Recommendations:**

1. Expanding efforts to formalize support and cooperation with businesses and convert them into an instrument or catalyst to promote quality improvements in the program. Take into account the companies and market viewpoints in adapting the curricula through the systematic use of business data.
2. In the light of positive accomplishments and actual challenges, we recommend to increase the internationalization effort of this diploma, in regard of the positive quality evaluation, within the actual framework. This will help in intensifying the promotion of the Bachelor program, better recognition by the interested groups, putting in evidence the program values, especially for the areas that do not have the right information, adapting to the increasing demand of the labor market professional figure.





## Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				+√
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				√+
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				√+
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				√+
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				√+
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				√+
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				√+

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Klodiana Gorica
2. Prof. Asoc. Dr. Ermelinda Kordha